REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER DHURATA VARDHAMI
ADRESA RR. SAMI FRASHERI
TEL: 0674110083

KONTRATË KONCESIONI

Nr. repertori: 554 Nr. koleksioni: 203

Tirane më 29/04/2022

Ligjet referuese:
1 Ligji nr. 7850, date 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
2 Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
3 Ligji nr. 110, date 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

TAKO noterial përbëhet nga 110 fletë

A20220541302574369B

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KONTRATË

NDËRMJET

MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

(AUTORITETI KONTRAKTOR)

DHE

BASHKIMI I OPERATORËVE EKONOMIKË
"AGBES CONSTRUKSION" SH.P.K., "BESTA" SH.P.K., "PREMIUM CONSTRUCTION & MAINTENANCE" SH.P.K., "ITE. GRUP" SH.P.K. DHE "ARKONSTUDIO" SH.P.K.

PËR

DHËNIEN ME KONCESION/PARTNERITET PUBLIK PRIVAT PËR PROJEKTIMIN, NDËRTIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E "PORTIT TË INTEGRUAR" NË TRIPORT VLORË

TABELA E PËRMBAJTJES

Neni 1 Përkufizime dhe Interpretime
Neni 2 Koncesioni
Neni 3 Koncesionari dhe Shoqëria Koncesionare
Neni 4 Referencat ndaj Koncesionarit dhe Shoqërisë Koncesionare
Neni 5 Kushtet Paraprake
Neni 6 Mospërmbushja e Kushteve Paraprake
Neni 7 Data e hyrjes në fuqi të Kontratës
Neni 8 Garancia e Kontratës
Neni 9 Njësia e Zbatimit të Projektit (NJZP)
Neni 10 Nënkontratat
Neni 11 Sigurimet
Neni 12 Detyrimet e Palëve
Neni 13 Bashkëpunimi dhe Dokumentacioni
Neni 14 Përfaqësuesit e Palëve
Neni 15 Dorëzimi i objektit të koncesionit nga AK te koncesionari
Neni 16 Territori i Punimeve të Projektit dhe Kushtet e Tokës
Neni 17 Objektet Arkeologjike ose Objektet e Trashëgimisë Kulturore
Neni 18 Kërkesat Mjedisore dhe Pëlqimet e Nevojshme
Neni 19 Dokumentacioni i Projektit
Neni 20 Ndërtimi
Neni 21 Organizimi i Territorit të Projektit
Neni 22 Cilësia
Neni 23 Përfundimi i Punimeve
Neni 24 Mirëmbajtja
Neni 25 Inspektimi, Mbikqyrja dhe Raportimi
Neni 26 Siguria
Neni 27 Emergjencat
Neni 28 Pagesat
Neni 29 Modeli Financiar
Neni 30 Shkak Kompensimi
Neni 31 Shkaqe Lehtësimi
Neni 32 Ngjarje të Forcës Madhore
Neni 33 Ndryshime në Ligj dhe Veprim Material i Pafavorshëm Qeveritar

Neni 34 Ndryshime në Punimet apo Shërbimet
Neni 35 Përgjegjësia dhe Premtimi për Zhdëmtim
Neni 36 Kthimi
Neni 37 Zgjidhja e Parakohshme e Kontratës
Neni 38 Vazhdimi i Detyrimeve deri në Përfundim
Neni 39 Transferimi i Aktiveve dhe të Drejtave pas Përfundimit të Kontratës
Neni 40 Shumat e Kompensimit
Neni 41 Llogaritja dhe Pagesa e Kompensimit
Neni 42 Ndërhyrja e Autoritetit Kontraktor
Neni 43 Konfidencialiteti
Neni 44 Të dhënat e Koncesionarit
Neni 45 Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale
Neni 46 Transferimi
Neni 47 Gjuha e Kontratës
Neni 48 Njoftimet
Neni 49 Të Ftesshme
Neni 50 Mbrojtja e të Dhënave
Neni 51 Ligji Rregullues
Neni 52 Përshkallëzimi dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve
Neni 53 Amendamentet e Kontratës
Neni 54 Kostot dhe shpenzimet e palëve
Neni 55 Konflikti i Kontratës kundrejt Marrëveshjes/ve të tjera

Shtojcat

Shtojca	1	Dokumentet e Procedurës Konkurruese për dhënien me Koncesion/PPP për Projektimin, Ndërtimin dhe Mirëmbajtjen e "Portit të Integruar" në Triport Vlorë
Shtojca	2	Oferta e Koncesionarit, Plane Zbatimi të Punimeve
Shtojca	3	Modeli Financiar
Shtojca	4	Përcaktimi Hartografik (sipas VKM nr. 163, datë 17.03.2021)
Shtojca	5	Grafiku i Punimeve
Shtojca	6	Preventivi i Punimeve
Shtojca	7	Sigurimet e nevojshme
Shtojca	8	Detyrat Kryesore të Inxhinierit të Pavarur
Shtojca	9	Sigurimi i Kontratës

REPUBLIKA E SHQIPERISË
ZYRA E NOTERISË Tiranë
NR. 554 Rep.
NR. 203 Kol.

KONTRATË PËR DHËNIEN ME KONCESION/PARTNERITET PUBLIK PRIVAT PËR PROJEKTIMIN, NDËRTIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E "PORTIT TË INTEGRUAR" NË TRIPORT VLORË

Në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, më datë 29 muaji 04, viti 2022 (dy mijë e njëzet e dy), para meje noterit Blerta Vardhami anëtar i dhomës së Noterisë Tiranë, me adresë Rruga "Sami Frashëri" u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, që më poshtë do të quhet "Autoritet Kontraktues", përfaqësuar me autorizimin nr. 7614/3 Prot., datë 09.12.2021 nga Zëvendësministri, Z. Ilir Bejtja, shtetas shqiptar, lindur në Elbasan, më 17.01.1966, banues në Tiranë, mbajtës i Letërnjoftimit ID me Nr. Personal G60117004R, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

DHE

Bashkimit të shoqërive që më poshtë do të quhet "Koncesionari"

1. Shoqëria "AGBES CONSTRUKSION" sh.p.k., shoqëri e regjistruar në QKB në datë 1.04.2003 me NIPT K32807432W, me seli në Fier, ne adresën Sheq i Madh,Fier, përfaqësuar nga administratori z. Arben Goga, shtetas Shqiptar, lindur në Fier, më 23.11.1968, mbajtës i Letërnjoftimit ID me nr. , madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
2. Shoqëria "BESTA" sh.p.k., shoqëri e regjistruar në QKB në datë 15.09.1992, me numër regjistrimi J62903182B, me seli në Berat ne adresën: Ura Vajgurore, Njësia Administrative Poshnje, Ndërtesë dy katëshe, kati i dytë, Zona kadastrale 3032, Pasuria Nr.326/20, Berat, me administrator znj.Drita Azizi, përfaqësuar me prokurë nga z. Ermal Memaj, shtetas Shqiptar, lindur në Berat, më 16.02.1989, mbajtës i Letërnjoftimit ID me nr. Personal , madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i autorizuar nëpërmjet prokurës së posaçme nr. 2988 Rep. dhe nr. 1388 Kol., datë 29.04.2022.
3. Shoqëria "Premium Construction & Maintenance" sh.p.k., shoqëri e regjistruar në QKB në datë 16.6.2021 me M11816005V, me seli në Tiranë, Rruga 365, Pallati Nr.8, Kati i 8, Apartamenti B, Tiranë, përfaqësuar nga administratori z.Hektor Agalliu, shtetas Shqiptar, lindur në Terpan, më 27.1.1957, mbajtës i Letërnjoftimit ID me nr. Personal madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
4. Shoqëria "ITE. GRUP" sh.p.k., shoqëri e regjistruar në QKB në datë 22.01.2001 me NIPT K11323001H, me seli në Tiranë, Rruga Dytësore Autostrada Tirane - Durres, Km 5, Tiranë, përfaqësuar nga administratori z.Sokol Zotkaj, shtetas Shqiptar, lindur në Tirane, më 07.05.1956, mbajtës i Letërnjoftimit ID me nr. Personal , madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

5. Shoqëria "ARKONSTUDIO" sh.p.k., shoqëri e regjistruar në QKB ne date 19.08.2014 me NIPT L42019004I, me seli në Tiranë, rruga "Mihal Duri", Objekti Nr. 33, Tiranë përfaqësuar nga administratori z.Nasjel Çiço, shtetas Shqiptar, lindur në Korçë, më 30.1.1987, mbajtës i Letërnjoftimit ID me nr. Personal .. madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari mund të referohen edhe individualisht si "**Pala**" dhe bashkërisht si "**Palët**".

Duke patur parasysh se:

A. Autoriteti Kontraktues ka tagrat të nënshkruajë këtë kontratë në përputhje me:

- Ligjin me nr. 125/2013 "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat" të ndryshuar;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 10.07.2013 "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me Koncesion/Partneritet Publik Privat" të ndryshuar;
- Ligjin nr. 9251, datë 08.07.2004 "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë;
- Ligji Nr.168/2013 "Për Sigurinë në anije dhe porte dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- Konventën Ndërkombëtare për parandalimin e ndotjes detare nga anijet (MARPOL 73/78);
- Ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar si dhe aktet e tjera ligjore në fuqi për supervizimin e punimeve të ndërtimit;
- Ligjin nr.107/2014, datë 31.7.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala për zbatim të tij;
- Ligjin nr.52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit"
- Vendim i Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.1, datë 14.10.2020 "Për miratimin e planit kombëtar sektorial të transportit detar dhe infrastrukturës portuale"
- VKM Nr. 100, datë 17.02.2021 "Për përcaktimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si Autoritet Kontraktor për zhvillimin e mundshëm të procedurës së koncesionit/ partneritetit publik privat për portin në Triport Vlorë"
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 163, datë 17.3.2021 "Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të portit të peshkimit në Triport, Vlorë.

- Dokumentet e Procedurës Konkurruese "Për Dhënien me Koncesion/Partneritet Publik Privat për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e "Portit të Integruar" në Triport Vlorë";
- Ofertën e paraqitur nga ofertuesi i suksesshëm;
- Legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare me fuqi detyruese në Republikën e Shqipërisë;

B. Në datë 30.09.2021, ora 12.00, ofertuesi fitues (Koncesionari) ka paraqitur propozimin e tij në lidhje me këtë procedurë konkurruese **("Oferta e Koncesionarit")**, e cila është pranuar nga Autoriteti Kontraktues (Komisioni i Dhënies me Koncesion);

C. Në datë 21.10.2021, Autoriteti Kontraktues i ka dërguar ofertuesit fitues (koncesionarit) "Njoftimin e fituesit", (*shkresa nr. 7614/1 prot., dt.21.10.2021 "Njoftim Fituesi"*), nëpërmjet së cilës është fituar ofertuesi fitues (Koncesionari) për negocimin e Kontratës Koncesionare;

D. Autoriteti Kontraktues dhe bashkimi i operatorëve ekonomikë angazhohen në mirëbesim të venë në zbatim këtë Kontratë Koncesioni në përputhje me afatet dhe kushtet e parashikuara më poshtë;

Duke pasur parasysh sa më sipër, Palët bien dakord për sa më poshtë vijon:

Neni 1

Përkufizime dhe Interpretime

1.1 Përkufizime

Kurdohere që fjalët me gërmën e parë të madhe do të përdoren në këtë Kontratë (duke përfshirë edhe Anekset e saj) këto fjalë do të kenë kuptimet e përkufizuara më poshtë apo përgjatë tekstit të Kontratës:

"Kontratë Koncesioni" ose **"Kontratë"** do të thotë kjo Kontratë Koncesioni (bashkë me të gjitha Anekset e saj, të cilat do të konsiderohen pjesë përbërëse e pandashme e saj) dhe çdo dokument apo akt bashkëngjitur kësaj Kontrate ose Aneksëve të saj, pavarësisht emrit që i jepet gjatë negociatave mes Palëve.

"Aneks" do të thotë çdo shtojcë e kësaj Kontrate që formon një pjesë përbërëse dhe të pandarë të saj.

"Garanci e Kontratës" do të thotë një siguritë i kontratës i vlefshëm përgjatë gjithë periudhës Koncesionare, i lëshuar nga një shoqëri sigurimi apo institucion bankar që vepron në Shqipëri në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që garanton përmbushjen e detyrimeve të

Koncesionarit.

"Periudhë Koncesionare" do të thotë kohëzgjatja prej 10 (dhjetë) vjetësh duke filluar nga Data e hyrjes në fuqi të kontratës, përveç kur Kontrata zgjidhet më parë ose shtyhet në përputhje me parashikimet e kësaj Kontrate.

"Data e hyrjes në fuqi të kontratës"/ "Data Efektive"/ kanë kuptimin e përcaktuar në nenin 7 të Kontratës.

"Periudha e Vlefshmërisë së Kontratës" është periudha kohore që fillon me Datën efektive të kësaj Kontrate dhe përfundon me Datën e Përfundimit të Kontratës, përfshirë edhe shtyrjet e parashikuara sipas kësaj Kontrate.

"Data e Përfundimit të Kontratës" është data më e hershme nga sa më poshtë:

a) Data e fundit e mbarimit të Periudhës së Koncesionit; dhe
b) Data e Përfundimit të kësaj Kontrate e përcaktuar në përputhje me nenin 37 "Zgjidhja e Parakohshme e kontratës"

"Ditë Pune" do të thotë çdo ditë e javës gjatë së cilës punohet, në kuptim të dispozitave të KP në Republikën e Shqipërisë.

"Muaj" është një muaj kalendarik gjatë Periudhës së Koncesionit. Një "Muaj" i referohet një periudhe që fillon në një ditë të një Muaji kalendarik dhe që përfundon në ditën që korrespondon numerikisht në Muajin e ardhshëm kalendarik (pa e përfshirë atë ditë), me përjashtim të rastit që, nëse nuk ka ditë që korrespondon numerikisht në Muajin në të cilin ajo periudhë përfundon, ajo periudhë do të përfundojë ditën e fundit në atë Muaj kalendarik.

"Vit i Plotë Kalendarik" është periudha nga data 1 Janar deri më datë 31 Dhjetor, duke i përfshirë të dyja këto data.

"Palë" ka kuptimin e dhënë në hyrje të Kontratës

"Autoritet Kontraktor" ka kuptimin e dhënë në hyrje të kësaj Kontrate.

"Koncesionari" ka kuptimin e dhënë në hyrje të kësaj Kontrate.

"Të Drejtat e Koncesionarit" janë të gjitha të drejtat e dhëna Koncesionarit sipas Kontratës, përfshirë të drejtën për të projektuar, ndërtuar, mirëmbajtur dhe për të financuar Portin e Integruar në Triport Vlorë, në përputhje me Ligjin dhe me këtë Kontratë, e drejta e çdo pagese, financimi, kompensimi, shtesë në kohë, nga ana e Autoritetit Kontraktor, sipas kësaj Kontrate, të Modelit Financiar të Koncesionarit si dhe të ofertës fituese të Koncesionarit, në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate.

"E Drejta për Kalim" do të thotë e drejta për të kaluar mbi dhe nën Port dhe në çdo pjesë të tyre, si dhe për të hyrë dhe për të dalë në të, pa ndërhyrje të parregullt nga ndonjë palë e tretë me qëllimin e zbatimit të kësaj Kontrate.

"Shoqëri Koncesionare" është subjekti për qëllime të veçanta, i themeluar nga Ofertuesi fitues (koncesionari) për tu bërë palë e kësaj kontrate, të cilit i transferohen automatikisht të drejtat dhe detyrimet e kësaj Kontrate Koncesioni, nga momenti i njoftimit të AK për krijimin e Shoqërisë Koncesionare.

"Aksioner" ka kuptimin që jepet sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar apo sipas përcaktimeve të Ligjit të zbatueshëm të vendit ku është regjistruar shoqëria.

"Leje, Autorizim, Licencë" do të thotë çdo miratim, leje, licencë, autorizim, aprovim ose certifikatë, nxjerrja ose ripërtëritja e secilës është në përgjegjësinë e çdo Entiteti Shtetëror dhe që kërkohet për zbatimin e kësaj Kontrate.

"Entitet Shtetëror" ose "Entitet" do të thotë (i) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe/ose çdo ministri, departament ose nënndarje politike dhe administrative e saj; dhe (ii) çdo entitet tjetër qeveritar, agjenci ose autoritet nën kontrollin e Republikës së Shqipërisë, ose çdo ministri, departament ose nënndarje politike e saj, si dhe çdo komunë ose bashki, dhe që ushtrojnë juridiksion sipas Ligjeve të Republikës së Shqipërisë mbi subjektin për qëllime të veçanta (SPV), ose çdo autoritet i pavarur rregullator, në territorin e Republikës së Shqipërisë. Autoriteti Kontraktues përjashtohet nga ky përkufizim.

"Autoritet Përkatës" janë entet, agjencitë, autoritetet, organizmat ose Personat shtetërorë, bashkiakë, kombëtarë, rajonalë ose vendorë që ushtrojnë aktivitet në Republikën e Shqipërisë dhe/ose kanë autoritet dhe kompetencë për të ushtruar tagrat zyrtarë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

"QKB" ka kuptimin e Qendrës Kombëtare të Biznesit, si institucioni shtetëror i ngarkuar nga Ligji për mbajtjen e regjistrit të shoqërive tregtare.

"Person" do të kuptohet çdo individ, person fizik, juridik, shoqëri tregtare, ortakëri apo organizatë e çdo lloj forme organizimi e parashikuar nga Ligji ose ligji i një vendi tjetër, përfshirë Autoritetin Kontraktor dhe Autoritetet Përkatëse.

"Palë e Autoritetit Kontraktor" është veçmas Autoriteti Kontraktor dhe nëpunësit, punëmarrësit dhe agjentët e tij dhe çdo nënkontraktor apo Person i punësuar ose i angazhuar nga secili prej tyre (ku përfshihen edhe Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor dhe Përfaqësuesi teknik, por pa përfshirë Koncesionarin dhe Palët Koncesionare) si dhe Autoritetet Përkatëse të tjera që sipas rastit asistojnë Autoritetin Kontraktor për zbatimin e Kontratës.

"Përfaqësues i Autoritetit Kontraktor" është Personi i autorizuar për të përfaqësuar Autoritetin Kontraktor në lidhje me realizimin e kësaj Kontrate.

"Njësia e Zbatimit të Projektit" (NjZP) është organi që krijohet, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e kontratës, nga Autoriteti Kontraktues për monitorimin e zbatimit të kësaj kontrate.

"Palë Koncesionare" është veçmas Koncesionari, Shoqëria Koncesionare, Nënkontraktori, Përfaqësuesi i Koncesionarit, inxhinieri i Koncesionarit dhe nëpunësit, punëmarrësit dhe çdo Nënkontraktor apo Person i punësuar ose i angazhuar nga secili prej tyre.

"**Përfaqësues i Koncesionarit**" është vetë Koncesionari ose një Person i autorizuar me shkrim për përfaqësimin e tij.

"**Inxhinieri i Pavarur**" është Personi ose Personat e pavarur me përvojë, të huaj dhe/ose shqiptarë, të cilët kontraktohen nga Autoriteti Kontraktor, në përputhje me këtë Kontratë, për të mbikëqyrur Punimet, shërbimet në lidhje me Ndërtimin dhe Mirëmbajtjen e Portit të Integruar në Triport Vlorë dhe të cilët kryejnë detyrat e Inxhinierit të Pavarur në aspektin teknik, ligjor, ekonomiko-financiar, në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate dhe Kontratës së Autoritetit Kontraktues me Inxhinierin e Pavarur. Detyrat kryesore të Inxhinierit të Pavarur jepen të renditura në Shtojcën 8 të Kontratës.

"**Kontrata e Inxhinierit të Pavarur**" është kontrata e lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të Pavarur në lidhje me realizimin e detyrave të Inxhinierit të Pavarur për mbikqyrjen dhe kontrollin e Punimeve të ndërtimit dhe mirëmbajtjen e portit të integruar në Triport Vlorë, në përputhje me këtë Kontratë.

"**Nënkontratë**" është:

a) Nënkontrata e miratuar e Ndërtimit; dhe
b) Nënkontrata e miratuar e Mirëmbajtjes.

"**Nënkontratë Ndërtimi**" është nënkontrata e lidhur ndërmjet Koncesionarit dhe Nënkontraktorit Ndërtimor për kryerjen e Punimeve apo një pjese të tyre, me ndryshimet dhe zëvendësimet perkatëse të bëra herë pas here në përputhje me këtë Kontratë.

"**Nënkontratë e Mirëmbajtjes**" është Nënkontrata e lidhur ndërmjet Koncesionarit dhe Nënkontraktorit të Mirëmbajtjes për kryerjen e Punimeve të mirëmbajtjes apo një pjese të tyre, me ndryshimet dhe zëvendësimet përkatëse të bëra herë pas here në përputhje me këtë Kontratë.

"**Nënkontraktor**" është:

a) Nënkontraktori Ndërtimor; dhe
b) Nënkontraktori i Mirëmbajtjes.

Për efekt sqarimi, nëse Punimet kryhen nga Koncesionari, (i) ky i fundit nuk do të konsiderohet si Nënkontraktor, dhe (ii) nuk do të ketë nevojë që, për të, të merret miratim nga Autoriteti Kontraktor.

"**Nënkontraktori Ndërtimor**" është subjekti i regjistruar sipas Ligjit, me seli në adresën e deklaruar në QKB dhe i përfaqësuar nga administratori apo përfaqësuesi i tij ligjor,si përfaqësues i caktuar dhe autorizuar rregullisht në bazë të Nënkontratës së Ndërtimit.

"**Nënkontraktori i Mirëmbajtjes**" është subjekti i regjistruar sipas Ligjit, me seli në adresën e deklaruar në QKB dhe i përfaqësuar nga administratori apo përfaqësuesi i tij ligjor, si përfaqësues i caktuar dhe autorizuar rregullisht në bazë të Nënkontratës së Mirëmbajtjes.

"**Palë e Lidhur**" është, kundrejt një shoqërie tregtare, çdo shoqëri e llojit holding (që zotëron Aksionet/Kuotat e shoqërive të tjera) që ushtron kontroll mbi atë shoqëri tregtare, çdo shoqëri tregtare mbi të cilën ushtrohet kontroll nga ajo shoqëri tregtare ose çdo shoqëri e kontrolluar e një shoqërie të llojit holding që ushtron kontroll mbi atë shoqëri tregtare.

"**Palë e Cënuar**" ka kuptimin e dhënë në përkufizimin e Ngjarjes së Forcës Madhore.

"Ngjarje e Forcës Madhore" do të thotë çdo rrethanë apo ngjarje që në mënyrë objektive është tej parashikimit dhe kontrollit absolut, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të Palës së cënuar ("Pala e Cënuar") shkakton pamundësi të plotë ose të pjesshme të Palës së Cënuar për të përmbushur ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate (përveç kryerjes së pagesave të parave), por vetëm nëse dhe në masën që:

a) kjo rrethanë, pavarësisht ushtrimit të kujdesit të arsyeshëm, nuk mund të parandalohej apo nuk ishte e mundur të parandalohej, shmangej ose mënjanohej nga Pala e Cënuar;

b) Pala e Cënuar ka marrë të gjitha masat e arsyeshme paraprake, kujdesin e duhur dhe masat e arsyeshme alternative në mënyrë që të shmangte pasojën e këtij rasti në aftësinë e Palës së Cënuar për të përmbushur detyrimet e saj sipas kësaj Kontrate dhe për të zbutur pasojat e saj;

c) ngjarja nuk është, ose nuk ka qenë pasoje e drejtpërdrejtë ose e tërthortë e shkeljes nga Pala e Cënuar të ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate, dhe

d) Pala e Cënuar t'i kalë dhënë njoftim Palës tjetër **("Pala e Pacënuar").**

"Rastet e Forcës Madhore" përfshijnë rrethanat e mëposhtme, por pa u kufizuar vetëm në to, me kusht që ato të plotësojnë kriteret e shprehura në përkufizimin e Ngjarjes së Forcës Madhore më sipër:

a) veprimet e luftës, pushtimi ose akti i një armiku të jashtëm, ose aktet e terrorizmit, bllokadat, embargot, racionimet;

b) aktet e rebelimeve, kryengritjet, trazirat civile, grevat e natyrës politike, aktet ose fushatat e terrorizmit;

c) trufeja, zjarri, tërmeti, stuhia, cikloni, tajfuni, tornado si dhe veprimtari të tjera të fenomeneve të njohura apo të panjohura natyrore mbi apo nën ajë ose ndonjë fatkeqësi tjetër natyrore;

ç) epidemitë, pandemitë ose murtaja; dhe

d) çdo akt sabotimi, grevat ose veprimtaritë e punës për të imponuar ose për të ngadalësuar punën *(sidoqoftë duke përjashtuar punonjësit e palës që pretendon atë si rast të forcës madhore, ose punonjësit e ndonjërit prej ortakëve/aksionarëve të kësaj pale, ose punonjësit e ndonjë filiali të kontrolluar, drejtpërdrejt ose tërthorazi nga shoqëria mëmë ose degë e ndonjë ortaku/aksionari të kësaj pale).*

Pala e Cënuar do të përjashtohet nga përmbushja e detyrimeve dhe nuk do të konsiderohet në mospërmbushje të Kontratës për aq kohë dhe në atë masë sa zgjat pamundësia për të përmbushur detyrimet. Njëkohësisht, Periudha e Koncesionit do të shtyhet automatikisht për aq sa do të zgjasë Ngjarja e Forcës Madhore.

"Dokumentacioni i Autoritetit Kontraktor" është i gjithë dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Autoriteti Kontraktor, gjatë procedurës së shpalljes së Kontratës, në lidhje me Portin e Integruar në Triport Vlorë.

"Dokumente të Procedurës Konkurruese" janë dokumentat e procedurës konkuruese të hartuara nga Autoriteti Kontraktor, të publikuara në faqen elektronike të Agjencisë së Prokurimit

Publik si dhe njoftimi i Kontratës, botuar edhe në një gazetë ndërkombëtare, për ofertuesit e mundshëm në lidhje me këtë Projekt.

"Dokumentat e Ofertës" është çdo dokument që Koncesionari ka paraqitur si pjesë të ofertës gjatë procedurës konkuruese.

"Çmimi i Ofertës" ka kuptimin siç përcaktohet në Ofertën e Koncesionarit Shtojca 2.

"Vlera e Investimit" do të thotë shuma totale për kryerjen e investimit, për realizimin e projektit të Portit të Integruar në Triport Vlorë, sipas objektit të kontratës.

"Pagesa nga Autoriteti Kontraktor" është pagesa e cila është e propozuar në Dokumentacionin e Ofertës fituese, çdo pagesë që Autoriteti Kontraktor e jep në përputhje me Kontratën.

"Model Financiar" është:

a) në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate, Modeli Financiar i paraqitur në ofertën e Koncesionarit; dhe

b) pas kësaj date, modeli i përditësuar në përputhje me këtë Kontratë, ku në të dhënat e këtij modeli të përditësuar, vlera e IRR do të jetë deri në/ ose 6.468% , pra deri në/ ose sa vlera e IRR së llogaritur në Studimin e Fizibilitetit të Autoritetit Kontraktues.

"Kapital i Investuar" janë shumat që Aksionerët e Koncesionarit apo Shoqërisë Koncesionare i investojnë në funksion të përmbushjes së kësaj Kontrate si Kapital Neto ose si Borxh i Pasiguruar.

"Kapital Neto" është kapitali i Koncesionarit, përfshirë të gjitha vlerat monetare/të pagueshme si rezultat i nënshkrimit/pagimit të kuotave/aksioneve, nga kontributet apo huatë e dhëna nga Aksionerët e tij, huatë e dhëna nga Shoqëritë e Lidhura ose kontrolluese të Koncesionarit (direkt apo indirekt), të cilat nuk rezultojnë si borxh i paguar, si dhe të gjitha asetet e Koncesionarit.

"Euro" është monedha e ligjshme e Bashkimit Ekonomik dhe Monetar Europian, apo çdo monedhë tjetër me të cilën Bashkimi Ekonomik dhe Monetar Europian mund ta zëvendësojë atë.

"Tatim apo Taksë" është çdo lloj tatimi, takse apo pagese e vendosur në bazë të Ligjit kohe pas kohe, pavarësisht nëse është vendosur apo jo deri më Datën e Fillimit të Zbatimit të Kontratës.

"Financues" do të thotë çdo institucion i njohur financiar kombëtar apo ndërkombëtar, i cili në përputhje me veprimtarinë e tij mund të financojë këtë Koncesion bashkë me Koncesionarin.

"Rifinancim" është zëvendësimi i një borxhi ekzistues me një borxh tjetër me kushte financiare të ndryshme, por që nuk sjell asnjë implikim financiar shtesë për Autoritetin Kontraktues përtej pagesave të parashikuara në Modelin Financiar.

"Instrument financiar" do të thotë çdo marrëveshje huaje, bono, kontrata, instrumente, marrëveshje sigurimi, deklarata regjistrimi ose informimi, marrëveshje varësie, hipoteka, akte përfaqësimi e administrimi, marrëveshje kredie, marrëveshje për blerje bonosh, marrëveshje pjesëmarrjeje dhe dokumente të tjera që lidhen nga Koncesionari dhe/ose Shoqëria Koncesionare në lidhje me objektin e Koncesionit dhe për ushtrimin e të Drejtave Koncesionare, duke përfshirë modifikimet, plotësimet, shtesat, zgjatjet, ripërtëritjet dhe zëvendësimet e çdo financimi të tillë.

"Marrëveshjet për Financimin" janë marrëveshje (pa përfshirë marrëveshjen për sigurimin e Borxhit të Pasiguruar) në bazë të së cilës Koncesionarit i jepet financim në formë borxhi me përparësi ose borxh që kthehet në kapital ose borxh afatshkurtër dhe/ose çdo lloj forme tjetër e jashtme financimi në lidhje me Projektin (në formë kredie, letër-kredie ose dorëzanie ose në forma të tjera) dhe çdo marrëveshje mbrojtjeje (hedging) për interesin dhe, në çdo rast çdo kontratë garancie duke përfshirë edhe çdo Marrëveshje të Drejtpërdrejtë në lidhje me to, në çdo rast të miratuar me shkrim nga Autoriteti Kontraktor si Marrëveshje Financimi.

"Marrëveshje e Drejtpërdrejtë" është marrëveshja e lidhur ndërmjet Koncesionarit, Shoqërisë Koncesionare dhe Huadhënësve dhe që mund të përfshijë sipas rastit edhe Autoritetin Kontraktor.

"Huadhënës" janë institucione krediti ose financiare ose organizma të tjera të ngjashme financiare të angazhuara profesionalisht në dhënien hua të parave, subjekte private të cilat mund të jenë palë në Marrëveshjet për Financimin, ose mund të kenë të drejta në bazë të Marrëveshjeve për Financimin, dhe/ose i japin Koncesionarit financim në formë linje financimi me obligacione, borxhi me përparësi ose borxhi me të drejtë kthimi në kapital apo të ngjashëm (dhe marrëveshje mbrojtëse (hedging)) në përputhje me Marrëveshje të tilla për Financimin dhe do të përfshijnë edhe siguruesit që lëshojnë dorëzani apo sigurime të ngjashme për këto linja financimi apo Persona të tretë që bien dakord të kryejnë Pagesa pa pagesë, me kusht që shuma e papaguar t'u kthehet në borxh apo Persona që blejnë dhe zotërojnë obligacione për të financuar Projektin).

"**Detyrimet Kundrejt Huadhënësve**" janë shumat e të gjithë komponentëve të mëposhtëm:

a) principalit, interesave (përfshirë edhe penalitetet për mospagesë, por vetëm atë të konstatuar përpara zgjidhjes së kësaj Kontrate si rezultat i Mospërmbushjes nga Autoriteti Kontraktor), komisioneve bankare, kostove dhe shpenzimeve të bëra apo të kryera në mënyrë të rregullt apo që Koncesionari i detyrohet apo kanë mbetur pa paguar tek Huadhënësit nga ana e Koncesionarit, në bazë të Marrëveshjeve të Financimit deri më Datën e Përfundimit të Kontratës (ku përfshihen edhe kostot e pagesave në rast shlyerjeje kredie përpara kohe); dhe

b) të gjitha shumave që Koncesionari u detyrohet Huadhënësve për shkak të zgjidhjes përpara kohe të marrëveshjeve mbrojtëse "hedging" për normën e interesit (ku përfshihen edhe kostot për shlyerje përpara kohe dhe komisionet e angazhimit të pagueshme si rezultat i kësaj) që janë aprovuar me shkrim nga Autoriteti Kontraktor si Marrëveshje Financimi në përputhje me nenin 13 me kusht që Koncesionari dhe Huadhënësit do të mundohen në mënyrë të arsyeshme t'i zbusin këto vlera, për aq sa është e mundur.

"**Vlera e Tregut e Projektit**" llogaritet si vijon:

Vlera e tregut = A + B – C, ku:

A = vlera aktuale e Pagesave nga Autoriteti Kontraktor që do të kishte marrë Koncesionari që nga Data e Përfundimit të Kontratës deri në fund të Periudhës së Koncesionit (pa marrë në konsideratë, në kuptimin e përllogaritjes, faktin e ndërprerjes përpara kohe të Kontratës) në bazë të Modelit Financiar me përditësimet më të fundit.

B = çdo kompensim i pagueshëm ndaj Koncesionarit në bazë të kësaj Kontrate, si pasojë e një ngjarjeje që ndodh përpara Datës së Përfundimit të Kontratës.

C = (D1 – D2) + E + F + G, ku:

D1 = kostoja gjithsej më Datën e Përfundimit të Kontratës për rivendosjen e Koncesionit në Standardet dhe specifikimet e parashikuara me këtë Kontratë.

D2 = dëmi nga sigurimi që ka arkëtuar Autoriteti Kontraktor në lidhje me kostot e rivendosjes të përmendura në D1.

E = vlera aktuale neto e kostove për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Koncesionit, përfshirë Shpenzimet Kapitale që nga Data e Përfundimit të Kontratës deri në fund të Periudhës së Koncesionit (pa marrë në konsideratë, në këtë kuptim, ndërprerjen përpara kohe të Kontratës) (pa përfshirë kostot e përfshira në D1, më lart) në bazë të Modelit Financiar me përditësimet më të fundit.

F = shumat e depozituara ose të kaluara në një llogari rezervë për shlyerjen e borxhit të mbajtur në emër ose për llogari të Koncesionarit në bazë të Marrëveshjes së Financimit, për të garantuar Detyrimet Kundrejt Huadhënësve.

G = çdo vlerë, të papërfshirë në shkronjën "F" më lart, në investime në mjete monetare ose ekuivalente të mjeteve monetare dhe vlera të tjera që në rast garantojnë të drejtat e Huadhënësve dhe janë të arkëtueshme nga Huadhënësit (ose në llogari rezervë ose në një formë tjetër) dhe në çdo rast pa e llogaritur dy herë garancinë për ecurinë që është vënë në dispozicion në përputhje me nenin 8.

Në kuptim të llogaritjes së vlerës aktuale neto, norma e skontimit është e barabartë me Normën e Brendshme të Kthimit mbi Kapitalin (Equity IRR) të situatës bazë.

Për të shmangur çdo dyshim, kur llogaritja nxjerr rezultat një shifër me vlerë negative, vlera e tregut e Projektit është zero.

"Port" do të thotë një pjesë e territorit tokësor të bregdetit, territorit detar, liqenor dhe ujor, i përcaktuar për të pranuar mjete lundruese.

"Territor i Projektit" është:

a) territori tokësor i bregdetit, territori detar dhe ujor, i përcaktuar për të pranuar mjete lundruese që përbën Portin e Integruar sipas Projektit, apo rrugët ndihmëse që i duhen Koncensionarit për të pasur akses në Kantier;

b) territori tokësor i bregdetit, territori detar dhe ujor, i përcaktuar për të pranuar mjete lundruese që përbën Portin e Integruar sipas Projektit dhe që Autoriteti Kontraktor ia vë në dispozicion Koncesionarit për realizimin e Punimeve dhe mirëmbajtjes së këtij porti.

Port i integruar në Triport Vlorë do të quhet porti aktual i peshkimit-Triport Vlorë, në të cilin referuar Vendimit Nr. 1 datë 14.10.2020 të Këshillit Kombëtar të Territorit, do të transferohet i gjithë aktiviteti tregtar që ushtrohet aktualisht në Portin Detar Vlorë.

"Sipërfaqja e Portit të Integruar" do të thotë sipërfaqja sipas përcaktimit hartografik bashkëngjitur Kontratës në Shtojcën 4.

"Asete të Portit" ose "Asete" do të thotë të gjitha të mirat materiale ose jo materiale të prekshme ose të paprekshme që janë ose do të krijohen nga Koncesionari të cilat janë të përfshira në Planin e Biznesit dhe Ofertën e Koncesionarit.

"Dorëzimi i Territorit të Projektit" do të thotë dorëzimi i Territorit të Projektit nga Autoriteti Kontraktor te Koncesionari, në çdo rast të çliruar nga (i) të gjitha pengesat për të filluar Punimet, përfshirë Shembjen e objekteve të Shpronësuara apo objekteve të ndërtuara pa leje si dhe largimin e Personave prej tyre (ii) nga të gjitha pretendimet e palëve të treta.

"Shembja e Objekteve" do të thotë prishja nga ana e Autoriteteve Përkatëse e objekteve të shpronësuara apo objekteve pa leje që ndodhen në Territorin e Projektit pa përfshirë kostot e transportit të mbetjeve pas shembjes të cilat në çdo rast mbulohen nga Koncesionari.

"Shpronësim" do të thotë çdo shtetëzim ose shpronësim i aseteve të një Personi, ose çdo masë apo veprim i cili, i marrë veç e veç apo së bashku, ka efekt të barasvlershëm me shtetëzimin ose shpronësimin.

"Kushtet paraprake" do të thotë kushtet sipas përcaktimeve të Nenit 5

"Data e Fillimit të Zbatimit të Kontratës" ka kuptimin e dhënë në Nenin 5

"Projekt Ideja" ka kuptimin e dhënë në Nenin 19 të Kontratës.

"Projekti" është tërësia e aktiviteteve të ndërlidhura për ndërtimin, mirëmbajtjen e Portit të Integruar në Triport Vlorë, i përcaktuar në objektin e kësaj Kontrate sipas Projektit të Zbatimit dhe kryerja e çdo pjese të Punimeve dhe Shërbimeve gjatë Periudhës së Vlefshmërisë së Kontratës dhe financimi sipas ofertës së paraqitur nga Koncesionari në procedurën e koncesionit.

"Projekt Zbatimi" ka kuptimin e dhënë në Nenin 19 të Kontratës.

"Data e Dorëzimit të Projekt Zbatimit" është brenda 3 (tre) Muajsh nga Data e Hyrjes në Fuqi të Kontratës.

"Plane Zbatimi të Punimeve" janë planet e skicuara të punimeve sipas Projekt Zbatimit, të Koncesionarit që i bashkëlidhen Shtojcës nr. 2 me miratimin e Projekt Zbatimit, me ndryshimet ose shtesat përkatëse.

"Skicat e Ndërtimit" janë skicat dhe llogaritjet e hartuara në përputhje me Kërkesat e Autoritetit Kontraktor dhe Ligjit, në të cilat paraqiten të gjitha dimensionet, llogaritjet dhe hollësitë e nevojshme për t'i dhënë mundësi Koncesionarit të realizojë Punimet.

"Test" do të thotë kryerja e verifikimeve të përputhshmërisë së ndërtimit të realizuar me lejen dhe projektin e miratuar.

"Situacioni" përfshin të gjitha skicat, llogaritjet, raportet etj., të miratuara nga Inxhinieri i Pavarur, në format elektronik dhe të shtypur në të cilat paraqiten evidencat faktike të miratuara të ndërtimit të përditësuara për të pasqyruar vendndodhjet, madhësitë, materialet e ndërtimit dhe hollësi të tjera të Punimeve të realizuara, duke bërë lidhjen me specifikimet dhe tabelat përkatëse.

"Faza e Ndërtimit" do të thotë periudha e kohës që rjedh nga Data e Fillimit të Punimeve deri në datën e përfundimit të Punimeve të ndërtimit.

"Punime" janë punimet ndërtimore në territorin tokësor të hregdetit, në territorin detar dhe ujor, i përcaktuar për të pranuar mjete lundruese dhe çdo punim tjetër që mund të nevojitet në lidhje me projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e Portit të Integruar në Triport Vlorë, nga Koncesionari sipas Projekt Zbatimit.

"Punime Ndërtimi", do të thotë të gjitha punimet që nevojiten për ndërtimin e Portit të Integruar në Triportin Vlorë dhe facilitetet përkatëse.

"Punime Mirëmbajtjeje" do të thotë të gjitha punimet që nevojiten për të siguruar mirëmbajtjen dhe funksionimin e duhur të infrastrukturës së ndërtuar prej koncesionarit në përputhje me ofertën dhe projekt zbatimin e miratuar të portit të Integruar në Triport Vlorë.

"Shërbime" janë shërbimet e mirëmbajtjes së Portit të Integruar në Triport Vlorë të parashikuara në Shtojcën 2.

"Riparim Kapital" është çdo mirëmbajtje që i bëhet Portit të Integruar, që nuk është Mirëmbajtje Rutinë.

"Kërkesa të Autoritetit Kontraktor" janë:

a) Kërkesat e Autoritetit Kontraktor për Punimet; dhe

b) Kërkesa e Autoritetit Kontraktor për Shërbimet.

"Kërkesat Teknike të Projektimit" do të thotë kërkesat teknike të projektimit në përputhje me legjislacionin për urbanistikën (Kërkesat Teknike të Projektimit);

"Kërkesat Teknike të Ndërtimit" do të thotë kërkesat teknike të ndërtimit në përputhje me legjislacionin për urbanistikën (Kërkesat Teknike të Ndërtimit);

Data e Përfundimit të Punimeve të Portit të Integruar në Triport Vlorë" është data kur lëshohet Certifikata paraprake e Përfundimit në përputhje me Punimet e këtij porti

"Periudha Ndërtimore" janë periudhat brenda periudhës së vlefshmërisë së Kontratës gjatë të cilave realizohen Punimet ndërtimore sipas Projekt Zbatimit.

"Defekt" është një defekt i punimeve të ndërtimit të portit të Integruar, që vjen si rezultat i mospërmbushjes me faj të detyrimeve të Koncesionarit në lidhje me Standardet.

"Periudha e Përgjegjësisë së Defekteve" në lidhje me Portin e Integruar në Triport Vlorë, ka kuptimin e periudhës prej 12 (dymbëdhjetë) Muajsh nga data e marrjes së Certifikatës Paraprake të Përfundimit të punimeve të ndërtimit të Portit të Integruar.

"Braktisje" ka kuptimin e ndërprerjes të Punimeve të parashikuara në Kontratë, përgjatë një

periudhe prej 90 (nëntëdhjetë) Ditë Pune të njëpasnjëshme. Dështimi për të kryer Punimet ose të një pjese të Punimeve brenda afateve të përcaktuara në Kontratë, për shkak të veprimeve ose mosveprimeve të Autoritetit Kontraktor apo në rast të një Ngjarjeje të Forcës Madhore, nuk do të konsiderohet si Braktisje.

"Certifikata e Përfundimit" (pas periudhës së garancisë) janë certifikatat e njëjta (përfshirë certifikatën paraprake të përfundimit), ose lejet e shfrytëzimit, në përputhje me Ligjet, të cilat vërtetojnë përfundimin në përputhje me Standardet dhe mundësinë për përdorim të çdo pjese të përfunduar të Portit.

"Efekt Negativ Thelbësor" do të thotë një pasojë apo grup pasojash që veç e veç apo së bashku e bëjnë të pamundur zbatimin nga Shoqëria Koncesionare apo Koncesionari të detyrimeve të lindura në bazë të kësaj Kontrate.

"Mospërmbushje nga Autoriteti Kontraktor" është secila prej ngjarjeve ose fakteve të mëposhtme:

a) Autoriteti Kontraktor nuk paguan pa shkaqe të përligjura brenda afateve të përcaktuara në këtë kontratë shumat përkatëse të Pagesës nga Autoriteti Kontraktor sipas Kontratës;

b) kalim i Kontratës tek të tretë nga Autoriteti Kontraktor në kundërshtim me dispozitat e saj;

c) shkelje e detyrimeve të Autoritetit Kontraktor parashikuar në këtë Kontratë, që e bën të pamundur ose e pengon sipas dhe vlerësimit të Inxhinierit të Pavarur, Koncesionarin që të realizojë Punimet për një periudhë më të gjatë se 3 (tre) Muaj;

d) çdo Ndryshim në Ligj i cili bën të pamundur ose e pengon në mënyrë të konsiderueshme zbatimin e Kontratës nga ana e Koncesionarit apo/dhe dëmton interesin e tij financiar dhe ekonomik sipas kësaj Kontrate;

e) çdo Veprim Material i Patavorshëm Qeveritar; dhe

f) çdo pengesë, dëm apo pamundësi e mospërmbushjes së detyrimeve sipas kësaj Kontrate si rezultat i mos Dorëzimit të Territorit të Projektit sipas kushteve të kësaj Kontrate. Për të shmangur cdo dyshim nuk konsiderohet Mospërmbushje nga Autoriteti Kontraktor nëse Koncesionari ka mundësi të vazhdojë punën pa iu cënuar siguria në punë, grafiku i punimeve pjesë e Projekt Zbatimit, si dhe kostot e ndërtimit dhe/apo mirëmbajtjes.

"Mospërmbushje nga Koncesionari" është çdo kusht i mëposhtëm që ndodh për faj të Koncesionarit dhe jo si rrjedhojë e veprimeve apo mungesës së veprimeve nga Autoriteti Kontraktor:

a) Shkelja e rëndësishme e detyrimeve të Koncesionarit, që:

(i) prek eecurinë e Punimeve dhe/ose mirëmbajtjes; ose
(ii) prek aftësinë e Autoritetit Kontraktor për të përmbushur detyrimet e parashikuara me Ligj dhe Kontratë; ose
(iii) prek përdorimin e Portit të Integruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Përdoruesit;

b) Shkelje e Vazhdueshme sipas Kontratës;

c) Në përfundim të procedurës së falimentit, vendimi përfundimtar i Gjykatës i cili pranon likujdimin kundër Koncesionarit, të lidhur me paaftësinë paguese,

d) Mosfillimi i Punimeve nga Koncesionari në përputhje me programin dhe/ose Shërbimet sipas Projektit brenda 2 (dy) Muajve nga Data e fillimit të Punimeve Ndërtimore kapitale;

e) Braktisja e Punimeve nga Koncesionari;

f) Mosrespektimi me faj i një date të përfundimit të fazës përkatëse brenda afatit përfundimtar për atë fazë, sipas përcaktimeve të bëra në grafikun e punimeve pjesë e Projekt Zbatimit;

g) Koncesionari nuk bën fillimisht dhe ne vazhdimësi Sigurimet e Nevojshme sipas Kontratës,

h) Koncesionari shkel kufizimet e vendosura në Kontratë për nënkontraktimin;

i) Koncesionari shkel kufizimet e vendosura mbi kalimin ose ndryshimin e kontrollit të parashikuara "Ndryshimi i Kontrollit"

"Aktet Korruptive" do të thotë akti i premtimit, i dhënies, i marrjes ose i marrëveshjes për të marrë para ose ndonjë send tjetër me vlerë, me qëllim korruptimi ose që perceptohet si korruptim, për të ndikuar tek një punonjës publik në kryerjen e detyrave të tij shtetërore si dhe aktet që sjellin përgjegjësi penale sipas Kodit Penal Shqiptar.

"Praktikë e Mirë e Industrisë" do të thotë praktikat, metodat, standardet, procedurat dhe rekomandimet që janë në përputhje me Ligjet e zbatuara përgjithësisht në ofrimin e punëve për sa i përket dhënies me Koncesion të projektimit, ndërtimit dhe mirëmbajtjes së portit të Integruar në Triport Vlorë, Koncesion i cili pritet në mënyrë të arsyeshme të realizohet nga një Kontraktor i aftë dhe me eksperiencë në rrethana të njëjta ose të ngjashme me praktika, metoda, standarde dhe procedura të cilat do të përfshijnë, pa kufizim, standardet shqiptare dhe evropiane *(ciliado qofshin më të larta nga një periudhë kohore në tjetrën)*. Pa u kufizuar në to, në implementimin apo zbatimin e këtyre standardeve do të përfshihen aktet ligjore e nënligjore shqiptare dhe evropiane.

"Ligjet" do të thotë çdo akt ligjor e nënligjor duke përfshirë edhe legjislacionin ndërkombëtar me fuqi detyruese në Republiken e Shqipërisë, që zbatohen për këtë koncesion dhe që rregullon apo ndikon drejtpërsëdrejti apo tërthorazi në këtë Koncesion.

"Ndryshim në Ligj" do të konsiderohet secili nga rastet e mëposhtme që ndodh pas datës së nënshkrimit të kësaj Kontrate, pa përfshirë Ndryshimet e Parashikueshme të Ligjit dhe që ka Efekt të Kundërt Thelbësor:

(i) miratimi, shpallja, modifikimi, ri-interpretimi ose shfuqizimi pas datës së kësaj Marrëveshje nga çdo autoritet qeveritar të çdo ligji, rregulli, akti nënligjor, rregulloreje ose urdhri, traktati, konvente, direktive, udhëzimi, politike që ka fuqinë e ligjit; ose

(ii) vendosja nga çdo autoritet qeveritar i çdo kushti material (ndryshe nga një kusht i cili është vendosur si trjedhojë e shkeljes nga Koncesionari të çdo Leje, Autorizimi, Licence) në lidhje me lëshimin, ripërtëritjen ose modifikimin e çdo Leje, Autorizimi, Licence pas datës së kësaj Marrëveshje e cila e bën kryerjen nga Koncesionari të secilit nga kushtet e kësaj marrëveshje të pamundur ose të pazbatueshme; ose

(iii) çdo Leje, Autorizim, Licencë e dhënë më parë, dhe që nuk prodhon efekte të mëtejshme për arsye të ndryshme nga shkelja ose neglizhenca e Koncesionarit ose çdo Leje, Autorizim, licencë e dhënë për një periudhë të kufizuar dhe e ripërtëritur me kushte të tjera (më të rënda/shtrënguese) nga ato të caktuara më parë.

(iv) Me kusht që çdo:

(a) vendosje e taksave, tatimeve, taksave lokale dhe/ose rritja e tyre herë pas here nga Autoriteti Qeveritar, dhe/ose

(b) vendosja e standardeve dhe kushteve të funksionimit, mirëmbajtjes dhe sigurisë që rrjedh nga legjislacioni për mjedisin, i ri ose i ndryshuar; dhe/ose

(c) imponimi i standardeve e kushteve të punësimit apo kushteve e punës të punëtorëve; dhe/ose

(d) çdo rregull ose rregullore të përcaktuara nga çdo autoritet tjetër regullator që ka juridiksion mbi Projektin lidhur me standardet e shërbimit;

nuk konsiderohen Ndryshim në Ligj.

"Ndryshim i Parashikueshëm i Ligjit" është propozimi për ndryshim i Ligjit, i bërë tridhjetë 30 (ditë kalendarike) përpara Datës së Dorëzimit të Ofertës përfundimtare në:

a) një projektligj të qeverisë ose projektligj të paraqitur nga ministria përkatëse për konsultim dhe i bërë publik masivisht, apo i cili i është njoftuar Koncesionarit; ose

b) një propozim i botuar në Fletoren Zyrtare.

"Ndryshim Cilësues i Ligjit" është:
a)Ndryshimi Diskriminues i Ligjit;
b)Ndryshimi Specifik i Ligjit;
c)një Ndryshim i Ligjit që ndodh pas nënshkrimit të kësaj kontrate, gjatë Periudhës Ndërtimore, dhe mirëmbajtjes dhe që sjell për pasojë një Shpenzim Kapital; ose
d)një Ndryshim i Ligjit që sjell për pasojë një TVSH të parimbursueshme në formën e TVSH-së në blerje të cilën e bën si shpenzim Koncesionari për çdo furnizim që merr për ta përdorur vetëm për realizimin e Punimeve ose Shërbimeve ose për të përmbushur detyrimet ose parashikimet e kësaj Kontrate (së bashku me TVSH-në në blerje të paguar si pjesë e shpenzimeve të përgjithshme administrative në lidhje me këto aktivitete) për aq sa Koncesionarit nuk i lind e drejta e rimbursimit apo kreditimit nga autoriteti tatimor shqiptar në lidhje me këtë TVSH në blerje.

"Ndryshim Diskriminues i Ligjit" është Ndryshimi i Ligjit, i cili zbatohet në mënyrë specifike a)për Projektin dhe jo për projekte të ngjashme; ose
b)për Koncesionarin/Shoqërinë Koncesionare dhe për asnjë Person tjetër; ose
c)për shoqëritë tregtare të angazhuara në projekte të ngjashme me Projektin dhe për asnjë Person tjetër;

"Ndryshim Specifik i Ligjit" është një Ndryshim i Ligjit që i referohet specifikisht ofrimit të Shërbimeve ose Punimeve të njëjta ose të ngjashme me Shërbimet dhe Punimet e parashikuara me këtë Kontratë ose zotërimit të aksioneve/kuotave të shoqërive tregtare aktiviteti kryesor i të cilave është ofrimi i Shërbimeve dhe Punimeve të ngjashme ose të njëjta me Shërbimet dhe Punimet e parashikuara me këtë Kontratë.

"Veprim Material i Pafavorshëm Qeveritar" nënkupton pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj kontrate si dhe përmbushjes së detyrimeve përkatëse nga ana e koncesionarit, të mos kryerjes nga ana e Autoritetit Kontraktor apo ndonjë Entiteti shtetëror, jo për faj të koncesionarit, të ndonjë detyre ligjërisht të detyrueshme për to, ose të ekzekutojë ose të zbatojë ndonjë të drejtë ligjore të Koncesionarit efekti i të cilave ndikon direkt mbi Koncesionarin dhe/ose provokon në mënyrë direkte ndonjë ndryshim të pafavorshëm aktual ose të mundshëm për Shoqërinë Koncesionare në shpenzimet apo të ardhurat, apo pozicionin ekonomik dhe financiar të saj, përveç rasteve të parashikuara në pikën (iv) të përkufizimit "Ndryshim në Ligj" të kësaj kontrate.

"Ndryshim nga Autoriteti Kontraktor" është ndryshimi i kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në bazë të nenit 34 të Kontratës.

"Ndryshim nga Koncesionari" është ndryshimi i propozuar nga Koncesionari në bazë të nenit 34 të Kontratës.

"Shpenzime Kapitale" nënkupton shpenzimet që klasifikohen nga Ligji apo parimet e përgjithshme të pranuara të kontabilitetit si Investime Kapitale ose Shpenzime Kapitale.

"Njoftim për Zgjidhje" në lidhje me secilën Palë, sipas rastit, do të thotë një njoftim me shkrim i njërës Palë drejtuar Palës tjetër që deklaron se do të ushtrojë të drejtën e saj për të filluar procedurat për zgjidhjen e kontratës.

"Normë Inflacioni" do të thotë norma zyrtare e inflacionit sipas përllogaritjeve të INSTAT-it në momentin kur lind nevoja për referim tek kjo normë.

"INSTAT" është Instituti i Statistikave i Shqipërisë.

"Risk i Pasigurueshëm" do të thotë një ngjarje apo situatë e cila nuk mbulohet apo është e përjashtuar në kushtet e përgjithshme të kontratave të policave të sigurimit që ofrohen në tregun shqiptar të sigurimeve nga kompanitë siguruese të licencuara nga Autoriteti Përkatës.

"Sigurimet e Nevojshme" janë sigurimet e identifikuara dhe mbajtura në përputhje me nenin 11 dhe të parashikuara sipas Shtojcës 7.

"**Sigurimi i Përgjegjësisë ndaj Palëve të Treta**" është sigurimi i përgjegjësisë ndaj palëve të treta që është pjesë e Sigurimeve të Nevojshme që duhen blerë dhe mbajtur në bazë të nenit 11 të Kontratës.

"**Sistemet e Cilësisë**" janë sistemet e menaxhimit të cilësisë të vëna në dispozicion në përputhje me Shtojcën 2.

"**Situatë e Jashtëzakonshme Gjeoteknike**" është ngjarja e një fenomeni gjeoteknik të paparashikuar, i cili mund të ndikojë negativisht në Punimet për projektimin, ndërtimin, mirëmbajtjen të Portit të Integruar në Triport Vlorë.

"**Shkak Kompensimi**" është:

a) shkelje me faj nga ana e Autoritetit Kontraktor e çdo detyrimi material të parashikuar me këtë Kontratë që e bën Koncesionarin të mospërmbushë detyrimet e parashikuara me këtë Kontratë, për një periudhë më të gjatë se 30 (tridhjete) Ditë Pune;

b) çdo ngjarje apo shkak tjetër që është parashikuar shprehimisht si Shkak Kompensimi në këtë Kontratë

"**Shkak Lehtësimi**" është:

a) zjarri ose shpërthimi ose çdo ngjarje e paparashikueshme e motit ekstrem (duke mbajtur në konsideratë natyrën e rajonit dhe kushtet klimatike që mbizotërojnë në rajon);

b) humbje apo dëmtimi aksidental, që u bëhet Punimeve ose objektit të koncesionit;

c) mungesë ose ndërprerja e energjisë, lëndës djegëse ose transportit, bllokimi i rrugëve, porteve, aeroporteve dhe i telekomunikacioneve, ose difekte të rënda në makineri;

d) Situata e Jashtëzakonshme Gjeoteknike;

e) vonesa në Punime për shkak të gërmimit, largimit ose Punimeve të tjera të nevojshme të kryera në lidhje me Objektet Arkeologjike ose të Trashëgimisë Kulturore, zbulimin e infrastruktures publike, Objekteve të paparashikueshëm (të vështirë për tu zhvendosur) zbulimin e lëndëve shpërthyese, mungesës së miratimeve dhe lejeve të Autoriteteve jo për faj të Koncesionarit, Forcë Madhore, Mospërmbushje të Kontratës nga Autoriteti Kontraktor, sipas parashikimeve përkatëse në Kontratë;

f) zbulimi i një Problemi të Trashëguar, që pengon Koncesionarin në përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në këtë Kontratë;

g) zbulimi i materialeve të rrezikshme, të paparashikueshme sipas Kontratës, që pengojnë Koncesionarin në përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në këtë Kontratë;

h) zbulimi i sistemeve të infrastrukturës publike, Objekteve të vështirë për tu zhvendosur, të paparashikueshme sipas Kontratës, që pengojnë Koncesionarin në përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në këtë Kontratë. Këtu përfshihet edhe çdo kërkesë e autoritetit kontraktor, që mund të detyrojë koncesionarin, të japë një zgjidhje të ndryshme nga ajo e planifikuar në projekt ide, apo projektzbatim;

i) greva, braktisja e punës nga punëmarrësit, ulja e tempit të punës ose çdo mosmarrëveshje tjetër zyrtare ose jo, për aq sa këto ngjarje zhvillohen në të gjithë sektorin përkatës dhe jo vetëm tek Koncesionari ose Pala Koncesionare; si dhe protesta që ka për pasojë mbylljen e Portit apo bllokimin e Kantierit, ose të një pjese të saj në çdo moment pas Datës së Hyrjes në Fuqi të Kontratës;

j) dështimi nga ana e Autoriteti Kontraktor për t'i vënë në dispozicion objektin dhe siguruar Koncensionarit hyrje-dalje në objekt në përputhje me grafikun e miratuar të punimeve, i cili mund të amendohet me marrëveshje mes paleve. Në cdo rast Autoriteti Kontraktor nuk do të konsiderohet në shkelje, në rast se Koncesionari ka mundësi të vijojë punën në pjese të tjera të portit;

si dhe

k) çdo rast tjetër i parashikuar në Kontratë si Shkak Lehtësimi,

me kusht që, për efekt të çlirimit nga përfundimi i Kontratës, një ngjarje e tillë të mos jetë shkaktuar nga shkelje të vullnetshme të Koncesionarit (ose një Pale Koncesionare) dhe që një ngjarje e tillë të mos jetë shkaktuar apo ndihmuar nga veprimi ose mosveprimi me faj i Koncesionarit (ose i një Pale Koncesionare).

1.2 Interpretime

Përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Kontratë:

1.2.1 Njëjësi përfshin shumësin dhe anasjelltas;

1.2.2 Referimi tek njëra gjini përfshin edhe gjininë tjetër dhe gjininë asnjanëse;

1.2.3 Referimi tek personat fizikë do të nënkuptojë edhe referimin tek personat juridikë të çdo lloj forme organizimi në kuptimin më të gjerë të mundshëm si dhe tek çdo lloj forme tjetër organizimi në kuptimin më të gjerë të mundshëm që nuk ka personalitet juridik;

1.2.4 Referimi tek një ligj, vendim, rregullore, urdhër apo procedurë përfshin referimin tek ai ligj, vendim, rregullore, urdhër apo procedurë siç është apo mund të jetë ndryshuar, shtuar kohe pas kohe dhe tek çdo akt tjetër i dalë në mbështetje e për zbatim të tyre.

1.2.5 Termat *"të kësaj"*, *"këtu"*, *"nëpërmjet kësaj ose nga kjo"*, *"në këtë"* dhe fjalë të ngjashme i referohen Kontratës në tërësi dhe jo ndonjë Neni, Paragrafi, Aneksi, Tabele, Bashkëlidhje ose Grafiku apo ndonjë nënndarje tjetër të kësaj Kontrate;

1.2.6 Parathënia dhe Anekset, Tabelat dhe Bashkëlidhjet të kësaj Marrëveshjeje do të përbëjnë pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje dhe referencat në Anekset, Tabelat dhe Bashkëlidhjet do të jenë referenca në Anekset, Tabelat dhe Bashkëlidhjet e kësaj Kontrate, përveç kur Palët bien dakord ndryshe;

1.2.7 Çdo frazë që fillon me fjalët *"përfshin"* ose *"duke përfshirë"*, *"në veçanti"*, *"për shembull"*, *të tilla si"* apo të ngjashme, do të kuptohet si ilustruese dhe pa kufizim ndaj përgjithshmërisë së fjaleve të Kontratës;

1.2.8 Referencat në *"këtë Kontratë"* ose *"kjo Kontratë Koncesioni"* do të interpretohen si referenca në këtë Kontratë siç mund të ndryshohet ose modifikohet në kohë, si dhe do të përfshijnë referencën në çdo dokument që e ndryshon, modifikon ose e shton atë, ose që është lidhur, bërë ose dhënë në zbatim ose në përputhje me kushtet e saj;

1.2.9 Sa herë që kjo Kontratë i referohet një numri "ditësh" ky numër do t'i referohet ditëve kalendarike, përveç kur specifikohen si Ditë Pune;

1.2.10 Çdo referencë në *"muaj"* ose *"vit"* do të interpretohet si referencë në një muaj kalendarik ose në një vit kalendarik;

1.2.11 Çdo frazë, fjalë, term dhe/ose shkurtim që fillon me shkronjë të madhe i përdorur në ndonjë Aneks, Bashkëlidhje a Dokument tjetër bashkangjitur do të ketë kuptimin e përcaktuar në Kontratë;

1.2.12 Titujt e përdorur për nenet, paragrafët, nën paragrafët, Anekset dhe tabela e përmbajtjes janë vetëm për lehtësi referimi dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin e Kontratës;

1.2.13 Në rast mospërputhjeje midis çdo fjalë me gërmë të madhe, termi të përcaktuar, frazë ose shkurtimi të parashikuara në Nenin 1.1 dhe një dispozite, fjale me gërmë të madhe, termi, fraze ose shkurtimi parashikuar gjetkë në këtë Kontratë, Aneks, Bashkëlidhje ose në një Dokument tjetër bashkangjitur tek çdo Bashkëlidhje, kuptimi i dhënë në Nenin 1.1 do të ketë përparësi ndaj kuptimit të dhënë në çdo Aneks, Bashkëlidhjeje a një Dokument tjetër bashkangjitur çdo Bashkëlidhjeje, përveç kur konteksti i kësaj Kontrate e kërkon ndryshe;

1.2.14 Një referim tek një Entitet Shtetëror nënkupton referimin tek juridiksioni i tij dhe nëse ky Entitet Shtetëror

(i) zëvendësohet nga një organ/ent tjetër, atëherë i referohet juridiksionit të këtij të fundit;

(ii) pushon së ekzistuari, atëherë i referohet juridiksionit të Entit Shtetëror, i cili ka kompetenca të njëjta ose të përafërta me Entin Shtetëror që ka pushuar së ekzistuari;

1.2.15 Kudo në Kontratë, termi *"Koncesionar"* do të nënkuptojë njëkohësisht edhe termin Subjekti për qëllime të veçanta "Shoqëri Koncesionare" dhe anasjelltas;

1.2.16 Pa paragjykim ndaj paragrafeve të mësipërm, nëse ka ndonjë konflikt apo mospërputhje ndërmjet neneve dhe Anekseve dhe/ose ndonjë shtojce të Anekseve dhe/ose çdo dokumenti tjetër të cilit i referohemi në këtë Kontratë, konflikti apo mospërputhja do të zgjidhet sipas rendit të mëposhtëm të përparësisë, duke bërë interpretimin me mirëbesim, nisur nga qëllimi që kanë patur Palët:

(i) Kontrata dhe Shtojcat e saj si më poshtë vijon:

Shtojca 1 Dokumentet e Procedurës Konkurruese për dhënien me Koncesion/PPP për Projektimin, Ndërtimin dhe Mirëmbajtjen e "Portit të Integruar" në Triport Vlorë

- Shtojca 2 Oferta e Koncesionarit, Plane Zbatimi të Punimeve
- Shtojca 3 Modeli Financiar
- Shtojca 4 Përcaktimi Hartografik (sipas VKM nr. 163, datë 17.03.2021)
- Shtojca 5 Grafiku i Punimeve
- Shtojca 6 Preventivi i Punimeve
- Shtojca 7 Sigurimet që Kërkohen
- Shtojca 8 Detyrat Kryesore të Inxhinierit të Pavarur
- Shtojca 9 Sigurimi i Kontratës

(ii) Projekti i zbatimit

1.2.17. Gjatë interpretimit kur ka mospërputhje mes dy neneve të Kontratës do të ketë përparësi neni që rregullon në mënyrë të posaçme çështjen e paqartë apo objekt mosmarrëveshjeje.

Neni 2

Koncesioni

2.1 Objekti i Koncesionit

Objekti i kësaj Kontrate është projektimi, ndërtimi dhe mirëmbajtja e "Portit të Integruar" në Triport Vlorë.

2.2 Periudha e Koncesionit

2.2.1 Koncesioni /Partneritet Publik Privat për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e "Portit të Integruar" në Triport Vlorë, jepet për një periudhë prej 10 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kontratës dhe përfundon në ditën e përvjetorit të 10-të të datës së hyrjes në fuqi. Megjithatë, në rastin e një zgjidhjeje përpara afatit 10 vjeçar, periudha e koncesionit do të nënkuptojë dhe do të kufizohet te periudha që fillon nga data e hyrjes në fuqi dhe mbaron në datën e zgjidhjes. Në rastin e zgjatjes së koncesionit pas afatit 10-vjecar, periudha e koncesionit do të nënkuptojë dhe do të kufizohet te periudha që fillon nga data e hyrjes në fuqi dhe mbaron në datën e zgjatjes së afatit të periudhës koncesionare.

2.2.2 Afati kohor i Kontratës mund të zgjatet, nëse është e nevojshme, për shkak të ndryshimeve të Kontratës, siç parashikohet në nenet 31, 32 dhe 33 të ligjit nr.125/2013 "Për koncesionet dhe Partneritetin publik privat" të ndryshuar, por ndryshimi do të realizohet pasi Palët bien dakord me shkrim. Çdo ndryshim do të jetë në formën e një aneksi dhe do të ndjekë procedurën e përcaktuar në legjislacionin në fuqi

2.3 Sipërfaqja e Portit

2.3.1 Duke pasur parasysh që Koncesionari ka rënë dakord të përmbushë detyrimet e tij sipas parashikimeve të kësaj Kontrate, Autoriteti Kontraktues nepërmjet kësaj Kontrate i njeh Koncesionarit të drejtën të hyjë, të marrë në dorëzim dhe të përdorë në përputhjet me Ligjet dhe këtë Kontratë, Sipërfaqen e "Portit të Integruar" në Triport Vlorë, siç përcaktohet hartografikisht në Shtojcën 4 me qëllim zbatimin e koncesionit në përputhje me parashikimet e kësaj Kontrate.

2.3.2 Koncesionari nuk do të Përdorë Sipërfaqen e "Portit të Integruar" në Triport Vlorë, siç përcaktohet hartografikisht në Shtojcën 4, për qëllime të tjera shtesë të paparashikuara

në këtë Kontratë, pa miratimin me shkrim të Autoritetit Kontraktues i cili jepet në çdo rast në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2.3.3 Informacioni në lidhje me objektin e Koncesionit dhe sipërfaqen e "Portit të Integruar" në Triport Vlorë (Asetet), prezumohen se janë siguruar në mirëbesim të plotë nga ana e Autoritetit Kontraktor, për të gjitha çështjet që lidhen me to. Autoriteti Kontraktor deklaron se do t'i sigurojë Koncesionarit, brenda një kërkese dhe afati te arsyeshëm, pa cenuar afatet e percaktuara në këtë kontratë, çdo informacion që ka lidhje me Objektin e Koncesionit dhe Asetet e Portit, për të cilat Autoriteti Kontraktor ka informacion apo do të ketë dijeni në të ardhmen, për aq sa lidhet me këtë objekt.

2.3.4 Autoriteti Kontraktues nuk garanton gjendjen e Sipërfaqes së "Portit të Integruar" në Triport Vlorë për sa i përket kushteve të cituara më poshtë dhe Koncesionari pranon Sipërfaqen e "Portit të Integruar" në Triport Vlorë "siç është dhe ku është" dhe deklaron e pranon se:

(i) ka inspektuar Sipërfaqen e "Portit të Integruar" në Triport Vlorë dhe zonën përreth tij dhe është dakord me gjendjen ekzistuese për sa i përket kushteve fizike, morfologjike, gjeo-fizike, gjeologjike dhe sizmike të Sipërfaqes së "Portit të Integruar" në Triport Vlorë;

(ii) është dakord lidhur me përshtatshmërinë klimatike, hidrologjike, gjeologjike, sizmike, etj. si dhe me kushtet ekzistuese të Sipërfaqes së "Portit të Integruar" në Triport Vlorë dhe zonës përreth në të cilën ndodhet kjo sipërfaqe, relievin dhe natyrën e dizenjove, punëve dhe materialeve që kërkohen për përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Kontrate;

Neni 3

Koncesionari dhe Shoqëria Koncesionare

3.1 Koncesionari me qëllim zbatimin dhe përmbushjen e kushteve të kësaj Kontrate është i detyruar, të themelojë një subjekt për qëllime të veçanta (SPV) në përputhje me legjislacionin shqiptar për Shoqëritë Tregtare, me shënimin para emrit "Shoqëri Koncesionare", të cilës i transferohen automatikisht të drejtat dhe detyrimet e kësaj Kontrate Koncesioni, nga momenti i njoftimit të AK për krijimin e Shoqërisë Koncesionare: Koncesionari duhet ti japë Autoritetit Kontraktues kopje origjinale (vërtetim njësia me origjinalin) të dokumentacionit të krijimit/themelimit dhe regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit të Subjektit për Qëllime të Veçanta (SPV) si dhe të ekstrakteve përkatëse brenda 45 (dyzet e pesë ditëve) nga data e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate.

3.2 Pavarësisht krijimit të SPV, Shoqëria Koncesionare dhe Koncesionari do të jenë përgjegjës në mënyrë solidare për përgjegjësitë dhe detyrimet në përmbushjen e kushteve të kontratës, gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj; duke filluar që nga momenti i hyrjes në fuqi të kontratës

3.3 Shoqëria Koncesionare do të themelohet duke pasur si ortakë/aksionarë shoqëritë që janë palë në kontratën e bashkimit të shoqërive të përzgjedhur si ofertuesi me i suksesshëm.

3.4 Shoqëria Koncesionare do të ketë si objekt të vetëm objektin e kontratës së koncesionit.

3.5 Gjatë Periudhës Koncesionare, ortakët/aksionarët e Shoqërisë Koncesionare nuk do të transferojnë paketën kontrolluese të aksioneve në favor të ndonjë pale të tretë, pa miratimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues. Autoriteti Kontraktues nuk mund të refuzojë pa shkaqe të arsyeshme ligjore dhe të argumentuara dhënien e këtij pëlqimi.

3.6 Për të shmangur çdo dyshim, për transferimin si më sipër si dhe transformin e kontratës së koncesionit/ppp do të zbatohen parashikimet e nenit 32 të ligjit me nr. 125/2013 "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat" të ndryshuar.

3.7 Koncesionari, me miratim të Autoritetit Kontraktues, vendos si garanci për financim në institucionet financiare, për realizimin e kësaj kontrate, vetëm të drejtat që rrjedhin nga kontrata e koncesionit.

Neni 4

Referencat ndaj Koncesionarit dhe Shoqërisë Koncesionare

4.1 Referencat ndaj Koncesionarit në këtë Kontratë, përveç atyre në pikën 2.1, pikën 12.1.1, të cilat i referohen të dyja Palëve, konsiderohen si referime vetëm tek Shoqëria Koncesionare; dhe

4.2 Nenet mbi përfundimin e parakohshëm, mbi pasojat e përfundimit të parakohshëm, mbi kompensimin për përfundimin e Kontratës, mbi llogaritjen dhe pagesën e kompensimit, mbi të drejtat e pronësisë intelektuale, mbi njoftimet, mbi Ligjin rregullues, dhe mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, dhe dispozitat përkatëse zbatohen, sipas rastit, për Koncesionarin ose për Shoqërinë Koncesionare.

Neni 5

Kushtet Paraprake

5.1 Pas nënshkrimit të saj nga Palët, dhe miratimin e saj nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, kjo kontratë hyn në fuqi me botimin e vendimit të miratimit të saj, në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë (në vijim "data e hyrjes në fuqi").

5.2 Pavarësisht nga parashikimet e pikës 5.1 dhe duke marrë në konsideratë dhe parashikimet e pikës 5.4, detyrimi i Shoqërisë Koncesionare për të filluar Punimet bëhet efektiv në datën, në të cilën përmbushet i fundit nga kushtet e përmendura më poshtë ("Data e Fillimit të Zbatimit të Kontratës"):

5.2.1 Nënshkrimi i Marrëveshjes së Drejtpërdrejtë midis Koncesionarit, Shoqërisë Koncesionare dhe nëse është e nevojshme nga Autoriteti Kontraktor dhe palës/palëve financuese;

5.2.2 Paraqitja nga ana e Shoqërisë Koncesionare te Autoriteti Kontraktor i Projekt Zbatimit

brenda 3 (tre) Muajsh nga Data e Hyrjes në Fuqi;

5.2.3 Miratimi i Projekt Zbatimit nga Autoriteti Kontraktor brenda 2 (dy) Muajsh nga paraqitja;

5.2.4 Lëshimi i lejeve të nevojshme nga ana e Autoritetit Kontraktor dhe Autoriteteve Përkatëse të tjera, me qëllim mundësimin e fillimit të zbatimit të Projekt Zbatimit;

5.2.5 Përmbyllja Financiare nga ana e Shoqërisë Koncesionare;

5.2.6 Përzgjedhja e Inxhinierit të Pavarur nga ana e Autoritetit Kontraktor, sipas dispozitave të kësaj Kontrate;

5.2.7 Dorëzimi i Territorit të Projektit nga ana e Autoritetit Kontraktor te Shoqëria Koncesionare në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate.

5.3 Afati maksimal për përmbushjen e këtyre kushteve do të jetë jo më shumë se 6 (gjashtë) Muaj nga Data e Hyrjes në Fuqi të Kontratës, përveç rasteve të përcaktuara në nenin 6 të kësaj Kontrate.

5.4 Shoqëria Koncesionare, në diskrecionin e saj të plotë dhe pas marrjes së pëlqimit me shkrim nga Autoriteti Kontraktor dhe nënshkrimit të proces verbalit të fillimit të punimeve, mund të fillojë Punimet duke zgjedhur të heqë dorë nga e drejta e saj për të kërkuar përmbushjen e ndonjërit prej kushteve paraprake sa më lart, apo duke lejuar përmbushjen e tij me vonesë. Kjo nuk do të konsiderohet heqje dorë e Koncesionarit nga të drejtat që ai ka në bazë të kësaj Kontrate.

Neni 6

Mospërmbushja e Kushteve Paraprake

6.1 Në rast se kushtet paraprake të përcaktuara në nenin 5 më sipër nuk janë përmbushur brenda 6 (gjashtë) Muajve nga Data e Hyrjes në Fuqi të kësaj Kontrate, Palët do të takohen për të vendosur për një rrugëzgjidhje për plotësimin e kushteve paraprake të mbetura.

6.2 Në rast se kushtet paraprake të mbetura nuk janë përmbushur ende brenda 1 (një) Muaji nga data e propozuar, ose brenda ndonjë datë tjetër, për të cilën Palët do të bien dakord me shkrim, kjo Kontratë do të zgjidhet dhe:

6.2.1 Në rast se Autoriteti Kontraktor nuk i plotëson kushtet që lidhen me të, Autoriteti Kontraktor i paguan Shoqërisë Koncesionare, si kompensim i rënë dakord paraprakisht, vetëm kostot e pjesëmarrjes në zhvillimin e procedurave konkuruese/të tenderit, si dhe zhbllokon dhe kthen Garancinë e Kontratës. Pagimi i këtyre kostove nga Autoriteti Kontraktues të bëhet mbështetur në prova të vlefshme të dokumentuara dhe të vendosura në dispozicion të Autoriteti Kontraktor, nga Koncesionari.

6.2.2 Në rastin e mospermbushjeve nga Shoqëria Koncesionare të kushteve paraprake për faj të Shoqërisë Koncesionare, Autoriteti Kontraktor do të mbajë Garancinë e Kontratës.

6.3 Pavarësisht nga sa më lart dhe pavarësisht nga dispozitat e tjera në këtë Kontratë, nëse në përputhje me pikën 5.4 Shoqëria Koncesionare pranon të fillojë Punimet pa e marrë në Dorëzim Territorin e Projektit në mënyrë të plotë dhe të çliruar plotësisht nga të gjithë pretendimet e palëve të treta mbi të, Shoqëria Koncesionare bie dakord që ajo nuk mund ta përdorë këtë shkelje të Autoritetit Kontraktor si shkak zgjidhje të parakohshme të Kontratës deri sa të kalojnë 12 (dymbëdhjetë) muaj nga Data e Hyrjes në Fuqi të kontratës. Megjithatë, vonesa e Autoriteti Kontraktor për të Dorëzuar Territorin e Projektit do të konsiderohet sipas rastit si Shkak Lehtësimi dhe/ose Shkak Kompensimi, veç e veç ose së bashku.

6.4 Përveç sa më sipër, në rast se kushtet paraprake nuk do të permbushen dhe kontrata do të zgjidhet për shkak të këtyre mospërmbushjeve, palët nuk do të kenë të drejta dhe detyrime të mëtejshme.

Neni 7

Data hyrjes në fuqi të Kontratës

Pas nënshkrimit të kontratës nga palët, dhe miratimin e saj nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, kjo kontratë hyn në fuqi me botimin e vendimit të miratimit të saj, në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë (në vijim "data e hyrjes në fuqi"/ "data efektive").

Neni 8

Garancia e Kontratës

8.1 Para nënshkrimit të kontratës, Koncesionari me qëllim përmbushjen e detyrimeve të kontratës gjatë gjithë periudhës koncesionare, i paraqet Autoritetit Kontraktues një sigurim kontrate të parevokueshëm dhe të pagueshëm me kërkesën e parë, në formën e një garancie bankare të pakushtëzuar, të lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë në Shqipëri ose, në formën e një police sigurimi të pakushtëzuar, të lëshuar nga shoqëri sigurimi që operon në tregun e sigurimeve në Shqipëri.

8.1.1 Sigurimi Kontratës do të jetë në masën 5 % të vlerës së kontratës. Dështimi për të dhënë sigurimin e kontratës në formën dhe vlerën e kërkuar, do të rezultojë në anulimin e kontratës dhe humbjen e sigurimit të Ofertës së kontraktorit. Sigurimi i kontratës është aneks dhe pjesë përbërëse dhe e pandarë e kësaj kontrate.

8.1.2 Koncesionarit i njihet e drejta të kërkojë tek autoriteti pas certifikimit të punimeve, me anë të një kërkese me shkrim, të argumentuar dhe të shoqëruar me dokumente realizimi, reduktim të vlerës së sigurimit të kontratës, në mënyrë përpjesëtimore me realizimin e investimit në përputhje me grafikun e zbatimit të kontratës dhe fazën përkatëse. Autoriteti Kontraktues, pas certifikimit të punimeve, me kërkesë të Koncesionarit do t'i kthejë këtij të fundit, brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës, një pjesë të vlerës së sigurimit të kontratës. Kjo masë e sigurimit të kontratës mund të reduktohet në mënyrë përpjesëtimore gjatë ekzekutimit të kontratës, por, në asnjë rast, gjatë kohëzgjatjes së saj, nuk mund të jetë më e vogël se 25 % e vlerës fillestare të sigurimit.

8.2 Përgjegjësia e Koncesionarit

Koncesionari do të jetë përgjegjës për pagimin e primit përkatës për plotësimin e shumës së Garancisë së Kontratës sa herë që kjo shumë preket/ulet në përputhje me Kontratën për kryerje pagesash të çdo natyre të përcaktuar në këtë kontratë në favor të Autoritetit Kontraktues. Ky plotësim do të kryhet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kryerja e ndonjë pagese të tillë.

8.3 Penalitetet

Nëse Koncesionari dështon të plotësojë brenda afatit të lartpërmendur shumën e Garancisë së Kontratës, Autoriteti Kontraktues ka të drejtën për të zbatuar dhe tërhequr një penalitet në shumën 10,000 lekë për çdo ditë vonesë, por gjithsesi jo më shumë se 3 (tre) muaj. Pas kalimit të 3 (tre) muajve Autoriteti Kontraktues do të kërkojë zgjidhjen me pajtim nëpërmjet takimeve të njëpasnjëshme deri në arritjen e një përfundimi në mënyrë të shkruar. Nëse palët nuk arrijnë një marrëveshje të shkruar, Autoriteti Kontraktues kundrejt një njoftimi paraprak prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh ka të drejtë të filloje procedurat për zgjidhjen e kontratës sipas përcaktimeve të kësaj kontrate.

8.4 Periudha e negocimit

Palët do të bisedojnë për zgjidhjen e çështjes me pajtim brenda një afati 30 ditor, me të drejtë zgjatje të këtij afati edhe për 30 ditë të tjera. Nëse Palët dështojnë të arrijnë një marrëveshje në përfundim të këtij afati, Kontrata do të zgjidhet në përputhje me parashikimet e kësaj kontrate, përkatësisht neni 37.

Neni 9

Njësia e Zbatimit të Projektit (NjZP)

Brenda 1 (një) muaji nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Kontrate, me Urdhër të Ministrit të Autoritetit Kontraktues krijohet Njësia e Zbatimit të Projektit Koncesionar ("NjZP") pranë AK. Përbërja dhe përgjegjësitë e NjZP do të përcaktohen në Urdhrin e Ministrit. Ky Urdhër nuk do të përmbajë detyrime të Koncesionarit ndaj NjZP. Puna e NjZP do të vazhdojë gjatë gjithë Periudhës Koncesionare.

Neni 10

Nënkontratat

10.1 Autoriteti kontraktues mund:

a) t'i kërkojë koncesionarit që të japë kontrata që janë minimalisht 30 për qind e vlerës totale të kontratës së koncesionit të palëve të treta, duke siguruar, në të njëjtën kohë, një mundësi për tenderuesit që ta rrisin këtë përqindje, ndërkohë që kjo përqindje minimale specifikohet në kontratën e koncesionit;

b) të kërkojë nga tenderuesit që të tregojnë në ofertat e tyre përqindjen e vlerës totale të kontratës që ata planifikojnë t'u caktojnë palëve të treta.

10.2. Për nënkontraktimin e partneriteteve publike private, që realizohen si kontrata të punëve publike ose të shërbimit publik, zbatohen dispozitat përkatëse të ligjit të prokurimit publik, në përputhje me rregullat.

Neni 11

Sigurimet

11.1 Kërkesa për sigurim

11.1.1 Shoqëria Koncesionare blen dhe mban sigurimet e nevojshme në bazë të Shtojcës nr. 7 me kushtet e përcaktuara në këtë Shtojcë dhe këtë Nen.

11.1.2 Shoqëria Koncesionare blen dhe mban, si dhe siguron që Nënkontraktorët të blejnë dhe mbajnë, të gjitha Sigurimet e Nevojshme me Ligj.

11.1.3 Shoqëria Koncesionare është përgjegjëse të përballojë me shpenzimet e veta pagesën e të gjitha Kostove Faktike të Sigurimeve, të primeve në lidhje me Sigurimet e Nevojshme dhe sigurimet e kërkuara me Ligj, si dhe përballon rreziqet që lidhen me shumat e zbritshme dhe/ose tepricat ose pamjaftueshmërinë e shumës së siguruar. Fakti që Shoqëria Koncesionare është ose jo e detyruar të blejë sigurimin e risqeve të caktuara sipas kësaj Kontrate, nuk e cenon Palën që përballon pasojat financiare të një risku të tillë.

11.2 Kushtet dhe afatet e sigurimeve të detyrueshme dhe të nevojshme

11.2.1 Sigurimet e Detyrueshme dhe të Nevojshme:

a) Do të bëhen me kompani sigurimi me pëlqimin e Autoritetit Kontraktor, miratim i cili nuk duhet të mos jepet apo vonohet pa pasur arsye;

b) Do të mbajë të pacënuar kërkesat për dëmshpërblim të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor;

c) Parashikojnë 30 (tridhjetë) ditë kalendarike përpara njoftimit me shkrim për anulimin, mos-rinovimin apo ndryshimin që i duhet dërguar Autoritetit Kontraktor; dhe

11.2.2 Secila nga Palët do të shmangë kryerjen e veprimeve, ose do të kryejë të gjitha veprimet e arsyeshme, me qëllim mënjanimin e situatave që do të rezultonin në refuzimin nga ana e një siguruesi të Sigurimit të Detyrueshëm dhe të Nevojshëm për të paguar një kërkesë për dëmshpërblim në bazë të çdo Sigurimi të Nevojshëm ku ajo palë është e siguruar, ose e bashkësiguruar, ose një Person shtesë i siguruar.

11.3 Dokumentacioni

Shoqëria koncesionare i jep Autoritetit Kontraktor:

11.3.1 Me kërkesë, kopje të të gjitha policave të sigurimit që lidhen me Sigurimet e Detyrueshme dhe të Nevojshme (bashkë me çdo informacion tjetër të kërkuar nga

Autoriteti Kontraktor në lidhje me këtë polica sigurimi) dhe Autoriteti Kontraktor ka të drejtë t'i inspektojë ato gjatë orëve të zakonshme të punës.

11.3.2 Dëshmi se primet e pagueshme sipas të gjitha policave të sigurimit, të lidhura me Sigurimet e Nevojshme, janë paguar dhe sigurimet e nevojshme janë në fuqi të plotë, në përputhje me këtë nen dhe Shtojcën 7; dhe

11.3.3 Sa më shpejt që të jetë e mundur, por gjithsesi në apo përpara datës së rinovimit, kopje të dokumentit provizor të sigurimit në lidhje me Sigurimet e Detyrueshme dhe të Nevojshme, nëse është e zbatueshme.

11.4 Mosblerja dhe mosmbajtja e sigurimeve të detyrueshme dhe të nevojshme

11.4.1 Nëse Shoqëria Koncesionare është në shkelje të pikës 11.1, Autoriteti Kontraktor i kërkon Shoqërisë Koncesionare të paraqesë menjëherë pranë tij Sigurimet e Detyrueshme dhe të Nevojshme me vlefshmëri të plotë. Nëse Koncesionari është në shkelje të këtij Neni, Autoriteti Kontraktues mund të paguajë çdo prim të kërkuar për të mbajtur në fuqi sigurimet e përcaktuara në pikën 11.1, ose mund të blejë vetë një sigurim të tillë të nevojshëm dhe në secilin rast, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë t'i rikuperojë këto shuma nga Koncesionari me anë të një kërkese me shkrim.

11.4.2 Asnjë parashikim i këtij Neni 11 nuk e detyron Shoqërinë Koncesionare të blejë një sigurim në lidhje me një Risk të Pasigurueshëm, përveçse kur shkaku që një risk është bërë i pasigurueshëm, është një veprim ose mosveprim me faj i Koncesionarit, ose i një Pale të Koncesionarit.

11.5 Risku i pasigurueshëm

Në rast Risku të Pasigurueshëm, si do të jetë subjekt negocimi me marrëveshje midis Palëve.

11.6 Rehabilitimi dhe pagesa e të hyrave

Të gjitha të ardhurat e marra nga sigurimi sipas çdo police të dëmit fizik do të përdoren për riparimin, rehabilitimin dhe zëvendesimin e secilës pjesë/pjesëve të Portit në lidhje me të cilat janë marrë të ardhurat ose për kompensimin e tyre.

11.7 Plani i Rehabilitimit

Nëse bëhet një kërkesë për dëmshpërblim sipas një Police të dëmtimit fizik:

11.7.1 Koncesionari i dorëzon Autoritetit Kontraktor sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur, por në çdo rast brenda njëzet 20 (njëzet) Ditësh Pune pas bërjes së kërkesës, një plan ("Plani i Rehabilitimit") të përgatitur nga Koncesionari për kryerjen e Punimeve të nevojshme ("Punimet e Rehabilitimit") për të riparuar, rehabilituar ose zëvendësuar dëmtimet, të cilat janë subjekt i kërkesës apo kërkesave përkatëse në përputhje me pikën 11.7.2;

11.7.2 Plani i Rehabilitimit përcakton:

a) identitetin e Nënkontraktorëve të Ndërtimit ose Nënkontraktorëve të Mirëmbajtjes; dhe

b) Kushtet dhe afatet e propozuara, në të cilat Punimet e Rehabilitimit duhet të realizohen (duke përfshirë datën kur Porti i Integruar do të bëhet plotësisht i shfrytëzueshëm);

c) Autoriteti Kontraktor brenda 10 (dhjetë) Ditësh Pune nga marrja e Planit të propozuar të Rehabilitimit, njofton Koncesionarin nëse Autoriteti Kontraktor:

- e pranon apo jo identitetin e Nënkontraktorit, të përcaktuar për të realizuar Punimet rehabilituese në Planin e propozuar të Rehabilitimit; dhe
- (duke vepruar në mënyrë të arsyeshme) kërkon informacion shtesë; ose
- Pranon apo hedh poshtë, në varësi të përfshirjes së komenteve të Autoritetit Kontraktor (të cilët mund të ofrojnë një propozim për ndryshimet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor), kushtet dhe afatet e Planit të propozuar të Rehabilitimit;

d) Për të vendosur nëse duhet të shprehë pëlqimin e vet për çështjet në bazë të pikës 11.7.2 "c" Autoriteti Kontraktor vepron në mënyrë të arsyeshme;

e) Nëse Autoritetit Kontraktor nuk e jep pëlqimin e tij, apo bën komente për ndonjë pjesë të Planit të propozuar të Rehabilitimit, atëherë në njoftimin që ai paraqet në bazë të pikës 11.7.2 "c", parashtron arsyet apo komentet e tij me hollësi të mjaftueshme, me qëllim që t'i japë mundësi Koncesionarit të kuptoje natyrën dhe shkallën e komenteve dhe të vlerësojë nëse pëlqimi i Autoritetit Kontraktor është refuzuar pa pasur ndonjë arsye. Koncesionari e ndryshon dhe ia riparaqet Planin e Rehabilitimit Autoritetit Kontraktor për shqyrtim në bazë të pikes 11.7.2 "c" dhe nëse plani prapë nuk miratohet, secila nga Palët mund t'ia referojë çështjen Inxhinierit të Pavarur për vendim përfundimtar; dhe

f) Nëse Autoriteti Kontraktor nuk e paraqet njoftimin e tij në bazë të pikes 11.7.2 "c" brenda 10 (dhjetë) Ditësh Pune nga marrja e Planit të propozuar të Rehabilitimit, ose kur Autoriteti Kontraktor nuk ka kërkuar në mënyrë të arsyeshme ndonjë informacion tjetër nga Koncesionari brenda 10 (dhjetë) Ditësh Pune nga marrja e Planit të propozuar të rehabilitimit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor e ka refuzuar Planin e propozuar të Rehabilitimit. Kur Plani i propozuar i Rehabilitimit konsiderohet i refuzuar nga Inxhinieri i Pavarur, Palët takohen për të diskutuar Planin e propozuar të Rehabilitimit brenda 10 (dhjetë) Ditësh Pune nga kërkesa e Koncesionarit për një gjë të tillë dhe nga marrja nga Autoriteti Kontraktor e informacionit të mëtejshëm, nese është rasti. Dispozitat e pikës 11.7, pikës 11.7.2 "c", (i-iii) dhe të pikes 11.7.2 "d" zbatohen për pëlqimin apo refuzimin nga Autoriteti Kontraktor të Planit të propozuar të rehabilitimit në një takim të tillë dhe, nëse përsëri ky Autoritet nuk e jep pëlqimin e tij, secila nga Palët mund t'ia referojë çështjen Inxhinierit të Pavarur për vendim përfundimtar.

Neni 12

Detyrimet e Palëve

12.1 Garancitë dhe Detyrimet e Koncesionarit

Koncesionari deklaron, garanton, dhe merr përsipër përpara Autoritetit Kontraktor se:

12.1.1 Është themeluar dhe vepron në përputhje me Ligjin;

12.1.2 Në dijeninë e tij, nuk ka ndodhur asnjë ngjarje që do ta bënte Koncesionarin të mos ishte në gjendje të përmbushte detyrimet e tij dhe nuk ekziston asnjë fakt ose ngjarje që mund të çonte në mospërmbushjen e detyrimeve të Koncesionarit; dhe

12.1.3 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Koncesionari nuk ka kryer asnjë veprim të ndaluar nga Ligji.

12.1.4 Koncesionari nëpërmjet kësaj Kontrate dhe në përputhje me parashikimet e saj e me ligjet ka të drejtën dhe detyrimin ekskluziv (i) të hartojë Dokumentacionin e Projektit të "Portit të Integruar" në Triport Vlorë, (ii) të realizojë Punimet sipas Projekt-Zbatimit të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, (iii) të sigurojë financimin për zbatimin e Projekt Zbatimit, (iv) të realizojë mirëmbajtjen në "Portit të Integruar" në Triport Vlorë (në shkallën e përcaktuar në këtë Kontratë) në përputhje me ofertën.

12.1.5 Koncesionari më tej garanton, deklaron dhe merr përsipër përpara Autoritetit Kontraktor se:

a) Çdo angazhim që buron nga Dokumentet e Projektit përfaqëson një angazhim të vlefshëm dhe të zbatueshëm të Koncesionarit dhe secili nga Dokumentet e Projektit është në formën që kërkohet nga Ligji;

b) Dokumentet e Projektit janë përgatitur dhe zbatimi i tyre dhe kryerja e punës nga Koncesionari nuk bie ndesh me:

i)Asnjë Ligj;
ii)Aktin e themelimit ose dokumente të tjera të brendshme të Koncesionarit; ose
iii)Detyrimet e Koncesionarit;

12.1.6 Ndaj Koncesionarit nuk është ngritur asnjë padi dhe nuk ka asnjë proces gjyqësor, arbitrazhi ose procedurë administrative në pritje për t'u zgjidhur apo ndonjë mosmarrëveshje tjetër e cila është duke u zgjidhur në ndonjë mënyrë tjetër, dhe Koncesionari nuk ka dijeni, me gjithë kujdesin e treguar, për ndonjë mosmarrëveshje në pritje për t'u zgjidhur apo mosmarrëveshje që mund të lindë në të ardhmen, që mund të ketë Efekt Negativ Thelbësor.

12.1.7 Ka ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura dhe gëzon të gjitha tagrat dhe kompetencat për të negociuar, lidhur, ekzekutuar dhe përfunduar këtë Kontratë dhe se kjo e fundit është angazhuese, detyruese, e vlefshme dhe e ekzekutueshme kundrejt tij.

12.1.8 Gjatë gjithë kohëzgjatjes së koncesionit në rast se do të transferojë pjesët apo aksionet e Shoqërisë Koncesionare do ta bëjë sipas përcaktimeve në këtë kontratë.

12.1.9 Për sa kohë që kontrata është në fuqi, do të sigurojë në mënyrë të vazhdueshme dhe të pandërprerë punët,shërbimet, pavarësisht pretendimeve që mund të ketë apo padive që mund të ketë ngritur ndaj Autoritetit Kontraktues dhe/ose të tretëve të lindur gjatë aktivitetit të shoqërisë koncesionare, në të kundërt Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të zgjidhë kontratën dhe sipas rastit të shpërblehet për dëmin e pësuar;

12.1.10 Nuk është paguar nga ai apo për llogari të tij asnjë shumë në para apo çfarëdo lloj interesi ndaj çdo funksionari, punonjësi apo përfaqësuesi të Autoritetit Kontraktues me qëllimin për të influencuar ose për t'u përpjekur të influencojë tek ata për lidhjen apo për të përfituar avantazhe në lidhje me këtë Kontratë;

12.1.11 Do të aplikojë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, për çdo leje, licencë apo autorizim, apo çdo miratim tjetër të nevojshëm për zbatimin e kësaj kontrate.

12.1.12 T'i japë Autoritetit Kontraktues kopje origjinale *(ose vërtetim njesoj me origjinalin)* të policave së sigurimit që kërkohen nga kjo Kontratë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga lindja e detyrimit për t'u pajisur me to;

12.1.13 Koncesionari garanton Autoritetin Kontraktues se i ka të gjitha të drejtat e pronësisë intelektuale *(nese eshte rasti)* që nevojiten apo përdoren për përmbushjen e Kontratës.

12.1.14 Koncesionari deklaron dhe garanton se gjatë realizimit të punimeve dhe shërbimeve të Portit të Integruar në Triport Vlorë, aktiviteti i hyrjes, daljes dhe ankorimit të anijeve të peshkimit, që aktualisht ankorohen, do të vijojë dhe nuk do të pengohet nga kryerja e punimeve dhe shërbimeve të Portit të Integruar në Triport Vlorë.

12.2 Angazhimet e Koncesionarit

12.2.1 Koncesionari duhet:

a) brenda mundësive të tij, të mbledh informacionin e nevojshëm ligjërisht të disponueshëm dhe të aksesueshëm për plotësimin e detyrimeve të tij, sipas kësaj Kontrate, nëse ky informacion është i mundshëm për t'u gjetur ose është vënë në dispozicion nga Autoritetet Përkatëse, pasi të jetë kërkuar në mënyrë të rregullt, duke përfshirë:

i) informacionin në lidhje me natyrën, vendndodhjen dhe gjendjen e Territorit të Projektit;

dhe

ii) informacionin që lidhet me Objektet Arkeologjike ose Objektet e Trashëgimisë Kulturore, zonat me interes arkeologjik, shkëmbor ose natyror, kushtet dhe mundësitë që ofron vendi dhe cilësinë e strukturave ekzistuese.

b) të garantojë për aplikimin pranë Autoritetit Kontraktor dhe Autoriteteve Përkatëse kompetente në përputhje me kushtet dhe afatet ligjore për marrjen e lejeve, licencave dhe autorizimeve të nevojshme për zbatimin e Projektit në rast se leja/licenca/autorizimi do të dalin në emër të Shoqërisë Koncesionare. Në rastet kur këto leje/licenca/autorizime do të dalin në emër të Autoritetit Kontraktor, atëherë Shoqëria Koncesionare angazhohet që t'i vërë në dispozicion sa më parë Autoritetit Kontraktor të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në mënyrë që ky i fundit të bëjë aplikimin tek Autoritetet Përkatëse në përputhje me Ligjin.

c) të garantojë që do të kryejë të gjitha studimet e nevojshme mjedisore në përputhje me Ligjin nr 10431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar dhe ofertën e tij.

12.2.2 Koncesionari pranon dhe konfirmon se, merr përgjegjësi të plotë për ecurinë e Projektit, përshtatshmërinë e Skicave ekzistuese të Ndërtimit dhe për çdo informacion tjetër që i është dhënë nga Autoriteti Kontraktor përpara nënshkrimit të Kontratës.

12.2.3 Koncesionari deklaron dhe garanton se, në asnjë rast nuk do të kërkojë ndaj autoritetit apo Enteve shtetërore ndonjë dëmshpërblim, penalitet apo nuk do të ngrejë çfarëdo lloj pretendimi padie në lidhje me zbatimin e kontratës për fakte, rrethana apo ngjarje për të cilat ka pasur, ka dijeni në mënyrë të shkruar;

12.2.4 Të gjitha kontratat që do të lidhen nga Koncesionari me të tretë nuk do të kenë periudhë vlefshmërie më të gjatë se data e përfundimit të Periudhës Koncesionare, në të kundërt përgjegjësi/debitor ndaj të tretëve lidhur me zbatimin e këtyre kontratave do të mbetet Koncesionari.

12.3 Koncesionari angazhohet se:

12.3.1 Do të informojë menjëherë Autoritetin Kontraktor sapo të marrë dijeni se kundra tij mund të filloje apo mund të jepet një vendim në një proçes gjyqësor apo administrativ apo një proçes arbitrazhi, kur një mosmarrëveshje e tillë do të shkaktonte ndonjë Efekt Negativ Thelbësor.

12.3.2 Nuk do të heqë dorë nga aktiviteti i tij tregtar ose një pjese të tij, apo ndonjë nga aktivet e përfshira në kryerjen e detyrimeve të tij sipas kësaj Kontratë (përveçse gjatë ecurisë së zakonshme të biznesit apo për qëllime zëvendësimi), të cilat do të kishin Efekt Negativ Thelbësor në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate, përgjatë gjithë kohëzgjatjes të zbatimit të saj, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor (qoftë përmes një transaksioni të vetëm ose një numër transaksionesh, të lidhura ose jo me Projektin). Autoriteti Kontraktor pas vlerësimit të kërkesës dhe dokumentave në dispozicion duhet ta japë pëlqimin nëse vlerëson që transferimi nuk ka një efekt negativ mbi detyrimet e Shoqërisë Koncesionare/Koncesionarit. Pëlqimi i Autoriteti Kontraktor do të konsiderohet i dhënë nëse ai nuk ka kthyer përgjigje brenda 20 (njëzet) Ditë Pune nga data kur Koncesionari ka depozituar kërkesën pranë Autoritetit Kontraktor.

12.3.3 Koncesionari, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor (i cili nuk duhet të mos jepet ose të vonohet në mënyrë të paarsyeshme), nuk mund të japë hua, kredi, garanci, ose kompensim për përfitimin e ndonjë Personi, ose të marrë përsipër (me ose pa pagesë) ndonjë borxh të ndonjë Personi, përveç rasteve kur kjo parashikohet nga Dokumentacioni i Projektit ose Marrëveshjet e Financimit.

12.4 Garancitë dhe informacioni i dhënë nga Autoriteti Kontraktor

12.4.1 Të dhënat e vëna në dispozicion

a)Autoriteti Kontraktor brenda mundësisë së tij, ka vënë në dispozicion të Koncesionarit materiale, dokumente dhe të dhëna të caktuara të lidhura me Projektin dhe Territorin e Projektit dhe çështje të tjera, të cilat lidhen ose mund të lidhen me Projektin dhe Territorin e Projektit (duke përfshirë, pa kufizim, Projekt Idenë ("Të Dhënat e Vëna në Dispozicion")

b)Autoriteti Kontraktor bën përpjekjet e tij të arsyeshme për të vënë në dispozicion të Shoqërisë Koncesionare çdo material tjetër, që mund të bjerë në dorë të tij gjatë kohëzgjatjes së Kontratës dhe që është i llojit që do të ishte bërë i njohur në rast se do ekzistonte në kohën e vënies në dispozicion të të dhënave të disponueshme dhe që ka efekt për zbatimin e Kontratës së Koncesionit nga Shoqëria Koncesionare. Materiale të tilla shtesë konsiderohen Të Dhëna Të Vëna në Dispozicion në kohën që jepen (por jo më parë).

12.4.2 Autoriteti Kontraktor garanton se:

a)Ka ndjekur të gjitha procedurat Ligjore në lidhje me organizimin e procedurës konkuruese si dhe ato të përzgjedhjes së Koncesionarit si dhe ka konsultuar, ndjekur dhe respektuar manualet, udhëzimet dhe rekomandimet e publikuara nga autoritete të tjera, të cilët ngarkohen me Ligj të mbikëqyrin sektorë të tjerë, subjekte të Ligjeve të veçanta.

b)Autoriteti Kontraktor garanton se në rastin e punimeve të kryera nga një palë e tretë, në siperfaqen e projektit ose në pjesë të caktuara të tij, Koncesionari apo Shoqëria Koncesionare nuk do të jetë përgjegjës për mangësi, dëmtime apo efekte të këtyre Punimeve mbi Punimet e bëra nga Shoqëria Koncesionare ose ndryshime apo rregullime të Projektit nga ana e Shoqërisë Koncesionare, që dalin të nevojshme si pasojë e mangësive, dëmtimeve apo efekteve të punimeve të bëra nga palë të treta.

c)Autoriteti Kontraktor garanton se do të marrë në kohë të gjitha masat e nevojshme, në lidhje me planifikimet buxhetore të financimeve që janë detyrim i Autoritetit Kontraktor apo që lindin si detyrime të tij, si rezultat i zbatimit të kësaj Kontrate.

d)Autoriteti Kontraktor angazhohet se do të ndërmarrë të gjithë hapat e duhur dhe do të japë të gjithë asistencën e nevojshme konkrete si dhe do të mbajë kontakte të vazhdueshme me Autoritetet Përkatëse kompetente, qendrore ose vendore, të cilat kanë kompetencë për lëshimin e lejeve dhe licencave përkatëse kundrejt Shoqërisë Koncesionare në mënyrë që këto autoritete të pajisin Koncesionarin/Shoqërinë Koncesionare me lejet/licencat përkatëse, në kohë dhe pa vonesë në lidhje me zbatimin e Kontratës, për sa kohë që ky i fundit ka përmbushur detyrimet e tij për aplikim në përputhje me Ligjin.

e)Autoriteti Kontraktor garanton se do të kryejë pa vonesë dhe në kohë të gjithë Pagesat dhe detyrimet e tjera financiare kundrejt Shoqërisë Koncesionare, të parashikuara në këtë Kontratë.

ë)Autoriteti Kontraktor angazhohet se gjatë gjithë vlefshmërisë së kësaj Kontrate, vetë apo kur është rasti në bashkëpunim me Autoritetet e tjera Përkatëse, do të sigurojë gëzimin e qetë të të drejtave që Koncesionarit i lindin nga kjo Kontratë.

f)Autoriteti Kontraktor merr përsipër që, gjatë kohëzgjatjes së Kontratës, të bejë përpjekjet e tij më të mira për të ndihmuar Shoqërinë Koncesionare në përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Kontrate dhe në përputhje me të, si dhe të mos krijojë asnjë pengesë kundrejt Shoqërisë Koncesionare në lidhje me zbatimin e Kontratës.

g)Pavarësisht nga çdo klauzolë tjetër e kësaj Kontrate, Autoriteti Kontraktor në të gjitha rastet bashkëpunon me mirëbesim dhe i ofron asistencë të arsyeshme Koncesionarit apo Shoqërisë Koncesionare.

i)Autoriteti Kontraktor do të marrë të gjitha masat që në bashkëpunim me Autoritetet Përkatëse t'i sigurojë Shoqërisë Koncesionare venddepozitime për mbetjet nga Punimet që do të kryhen në Kantier sipas projekt zbatimit të miratuar. Autoriteti Kontraktor do të bashkëpunojë me Shoqërinë Koncesionare për përzgjedhjen e këtyre venddepozitimeve në mënyrë që (i) ato të jenë në distancë të arsyeshme nga Territori i Projektit, në mënyrë që Koncesionari të mos ketë kosto të paarsyeshme shtesë për transportin e mbetjeve (inerte, dhera etj) dhe (ii) të mos pengojë planet e zhvillimit të miratuara të Autoriteteve Përkatëse që kanë pronësinë e truallit ku planifikohet të bëhet venddepozitimi. Kostoja e transportit dhe e sistemimit të mbetjeve do të jenë në ngarkim të Shoqërisë Koncesionare.

j)Autoriteti Kontraktor do të bëjë të gjitha përpjekjet që, pas Datës së Nënshkrimit të kësaj Kontrate, Shoqëria Koncesionare të mos të jetë subjekt i ndonjë Tatimi apo Takse të re që ndonjë Autoritet Përkatës apo Autoriteti Kontraktor mund të aplikojë mbi Shoqërinë Koncesionare për shkak të zbatimit të kësaj Kontrate lidhur me Punimet në Kantier. Për të shmangur çdo dyshim, kjo klauzolë nuk mbulon Tatimet apo Taksat që kanë karakter të përgjithshëm dhe aplikohen mbi të gjitha subjektet në Republikën e Shqipërisë.

k)Nëse brenda periudhës së koncesionit, do të ketë strategji për zhvillimin e mëtejshëm të Portit të Integruar dhe zgjerimin e këtij porti me qëllim përmbushjen e kërkesave të kohës, koncesionari në përputhje me nenin 33 të ligjit nr.125/2013 "Për koncesionet dhe Partneritetin publik privat" të ndryshuar, mund të kërkojë kryerjen e punëve apo shërbimeve shtesë dhe për këtë ai duhet t'i paraqesë për miratim Autoritetit Kontraktues, Projektin dhe dokumentacionin përkatës. Autoriteti Kontraktues do të shqyrtojë dhe kthejë përgjigje për kërkesën e Koncesionarit brenda 60 ditëve kalendarike, në përputhje me rregullat, kushtet dhe afatet e përcaktuara në nenin 33 të ligjit nr.125/2013 "Për koncesionet dhe Partneritetin publik privat" të ndryshuar.

Neni 13

Bashkëpunimi dhe Dokumentacioni

13.1 Bashkëpunimi i Shoqërisë Koncesionare

13.1.1 Shoqëria Koncesionare ka detyrimin të bashkëpunojë me Autoritetin Kontraktor dhe të zbatojë këtë Kontratë si dhe të gjitha angazhimet e marra përsipër sipas Dokumentacionit të Ofertës, Dokumentacionit të Tenderit, siç këto të fundit janë pasqyruar në mënyrë përfundimtare në Projekt Zbatimin e dorëzuar pranë Autoritetit Kontraktor.

13.1.2 Përveç rasteve kur është parashikuar ndryshe në këtë Kontratë si dhe/ose kur veprimi dhe mosveprimi i Shoqërisë Koncesionare varet drejtpërdrejt dhe/ose vjen si rezultat i një veprimi dhe/ose mosveprimi të Autoritetit Kontraktor, Shoqëria Koncesionare pa pëlqimin e shprehur me shkrim të Autoritetit Kontraktor:

a) Nuk kryen asnjë veprim me anë të të cilit një pjesë e Projektit përfundimtar do të bëhej i pavlefshëm (duke hequr dorë prej tij, duke mosvepruar, duke dhënë njoftim për përfundimin e tij, ose në çdo formë tjetër), ose do të ndryshohej; ose

b) Nuk heq dorë, ose nuk mund të mos ushtrojë të drejtat e tij sipas Dokumenteve të Projektit, kur, dhe për sa kohë që një veprim i tillë do të bëhej shkak ose do të kishte

gjasa të bëhej shkak, që Shoqëria Koncesionare të mos ishte në gjendje të plotësonte detyrimet e saj.

13.2 Bashkëpunimi i Autoritetit Kontraktor

13.2.1 Autoriteti Kontraktor i ofron Koncesionarit dhe Shoqërisë Koncesionare çdo bashkëpunim të arsyeshëm që mund të kërkohet për realizimin e kësaj Kontrate nga Autoriteti Kontraktor. Autoriteti Kontraktor nuk është i detyruar të ofrojë ndonjë bashkëpunim për ndreqjen e ndonjë shkeljeje të Kontratës të shkaktuar nga Shoqëria Koncesionare ose një Palë e Koncesionarit.

13.2.2 Autoriteti Kontraktor merr përsipër që, gjatë kohëzgjatjes së Kontratës, të bëjë përpjekje të arsyeshme për të asistuar Koncesionarin në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate dhe në përputhje me të.

13.3 Koncesionari i dërgon për njohje Autoritetit Kontraktor, brenda 30 (tridhjetë) Ditësh Pune nga nënshkrimi i tyre, kopje të vërtetuara të të gjitha marrëveshjeve, amendamenteve ose dokumenteve të tjera, të cilat ndryshojnë ose anullojnë një Dokument të Projektit, ose të ndonjë Marrëveshjeje Financimi të lidhur nga Koncesionari, ose të çdo dokumenti të ri të Projektit, ose të një Marrëveshjeje Financimi të lidhur nga Koncesionari, që nuk është e nevojshme të nënshkruhet nga Autoriteti Kontraktor dhe ky i fundit nuk është palë.

13.4 Amendamente në Marrëveshjet e Financimit

13.4.1 Koncesionari nuk mund të ndryshojë Marrëveshjet e Financimit ose të pranojë ndonjë financim tjetër nga ai i parashikuar në Marrëveshjet e Financimit ose nga Aksionerët pa pëlqimin paraprak të Autoritetit Kontraktor. Autoriteti Kontraktor në këtë rast merr mendimin paraprak të ministrisë përgjegjëse për financat.

13.4.2 Për të shmangur çdo dyshim, ndryshimi i strukturës së financimit të Kontratës nuk rrit kostot e Autoritetit Kontraktor përtej pagesave të disponueshmërisë të parashikuara në modelin financiar.

13.4.3 Autoriteti Kontraktor i përgjigjet çdo kërkese për dhënie pëlqimi, të bërë nga Koncesionari në përputhje me këtë Klauzolë, brenda 20 (njëzet) ditësh pune. Pranimi i një financimi tjetër nga ai sipas Marrëveshjeve të Financimit, ose nga Aksionarët, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor, dhe çdo ndryshim në një Marrëveshje Financimi, për të cilën nuk ka dhënë pëlqimin Autoriteti Kontraktor që më parë, është shkelje kontrate nga Koncesionari dhe, sipas Klauzolës, nuk ka asnjë efekt ndaj Autoritetit Kontraktor sipas kësaj Marrëveshjeje ose Marrëveshjes së Drejtpërdrejtë.

13.5 Rifinancimi

13.5.1 Koncesionari i jep Autoritetit Kontraktor, në çdo kohë, pa vonesë dhe pa pagesë, hollësi për rifinancimin, dhe justifikim për supozimet mbi të cilat është bazuar ai dhe çdo material tjetër të rëndësishëm rrethanor që palët e Koncesionarit posedojnë.

13.5.2 Koncesionari merr pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor për çdo Rifinancim Kualifikues i cili në asnjë rast nuk do të sjellë kosto shtesë për Autoritetin Kontraktues përtej pagesave të parashikuara në modelin financiar. Autoriteti Kontraktor

në këtë rast merr mendimin paraprak të ministrisë përgjegjëse për financat. Si Autoriteti Kontraktor ashtu edhe Koncesionari do të veprojnë me mirëbesim në lidhje me çdo Rifinancim.

13.5.3 Në rast se ndonjë ndryshim i një Marrëveshje Financimi, jo për arsye që lidhen me Koncesionarin, është një Rifinancim Kualifikues, Koncesionari do të njoftojë Autoritetin Kontraktor për termat dhe kushtet e Rifinancimit siç parashikohet në pikën më sipër. Pasi Autoriteti Kontraktor vihet në dijeni nga Koncesionari për ndryshimin e Marrëveshjes së Financimit, ai ka të drejtë të japë apo të refuzojë pëlqimin për ndryshimet e ndodhura. Autoriteti Kontraktor në këtë rast merr mendimin paraprak të ministrisë përgjegjëse për financat.

Neni 14

Përfaqësuesit e Palëve

14.1 Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor

14.1.1 Përfaqësuesi i Autoriteti Kontraktor është një Person i autorizuar për të përfaqësuar Autoritetin Kontraktor në lidhje me realizimin e kësaj Kontrate.

14.1.2 Përfaqësuesi i Autoriteti Kontraktor mund të jetë kreu i njësisë së zbatimit të Projektit, që krijohet nga Autoriteti Kontraktor dhe ushtron funksionet e tij deri në përmbushjen e kushteve të kësaj Kontrate, ose një Person tjetër që caktohet nga Autoriteti Kontraktor në bazë të këtij Neni.

14.1.3 Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të zëvendësojë Përfaqësuesin e tij, për të cilin njofton me shkrim 10 ditë pune përpara Shoqërinë Koncesionare.

14.1.4 Veprimet ose udhëzimet e Përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktor, për aq sa parashikohen këtu, konsiderohen veprime ose udhëzime të Autoritetit Kontraktor, përveçse kur Autoriteti Kontraktor e njofton Shoqërinë Koncesionare paraprakisht që një veprim ose udhëzim i caktuar nuk është veprim ose udhëzim i Autoritetit Kontraktor.

14.1.5 Çdo kërkesë për t'i dhënë informacion ose dokumente Autoritetit Kontraktor, sipas Kontratës, është një kërkesë që dokumente të tilla t'i bëhen të njohura Përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktor, përveçse kur Autoriteti Kontraktor e vë në dijeni Shoqërinë Koncesionare për një Person tjetër ose institucion të cilit i duhen dërguar dokumente të tilla.

14.2 Përfaqësuesi i Shoqërisë Koncesionare

14.2.1 Përfaqësuesi i Shoqërisë Koncesionare është një Person i autorizuar për të përfaqësuar Shoqërinë Koncesionare në lidhje me zbatimin e kësaj Kontrate.

14.2.2 Shoqëria Koncesionare mund ta zëvendësojë Përfaqësuesin e saj, duke i dërguar një njoftim me shkrim Autoriteti Kontraktor të paktën 10 (dhjetë) Ditë Pune më përpara.

14.2.3 Veprimet ose udhëzimet e Përfaqësuesit të Shoqërisë Koncesionare, për aq sa ato parashikohen këtu, konsiderohen veprime ose udhëzime të Shoqërisë Koncesionare, përveçse kur Shoqëria Koncesionare e njofton Autoritetin Kontraktor që një veprim ose udhëzim i caktuar nuk është veprimi ose udhëzimi i saj.

Neni 15

Dorëzimi i objektit të koncesionit nga AK te koncesionari

15.1 Autoriteti kontraktor brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e kontratës/data efektive e saj, duhet të sigurojë se nepërmjet Portit të Peshkimit Vlorë do të bëhet dorëzimi i sipërfaqes objekt të kësaj kontrate tek koncesionari.

15.2 Autoriteti Kontraktor i jep mundësi Shoqërisë Koncesionare të hyjë e të dalë në Territorin e Projektit dhe e lejon ta përdorë atë territor, pa e penguar gjatë gjithë kohëzgjatjes së Kontratës.

15.3 Autoriteti Kontraktor është dakord se çdo kosto, dëm, pengesë apo vonesë në zbatimin e kësaj Kontrate nga ana e Koncesionarit, pasi vërtetohet nga ana e Inxhinierit të Pavarur, për arsye që lidhen me Shpronësimet apo marrjen në kontroll të Territorit të Projektit, nga Autoritetet Përkatëse ose palët e treta do të jetë një Shkak Lehtësimi dhe/ose Shkak Kompensimi per koncesionarin, përveç rasteve kur kjo vonesë është shkaktuar nga veprimet apo mosveprimet me faj të Shoqërisë Koncesionare.

15.4 Në Datën e Përfundimit të Kontratës, Shoqëria Koncesionare i kthen Autoritetit Kontraktor të gjithë Territorin e Projektit, në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate.

15.5 Territori i Projektit nuk përdoret nga Shoqëria Koncesionare për ndonjë qëllim tjetër, të ndryshëm nga çka parashikohet në këtë Kontrate duke respektuar kërkesat e zbatueshme të Ligjit dhe kushtet e kësaj Kontrate.

15.6 Koncesionari nuk ka asnjë detyrim për të gjitha shpenzimet apo Taksat (nëse mund të këto të ulla), për regjistrimin e pronësisë, apo të përdorimit të Territorit të Projektit në Zyrat Vendore të Agjencisë Shtetërore te Kadastrës (ASHK) dhe/ose kosto të tjera që rrjedhin nga aktet ligjore apo nënligjore në lidhje me regjistrimin e pronësisë së kësaj toke apo përdorimin e saj, do të përballohen nga Autoritetit Kontraktor.

15.7 Në rastin e identifikimit të materialeve të rrezikshme dhe rrjeteve të infrastrukturës publike apo zbulimi i objekteve gjatë punimeve të paparashikueshme të vështira për to zhvendosur sipas parashikimeve të nenit 20.7 dhe nenit 20.8, Autoriteti Kontraktues duke treguar vëmendje maksimale gjate lazës së vënies së territorit të objektit në dorëzim me qëllim shmangien e çdo pengese për Koncesionarin merr masa vetë ose nëpërmjet institucioneve përgjegjëse përkatëse në varësi të saj që brenda një afati 60 (gjashtëdhjetë) ditë të pastrojë territorin nga këto materiale dhe dorëzimin pa vonesa te Koncesionari. Në rast mosveprimi të AK-së sipas kësaj pike do të zbatohen parashikimet e pikës 20.7.3 dhe pikës 20.8.3 të kësaj kontrate.

Neni 16

Territori i Punimeve të Projektit dhe Kushtet e Tokës

16.1 Inspektimi i Territorit të Projektit

16.1.1 Pa cënuar përfitimet (të drejtat) e Shoqërisë Koncesionare sipas kësaj Kontrate, Shoqëria Koncesionare garanton se:

a) Aq sa ishte e mundur ka inspektuar dhe kontrolluar Territorin e Projektit dhe mjediset përreth dhe, sipas rastit, të gjitha strukturat që gjenden në gjithë hapësirën e Territorit të Projektit;

b) aq sa është e mundur, duke marrë në konsiderate dhe përdorur kujdesin e zakonshëm profesional si dhe metodat profesionale të zbatueshme në Shqipëri, është njohur dhe ka marrë dijeni për (i) natyrën e përgjithshme të kushteve klimatike, hidrologjike, gjeologjike, ekologjike, mjedisore dhe të përgjithshme të Territorit të Projektit dhe rrethinat e tij, (ii) natyrën e tokës dhe nëntokës, (iii) formën dhe natyrën e Territorit të Projektit, (iv) rrezikun e dëmtimit apo të dëmit ndaj pronave pranë tij, apo rreziqet që prekin Territorin e Projektit dhe pronarët e pronave të tilla, (v) natyrën e materialeve (natyrale ose jo) që do të gërmohen, dhe (vi) natyrën e Projektit, punën, impiantet dhe materialet e nevojshme për Projektin.

16.1.2 Autoriteti Kontraktor nuk është përgjegjës para Shoqërisë Koncesionare për ndonjë pasaktësi, mosveprim, papërshtatshmëri për ndonjë qëllim, apo për panjaftueshmëri të ndonjë lloji, cilado qoftë, të ndonjë vrojtimi topografik, që Autoriteti Kontraktori i paraqet dhe i vendos në dispozicion apo i miraton Shoqërisë Koncesionare, kur konstatimi i këtyre mangësive me efekte negative ndaj Shoqërisë Koncesionare do të ishte lehtësisht i mundshëm për t'u evidentuar nga Koncesionari/Shoqëria Koncesionare duke ushtruar kujdes të zakonshëm profesional si dhe në respekt të Praktikave të Mira të Industrisë.

16.1.3 Pavarësisht nga çdo parashikim i ndryshëm në këtë Kontratë, Koncesionari apo Shoqëria Koncesionare nuk do të jetë përgjegjës për dëmtime, Defekte, riparime dhe vonesa në zbatimin e Punimeve, të cilat kanë ardhur si rezultat i ndryshimeve të projekt zbatimit gjatë periudhës së zbatimit të punimeve të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

16.1.4 Në raste të situatave të tilla të parashikuara nga paragrafi 16.1.3 më sipër, pas aprovimit nga Inxhinieri i Pavarur, çdo vonesë apo kosto për Shoqërinë Koncesionare, e cila vjen si pasojë e këtyre ngjarjeve dhe elementeve do të konsiderohet, sipas rastit, si Shkak Lehtësimi dhe/ose Shkak Kompensimi, veç e veç ose së bashku.

Neni 17

Objektet Arkeologjike ose Objektet e Trashëgimisë Kulturore

Zbulimi i relikave kulturore, arkeologjike, fosile, turma varrezash dhe përmendore, mbetje të kaluara artistike dhe çdo send tjetër me vlerë arkeologjike, gjeologjike dhe historike në vendndodhjen e Sheshit që rezulton në ndërhyrjen e punimeve të koncesionarit do të deklarohen për të vepruar

konform legjislacionit në fuqi. Koncesionari duhet të njoftojë autoritetin kontraktor për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e njësisë së zbatimit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

Neni 18

Kërkesat Mjedisore dhe Pëlqimet e Nevojshme

18.1 Gjatë kohëzgjatjes së Kontratës Shoqëria Koncesionare do të veprojë në përputhje të plotë me kërkesat e lejeve mjedisore të dhëna dhe legjislacionin në fuqi për lejet e mjedisit.

18.2 Rehabilitimi

18.2.1 10 (dhjetë) Ditë Pune përpara fillimit të Punimeve, Palët do të nënshkruajnë një procesverbal konstatimi (që mund të përmbajë apo t'i referohet dhe dokumentacionit audioviziv) për gjendjen e Territorit të Projektit ("Procesverbali i Konstatimit").

18.2.2 Shoqëria Koncesionare merr përsipër që, pas përfundimit të Punimeve, të rehabilitojë pjesën e Territorit të Projektit që nuk është objekt i këtij koncesioni (të tillë si zonat me instalime, zonat ku janë vendosur pajisjet, instrumentet e nevojshme për realizimin e punimeve dhe çdo zonë tjetër të përdorur nga Koncesionari më parë), duke i kthyer ato në gjendje të mëparshme sipas Proces-Verbalit të Konstatimit.

18.3 Lejet Ekzistuese dhe Miratimet e Nevojshme të Autoritetit Kontraktor

18.3.1 Autoriteti Kontraktor i miraton Shoqërisë Koncesionare të gjitha lejet dhe miratimet e nevojshme të Autoritetit Kontraktor, të cilat disponohen dhe janë kompetencë e Autoritetit Kontraktor, dhe bën të gjitha përpjekjet që Autoritetet Përkatëse të bëjnë të njëjtën gjë me lejet dhe miratimet që janë në kompetencë të këtyre autoriteteve, menjëherë pas aplikimit të Shoqërisë Koncesionare, me qëllim që kjo e fundit të fillojë dhe përfundojë Punimet në përputhje me Projekt Zbatimin.

18.3.2 Në rastin kur Autoriteti Kontraktor apo një Autoritet Përkatës nuk e jep në kohën e duhur lejen ose miratimin e nevojshëm, me qëllim fillimin dhe vazhdimin e Punimeve në përputhje me Projekt Zbatimin, atëherë kjo do të konsiderohet si Shkak Lehtësimi, përveç rasteve kur Shoqëria Koncesionare nuk ka përmbushur kërkesat dhe formalitetet ligjore përkatëse.

18.3.3 Në rastin kur një leje ekzistuese ose miratimi i nevojshëm i Autoritetit Kontraktor apo i një Autoriteti Përkatës hiqet, revokohet, ndryshohet (jo me kërkesë të Shoqërisë Koncesionare), pezullohet ose ndryshe deklarohet të pavlefshme, për shkak të një veprimi të gabuar ose të një mosveprimi që nuk ka ardhur si rrjedhojë e veprimeve dhe/apo mosveprimeve të Shoqërisë Koncesionare, atëherë kjo do të konsiderohet si Shkak Lehtësimi.

18.4 Autoriteti Kontraktor do të jetë përgjegjës për aplikimin dhe marrjen e të gjitha lejeve që dalin në emër dhe për llogari të tij. Dokumentacioni ndihmës për këto aplikime përgatitet nga Shoqëria Koncesionare. Shoqëria Koncesionare do të jetë përgjegjëse për aplikimin dhe përmbushjen e të gjitha kërkesave dhe formaliteteve ligjore që duhen për marrjen e të gjitha lejeve dhe miratimeve shtesë (nëse duhen të tilla pas lejeve dhe miratimeve fillestare) të nevojshme pranë Autoritetit Kontraktor apo Autoriteteve Përkatëse, vetëm në rastet kur

aplikimi dhe/ose marrja e këtyre lejeve apo miratimeve shtesë bëhet në emër dhe për llogari të Shoqërisë Koncesionare, ose dokumentacioni shtesë duhet të paraqitet edhe në emër të Shoqërisë Koncesionare. Autoriteti Kontraktor garanton dhe anagazhohet se do të bëjë çdo përpjekje për të mbështetur Shoqërinë Koncesionare në marrjen e të gjitha lejeve dhe miratimeve të nevojshme, si dhe do të bëjë të gjitha përpjekjet për të siguruar që, në varësi të përmbushjes nga ana e Koncesionarit të të gjitha kërkesave dhe formaliteteve ligjore, lejet të lëshohen dhe miratohen nga ana e Autoriteteve Përkatëse. Në rastin kur lejet apo miratimet shtesë jepen në emër dhe për llogari të Autoritetit Kontraktor, atëherë Shoqëria Koncesionare është përgjegjëse për përgatitjen e kërkesave të nevojshme që Autoriteti Kontraktor të aplikojë për marrjen e këtyre lejeve dhe miratimeve. Në rast të vonesave në zbatimin e detyrimeve të Shoqërisë Koncesionare sipas kësaj Kontrate, të shkaktuara si pasojë e mos dhënies apo vonesave të lëshimit të lejeve dhe miratimeve nga Autoritetet Përkatëse apo Autoritetit Kontraktor, jo për faj të Shoqërisë Koncesionare, atëherë këto vonesa mund të përbëjnë një Shkak Lehtësimi dhe në rast të kostove të shtuara, Shkak Kompensimi.

Neni 19

Dokumentacioni i projektit

19.1. Projekt Ideja

19.1.1. Koncesionarit i janë vënë në dispozicion nga Autoriteti Kontraktor gjurmë dhe informacione të tjera në lidhje me Projektin ("Projekt Ideja"). Projekt Ideja është pjesë e Dokumentacionit të Tenderit Shtojca 2. Shoqëria Koncesionare ka të drejtë t'i modifikojë Skicat e Ndërtimit e të Projektimit gjatë hartimit të Projekt Zbatimit, duke patur në vëmendje Shtojcën 4.

19.1.2. Projekti i hollësishëm përfundimtar do të konsiderohet në këtë Kontratë si Projekt Zbatimi (në vijim "Projekt Zbatimi"), dhe pas miratimit të tij, do të bëhet pjesë integrale e kësaj Kontrate. Në rast të një mospërputhje me Projekt Idenë ka përparësi Projekt Zbatimi i Miratuar.

19.1.3. Shoqëria Koncesionare harton Projekt Zbatimin dhe siguron që të gjitha Skicat e Ndërtimit të hollësishme përfundimtare të projektimit në kuadër të Projekt Zbatimit të jenë në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktor dhe Autoritetit Përkatës si dhe rregullave të përcaktuara në legjislacionin përkatës për projektimin.

19.1.4. Shoqëria Koncesionare e dorëzon Projekt Zbatimin tek Autoriteti Kontraktor brenda 3 (tre) Muajsh nga Data e Hyrjes në Fuqi të Kontratës. Pas kryerjes së opinioneve teknike nga institucionet përgjegjëse të ngarkuara me ligj dhe akte nënligjore, Autoriteti Kontraktor e dërgon për shqyrtim dhe miratim Projektin tek Autoriteti Përkatës, i cili duhet të shprehet në lidhje me projektin e propozuar brenda 20 (njëzet) Ditëve Pune dhe pas miratimit nga ky autoritet, Autoriteti Kontraktor njofton Shoqërinë Koncesionare për vendimin e këtij të fundit.

19.1.5. Shoqëria Koncesionare harton Projekt Zbatimin në mënyrë të tillë që të jetë në përputhje me Projekt Idenë, specifikimet teknike, ofertën e tij, si dhe standardet e përcaktuara në Dokumentacionin e Tenderit. Autoriteti Kontraktor angazhohet maksimalisht dhe bën përpjekjet për marrjen e të gjitha lejeve të nevojshme dhe miratimet përkatëse për Projekt Zbatimin.

19.1.6. Çdo dokumentacion i Projekt Zbatimit i krijuar nga Shoqëria Koncesionare në kuadër të një skice të hollësishme përfundimtare të projektimit i dorëzohet Autoritetit Përkatës kompetent për miratim. Autoriteti Kontraktor bën komentet e tij për Dokumentacionin e Projekt Zbatimit, nëse ka, dhe i komunikon ato tek Shoqëria Koncesionare brenda 20 (njëzet) Ditësh Pune nga dorëzimi. Komentet e Autoritetit Kontraktor lidhen vetëm me rastet kur Projekt Zbatimi nuk është në përputhje me kërkesat e Dokumentacionit të Tenderit, me përmbajtjen e Dokumentave të Ofertës fituese të paraqitur nga Koncesionari, si dhe Ligjin dhe me standartet teknike në fuqi.

19.1.7. Në rastin kur Autoriteti Kontraktor paraqet komente, atëherë brenda 5 (pesë) Ditëve Pune nga marrja e tyre Palët takohen për të diskutuar mbi komentet e paraqitura. Shoqëria Koncesionare ka afat 20 (njëzet) Ditë Pune për të rregulluar Projekt Zbatimin në përputhje me komentet dhe për t'a dorëzuar Projekt Zbatimin e rregulluar tek Autoriteti Kontraktor. Pas dorëzimit nga ana e Shoqërisë Koncesionare, Autoriteti Kontraktor ka një afat 10 (dhjetë) Ditë Pune nga Data e Dorëzimit të Projekt Zbatimit, për të miratuar këtë të fundit. Në rast se Autoriteti Kontraktor nuk shprehet brenda një afati prej 10 (dhjetë) Ditësh Pune, ndërkohë që ky projekt zbatim i rregulluar është miratuar nga Inxhinieri i Pavarur, atëherë ai quhet i miratuar.

Neni 20

Ndërtimi

20.1. Shoqëria Koncesionare do t'i kryejë Punimet Ndërtimore në përputhje me afatin 36 (tridhjetë e gjashtë) mujor nga data e hyrjes në fuqi të Kontratës së Koncesionit/PPP, ku përfshihet dhe afati jo më shumë se 6 muaj per aplikime/pajisje me lejet e nevojshme, të percaktuar në Dokumentacionin e Tenderit, Dokumentacionin e Ofertës, shtojcën 5 si dhe në përputhje me Standartin e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor, përveç rasteve të shtyrjeve të afateve që mund të ndodhin në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate.

20.2. Shoqëria Koncesionare do të marrë masat që në objektin që do të ndërtojë të parashikojë dhe verë në dispozicion ambientet e nevojshme për organet e kapitenerise, policisë kufitare, doganës dhe institucioneve të tjera të nevojshme sipas projektit të miratuar nga organi administrative fundor vendimmarrës.

20.3. Volumet periodike të Punimeve të kryera gjatë periudhës së afatit të përcaktuar për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e Portit të Integruar në Triport Vlore, si dhe dokumentacioni i ruajtur nga Shoqëria Koncesionare në lidhje me to, do të shërbejnë vetëm për qëllim deklarimi dhe orientimi dhe nuk do të shërbejnë si referencë për pagesat (me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 20.3.). Situacionet e Punimeve të kryera që do të hartohen nga Shoqëria Koncesionare, do të çertifikohen nga Inxhinieri i Pavarur në baza Mujore.

20.4. Nëse Koncesionari gjatë fazës së ndërtimit, pengohet për një periudhë më të gjatë se 3 muaj, nga Autoriteti Kontraktues apo nga Entitet Shtetërore, duke e pasur të pamundur në këtë rast vijimin e punës për ndërtimin e projektit sipas kësaj Kontrate koncesioni, e konstatuar, vlerësuar, konfirmuar, kjo pamundësi për vazhdimin e punimeve dhe nga Inxhinieri i Pavarur, atëherë Koncesionari mund të rishikojë Modelin Financiar, i cili do të përshtatet me punimet e kryera por në asnjë rast nuk do të lejkalohet vlera e pagesës së Autoritetit Kontraktor përcaktuar në pikën 28.1 "Pagesat e Autoritetit Kontraktues". Në këtë rast, Autoriteti Kontraktues përjashtohet nga penalitetet për vonesën e shkaktuar dhe Pagesat do

të kryhen sipas modelit financiar të rishikuar nga Koncesionari pas miratimit paraprak të këtij modeli financiar të rishikuar nga Autoriteti Kontraktor si dhe nga Ministria përgjegjëse për Financat, miratim i cili duhet të jepet brenda afateve të përcaktuara në ligjin nr. 125/2013 "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat" të ndryshuar.

20.5. Shoqëria Koncesionare do të kryejë dhe përfundojë Punimet:

20.5.1 Në varësi të ndryshimeve që mund të ndodhin në bazë të dispozitave të Kontratës, në përputhje me afatet e propozuara në Dokumentat e Ofertës dhe në Projekt Zbatim;

20.5.2 Në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate, kërkesat, Standardet e Autoritetit Kontraktor, propozimet e tij për Punimet dhe Praktikat e Mira të Industrisë dhe Dokumentacionin e Tenderit;

20.5.3 Duke përdorur ekskluzivisht materiale dhe pajisje për Punimet, të cilat janë zgjedhur profesionalisht bazuar në Praktikat e Mira të Industrisë në përputhje me kërkesat dhe Standardet e Punimeve të Autoritetit Kontraktor dhe Ligjit shqiptar në fuqi; dhe

20.5.4 Duke bërë të gjitha përpjekjet që punëmarrësit dhe sipërmarrësit e tij (përfshirë Nënkontraktorët), gjatë kohës që janë të pranishëm në Territorin e Projektit, të kryejnë Punimet në përputhje me rregullat e sigurimit teknik në punë si dhe Ligjin në fuqi.

20.5.5 Nëse përfundimi i punimeve nuk realizohet për fajin e Shoqërisë Koncesionare, brenda afateve të përcaktuara në Grafikun e Punimeve, Autoriteti Kontraktor mund të dërgojë një njoftim për mospërmbushje të detyrimeve te shoqëria koncesionare në përputhje me parashikimet e nenit 37, duke i vënë në dispozicion një kohë të arsyeshme për të kryer veprimet korrigjuese.

20.5.6 Nëse Shoqëria Koncesionare nuk ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme korrigjuese për të përmirësuar shkaqet e mospërmbushjes të vëna në dukje në Njoftimin për Mospërmbushje të Detyrimeve, brenda një afati kohor të arsyeshëm, të caktuar në këtë njoftim, ajo i paguan Autoritetit Kontraktues penalitet në masën 0.001% të Vlerës së Investimit të parealizuar, për çdo muaj vonesë. Ky penalitet fillon të aplikohet pas përfundimit të një periudhe prej 10 Ditë Pune nga data e fundit e afatit të përcaktuar në Njoftimin për Mospërmbushje të detyrimeve të dërguar nga Autoriteti Kontraktor, sipas këtij neni.

20.6. Përmbyllja Financiare

20.6.1 Shoqërisë Koncesionare i kërkohet që të kryejë Përmbylljen Financiare jo më vonë se afati i përcaktuar në këtë kontratë. Autoriteti Kontraktor sipas gjykimit të tij të arsyeshëm mund të bjerë dakord ta zgjasë këtë periudhë, pas një propozimi me shkrim nga Koncesionari.

20.6.2 Nëse Shoqëria Koncesionare për faj të saj nuk arrin të sigurojë financimin e nevojshëm, përveçse kur një mospërmbushje e tillë është shkaktuar nga një veprim ose mosveprim i Autoritetit Kontraktor apo i një Autoriteti Përkatës, apo një ndryshim përkeqësues thelbësor që prek tregjet financiare, atëherë kjo Kontratë përfundon me efekt të menjëhershëm dhe:

a) Asnjëra Palë nuk i detyrohet Palës tjetër ndonjë pagesë në lidhje me një përfundim të tillë;
b) Autoriteti Kontraktor do të mbajë Garancinë e Kontratës; dhe

c) Shoqëria Koncesionare është plotësisht përgjegjëse për të gjitha kostot e largimit të pajisjeve nga Territori i Projektit apo të gjitha kostot e tjera që mund t'i lindin.

20.6.3 Në rast se Shoqëria Koncesionare nuk arrin të sigurojë financimin e nevojshëm si pasojë e një veprimi ose mosveprimi të Autoritetit Kontraktor apo një Autoriteti Përkatës që ka ndikim të drejtpërdrejtë te koncesionari, atëherë ky i fundit zhbllokon Garancinë e Kontratës.

20.7. Inxhinieri i Pavarur

20.7.1 Autoriteti Kontraktor, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga Data e Hyrjes në Fuqi të kontratës, do të përgatisë dokumentacionin e tenderit që kërkohet për përzgjedhjen e Inxhinierit të Pavarur. Një dokumentacion i tillë do të përmbajë por nuk do të kufizohet me:

a) Objektin e punës së Inxhinierit të Pavarur, i cili do të bazohet në atë që përmbahet në Shtojcën nr. 8;

b) Kriteret, mbi të cilët do të përzgjidhet Inxhinieri i Pavarur; dhe

c) Termat kyç të kontratës për emërimin dhe detyrat e Inxhinierit të Pavarur, sipas detyrave kyç, të përcaktuara në Shtojcën nr. 8.

20.7.2 Autoriteti Kontraktor e kontrakton Inxhinierin e Pavarur brenda 6 (gjashtë) Muajsh nga Data e Hyrjes në Fuqi e kësaj Kontrate dhe përzgjedhja e tij bëhet në përputhje me Ligjin shqiptar për Prokurimet Publike. Kontrata fillestare e Inxhinierit të Pavarur bëhet për një kohë deri në mbarim të Periudhës së Përgjegjësisë për Defektet e Punimeve (periudha e garancisë së Punimeve sipas parashikimeve të kësaj Kontrate). Më pas, çdo Kontratë e Inxhinierit të Pavarur duhet të jetë të paktën për një periudhë maksimale që parashikon legjislacioni shqiptar për prokurimet publike.

20.7.3 Inxhinieri i Pavarur duhet të ketë përvojë në Projekte të ngjashme me këtë Projekt.

20.7.4 Inxhinieri i Pavarur i kryen detyrimet e tij në përputhje me dispozitat e Kontratës së Inxhinierit të Pavarur të lidhur midis tij dhe Autoritetit Kontraktor, në përputhje me Shtojcën nr. 8 të kësaj Kontrate.

20.7.5 Kontrata e Inxhinierit të Pavarur përmban (ndër të tjera) kushtet e mëposhtme:

a) Kostot e lindura në lidhje me përzgjedhjen, emërimin dhe punën e Inxhinierit të Pavarur përballohen nga Autoriteti Kontraktor;

b) Inxhinieri i Pavarur i plotëson detyrimet e tij për raportim te Autoriteti Kontraktor dhe te Shoqëria Koncesionare drejtpërdrejt dhe njëkohësisht;

c) Objekti i shërbimeve dhe shkalla e të drejtave dhe detyrimeve të Inxhinierit të Pavarur janë në përputhje me Kontratën, e cila përmban detyrimet kryesore të Inxhinierit të Pavarur të përcaktuara në Shtojcën nr. 8;

d) Inxhinieri i Pavarur i ofron shërbimet e tij, në çdo kohë dhe në të gjitha rrethanat, në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate si dhe kontratës së Inxhinierit të Pavarur dhe këtë e bën në mënyrë të paanshme dhe të pavarur;

c) Përpara zgjidhjes së një mosmarrëveshjeje, Inxhinieri i Pavarur u jep Autoritetit Kontraktor dhe Shoqërisë Koncesionare mundësinë që të shprehin mendimet e tyre në lidhje me çështjen përkatëse;

f) Shoqëria Koncesionare ka të drejtë të konsultohet me Inxhinierin e Pavarur në lidhje me të gjitha aspektet e çdo çështjeje, që ka të bëjë me Punimet ose me ndonjë Riparim Kapital.

g) Shoqëria Koncesionare ka të drejtë të kërkojë tek Autoriteti Kontraktor fillimin e procedurave për zgjidhjen e Kontratës së Inxhinierit të Pavarur, ose zëvendësimin e Inxhinierit të Pavarur në rast të shkeljeve të dispozitave të Kontratës apo të Kontratës së Inxhinierit të Pavarur nga ana e tij, si dhe në rast të pengesave të pajustifikuara dhe të përsëritura të Inxhinierit të Pavarur kundrejt Shoqërisë Koncesionare, në përmbushjen e detyrimeve të këtij të fundit sipas kësaj Kontrate.

h) Në rast të zgjidhjes së parakohshme të Kontratës së Inxhinierit të Pavarur nga ana e Autoritetit Kontraktor, ky i fundit do ta njoftojë Shoqërinë Koncesionare minimalisht 10 ditë përpara dhe inxhinieri i pavarur ka detyrimin të çertifikojë punimet e kryera nga shoqëria koncesionare deri në momentin e zgjidhjes së kontratës.

20.7.6 Pas marrjes së raporteve apo dokumenteve me informacion nga Inxhinieri i Pavarur, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë t'i parashtrojë Shoqërisë Koncesionare mendimet e tij në lidhje me to.

20.7.7 Nëse kjo Kontratë kërkon që Inxhinieri i Pavarur të japë vendimin, mendimin, pëlqimin, miratimin e tij ose të përcaktojë masat e duhura, në varësi të pikës 20.6.8 më poshtë, ky vendim, mendim, pëlqim, miratim ose përcaktim i masave të duhura nga Inxhinieri i Pavarur është detyrues për Palën përkatëse që duhet të veprojë në përputhje me të.

20.7.8 Nëse ndonjëra nga Palët është e pakënaqur me vendimin, mendimin, pëlqimin, ose masat e urdhëruara nga Inxhinieri i Pavarur, atëherë kjo Palë e njofton Palën tjetër brenda 15 (pesëmbëdhjetë) Ditësh Pune nga marrja e njoftimit përkatës nga Inxhinieri i Pavarur, me kusht që në asnjë rrethanë Shoqëria Koncesionare të mos ketë të drejtë të pezullojë, ndalojë, ose ndërpresë në ndonjë mënyrë tjetër Punimet gjatë procesit të zgjidhjes së një mosmarrëveshjeje të tillë, me përjashtim të punëve që preken drejtpërdrejt nga mosmarrëveshja, si dhe të punëve përfundimi apo kryerja e të cilave varet drejtpërdrejt nga rezultati i zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Në rast se njëra Palë është e pakënaqur me vendimin e Inxhinierit të Pavarur, aplikohet Neni 52.

20.7.9 Për shmangien e çdo dyshimi, Shoqëria Koncesionare nuk mban përgjegjësi për mospërmbushjen e ndonjë detyrimi ose përgjegjësie të saj, në rast se kjo mospërmbushje vjen për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve nga Inxhinieri i Pavarur, në përputhje me këtë Kontratë si dhe Kontratën e Inxhinierit të Pavarur.

20.7.10 Në rast se Inxhinieri i Pavarur nuk emërohet në kohën e përcaktuar në këtë nen, apo në rast se veprimtaria e tij në funksion të zbatimit të kësaj Kontrate dhe Kontratës së Inxhinierit të Pavarur pezullohet, ndalohet apo braktiset për çfarëdolloj arsye, Palët bien dakord që brenda 15 ditëve Autoriteti Kontraktor apo ndonjë Person i autorizuar/emëruar nga ai, do të kryejë funksionin e Inxhinierit të Pavarur deri në emërimin e Inxhinierit të Pavarur apo zëvendësimin e tij.

20.8 Materialet e Rrezikshme

20.8.1 Në rastin e zbulimit të ndonjë materiali apo substance të rrezikshme, toksike, apo të ndotur nën, sipër dhe/ose në Territorin e Projektit, Shoqëria Koncesionare:

a) njofton menjëherë Autoritetin Përkatës dhe Autoritetin Kontraktor; dhe
b) merr të gjithë hapat e nevojshëm për të garantuar sigurinë e njerëzve dhe të pronës.

20.8.2 Autoriteti Kontraktor, në bashkëpunim me Shoqërinë Koncesionare, ndërmerr të gjithë hapat e nevojshëm për largimin dhe/ose neutralizimin e materialeve apo substancave të tilla (në përputhje me miratimet, Standardet dhe legjislacionin në fuqi për substancat e rrezikshme). Për qëllime të largimit dhe/ose neutralizimit të materialeve ose substancave të tilla, Shoqëria Koncesionare e lejon Autoritetin Përkatës që të hyjë në Territorin e Projektit dhe të zbatojë udhëzimet e Autoritetit Përkatës.

20.8.3 Nëse gjatë kryerjes së Punimeve, Shoqëria Koncesionare zbulon në Territorin e Projektit ndonjë material apo substancë të rrezikshme, toksike apo të ndotur, që (i) nuk është sjellë në Territorin e Projektit nga Shoqëria Koncesionare ose nga ndonjë Palë Koncesionare, apo (ii) Shoqëria Koncesionare nuk kishte mundësi t'i kishte identifikuar apo zbuluar ato përpara datës së nënshkrimit si nga Të Dhënat e Vëna në Dispozicion, apo nga hetimi me sy i Territorit të Projektit dhe nga hetimi i ndonjë shenje të jashtme në sipërfaqe, atëherë zbulimi në Territorin e Projektit i materialeve apo substancave të tilla të paparashikueshme, të rrezikshme, toksike ose të ndotura, në rast shkaktimi të dëmeve apo vonesave për Shoqërinë Koncesionare, do të konsiderohet si Shkak Lehtësimi.

20.9 Rrjetet e Infrastrukturës Publike apo zbulimi gjatë punimeve i objekteve të paparashikueshme (të vështira për tu zhvendosur)

20.9.1 Nëse ndonjë rrjet i infrastrukturës publike nën, sipër dhe/ose në Territorin e Projektit apo zbulimi i objekteve (të vështira për tu zhvendosur) pas datës në të cilën Autoriteti Kontraktor i ka Dorëzuar koncesionarit Territorin e Projektit pengon kryerjen e Punimeve, Shoqëria Koncesionare njofton menjëherë Autoritetin Kontraktor i cili në konsultim me autoritetin përkatës, poseduesin/përdoruesin ose operatorin përkatës të infrastrukturës publike dhe ose objektit të paparashikueshëm të zbuluar dhe në bashkëpunim me të gjitha Palët dhe Autoritetet Përkatëse, angazhohet që objekti i paparashikueshëm i zbuluar apo/dhe infrastruktura publike të zhvendoset, hiqet, brenda 2 (dy) Muajsh nga territori i projektit dhe këto shpenzime (për koston e zhvendosjes, heqjes, dhe/ose rivendosjes të tyre dhe të tjetër) nuk do ti ngarkohen koncesionarit por do të mbulohen sipas pikës 20.8.2.

20.9.2 Nëse zhvendosja, heqja e objektit të paparashikueshëm (të vështirë për tu zhvendosur) të zbuluar dhe/apo zhvendosja, heqja rivendosja e infrastrukturës publike nuk është mundësuar nga AK, apo autoriteti përkatës, poseduesi/përdoruesi, operatori përkatës brenda dy muajsh nga data e njoftimit të Autoritetit Kontraktor, kjo do të do të konsiderohet sipas rastit si Shkak Lehtësimi. Nëse zhvendosja, heqja e objektit të paparashikueshëm (të vështirë për tu zhvendosur) të zbuluar dhe/apo zhvendosja, heqja rivendosja e infrastrukturës publike nuk është mundësuar nga AK, apo autoriteti përkatës, poseduesi/përdoruesi, operatori përkatës brenda dy muajsh nga data e njoftimit të Autoritetit Kontraktor, pas kalimit të këtij afati, Koncesionari mund që, me pëlqimin e Autoritetit Kontraktor dhe pasi të ketë rënë dakord me të dhe me Inxhinierin e Pavarur për kostot, cilësinë dhe afatin e kryerjes së punimeve për zhvendosjen, heqjen e Rrjetit të Infrastrukturës Publike apo

objektit/objekteve të paparashikueshme (të veshtirë për tu zhvendosur) të zbuluara gjatë punimeve të koncesionarit të kryejë vetë këto veprime dhe të përballojë me shpenzimet e tij kostot për këto veprime, por ato do të rimbursohen nga Autoriteti Kontraktor në bashkëpunim me Autoritetet e tjera Përkatëse, të cilat kanë në administrim ose pronësi, këto objekte të zbuluara të paparashikueshme apo infrastruktura publike. Në lidhje me këto kosto të rimbursueshme, Autoriteti Kontraktor është i detyruar të kryejë pagesën pas kërkesës së Koncesionarit/Shoqërisë Koncesionare si dhe me paraqitjen nga kjo e fundit të dokumentacionit përkatës që vërteton koston si dhe të faturës/ravë përkatëse dhe miratimin e Inxhinierit të Pavarur, brenda 20 (njëzet) Ditë Pune nga paraqitja e faturave tek Autoriteti Kontraktor. Nëse ky objekt i paparashikueshëm, i zbuluar gjatë punimeve dhe i veshtirë për tu zhvendosur, eshte me vlerë, atëherë procedura e zhvendosjes se tij si dhe mënyra e dhënies së pagesës do të përcaktohen në marrëveshje me shkrim midis palëve.

20.9.3 Në rast se gjatë kryerjes së Punimeve në Territorin e Projektit zbulohet ndonjë objekt i paparashikueshëm (i veshtirë për tu zhvendosur) apo infrastrukturë publike dhe kur një objekt i tillë dhe/apo infrastrukturë e tillë publike nuk mund të ishte/ishin zbuluar normalisht nga Koncesionari përpara datës së nënshkrimit të kësaj Kontrate nga (i) Të Dhënat e Vëna në Dispozicion, ose (ii) hetimi i kujdesshëm i ndonjë shënje të jashtme të elementëve strukturorë në Territorin e Projektit, atëherë zbulimi i një infrastrukture të tillë publike apo objekti të paparashikueshëm (i vështirë për tu zhvendosur) do të konsiderohet/en si Shkak Lehtësimi dhe nëse zhvendosja do të kryhet nga koncesionari, rimbursimet e kostove do bëhen nga Autoriteti Kontraktor në bashkëpunim me Autoritetet e tjera Përkatëse, të cilat kanë në administrim ose pronësi, këto objekte të zbuluara të paparashikueshme apo infrastruktura publike.

20.10 Miratimet e nevojshme

Në rast se do e kërkonte nevoja, për të gjitha punët në lidhje me largimin, instalimin ose zëvendësimin, të përmendura më lart, në rast se Shoqëria Koncesionare është ajo që do të kryejë këto punime, atëherë Shoqëria Koncesionare duhet të marrë te Autoriteti Përkatës, të gjitha miratimet e nevojshme dhe të paraqesë kërkesat e shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm mbështetës, të nevojshëm për dhënien e miratimeve të duhura. Autoriteti Kontraktor është i detyruar të bëjë të gjitha përpjekjet dhe të japë të gjithë ndihmën e nevojshme për Shoqërinë Koncesionare për të marrë miratimet e nevojshme nga ana e Autoriteteve Përkatëse. Për sa kohë që Shoqëria Koncesionare ka përmbushur të gjitha kërkesat dhe formalitetet e kërkuara nga Ligji, çdo vonesë e pajustifikuar, e shkaktuar nga ndonjë Autoritet Përkatës në lidhje me ndonjë leje apo miratim që do të lëshohet nga ky Autoritet Përkatës, do të konsiderohet sipas rastit si Shkak Lehtësimi dhe/ose Shkak Kompensimi, veç e veç ose së bashku.

Neni 21

Organizimi i Territorit të Projektit

21.1. Bashkëpunimi me Sipërmarrës të Tjerë

Shoqëria Koncesionare gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate koncesioni, i jep mundësinë për hyrje dalje dhe përdorimin e infrastrukturës së Portit të Integruar, subjekteve që kryejnë veprimtarinë përkatëse në territorin e këtij porti, krijon lehtësirat e nevojshme dhe të arsyeshme për Perfaqësuesit e autorizuar të Autoritetit Kontraktor apo të çdo Autoriteti Përkatës tjetër

kompetent, që të mund të kryejnë Punime në Territorin e Projektit, ose në zona pranë Territorit të Projektit, me kusht që një gjë e tillë mos të pengojë apo vonojë Punimet objekt kontrate të Shoqërisë Koncesionare. Nga ana tjetër Autoriteti Kontraktor, me aq sa është e mundur, e lehtëson punën e Shoqërisë Koncesionare dhe angazhohet që punonjësit e tij apo të çdo Autoriteti Përkatës do të bëjnë të njëjtën gjë.

21.2. Infrastruktura Publike

Shoqëria Koncesionare, me shpenzimet e veta dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, instalon ose lidh (sipas rastit) vendin e Punimeve dhe Territorin e Projektit me rrjetin e furnizimit të përshtatshëm të infrastrukturës publike.

Shoqëria Koncesionare merr të gjitha masat paraprake që të mos lejojë që Personat e paautorizuar të futen në Territorin e Projektit. Gjatë kryerjes së një aktiviteti në Kantier gjatë Periudhave Ndërtimore, Koncesionari mund t'i rrethojë këto zona për evitimin e hyrjes së Personave të paautorizuar në Territorin e Projektit. Shoqëria Koncesionare merr të gjitha masat paraprake për:

a) të mbajtur personelin dhe pajisjet e tij brenda Territorit të Projektit,

b) angazhohet që secili nga Nënkontraktorët e tij të marrë të gjitha masat e nevojshme paraprake për të mbajtur personelin dhe pajisjet e tyre brenda Territorit të Projektit, si dhe

c) nuk i lejon ata të futen në fokat që ndodhen pranë, përveçse kur është e nevojshme për zbatimin e detyrave të Kontratës.

21.3. Largimi i mbetjeve

Shoqëria Koncesionare e mban Territorin e Projektit të pastër nga mbetjet apo pengesat e panevojshme dhe i magazinon ose i largon të gjitha pajisjet, Objektet e Përkohshme ose materialet e tepërta. Koncesionari me përjashtim të mbetjeve nga porti i peshkimit, pastron ose largon nga Territori i Projektit çdo mbeturinë, mbetje apo punë të përkohshme që nuk është më e nevojshme për Projektin.

Neni 22

Cilësia

22.1. Menaxhimi i Cilësisë

22.1.1 Shoqëria Koncesionare përgatit dhe zbaton, në lidhje me çdo fazë të Projekt Zbatimit, sisteme kontrolli dhe sigurimi të cilësisë, në përputhje me Standardin ISO 9001 (ose çdo procedurë tjetër të barazvlefshme, ose më të avancuar) dhe Praktikat e Mira Industriale. Shoqëria Koncesionare angazhohet që secili nga Nënkontraktorët të respektojë të njëjtat Standarde.

22.1.2 Sistemet e Cilësisë zbatohen për (ndër të tjera) menaxhimin e përgjithshëm, sistemin e kontrollit, planifikimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë dhe mirëmbajtjen e Portit të Integruar, në Triport Vlorë.

22.1.3 Përpara fillimit të ndonjë pjese të Punimeve apo Shërbimeve të Mirëmbajtjes, Sistemet e Cilësisë të përgatitura nga Shoqëria Koncesionare i paraqiten Inxhinierit të Pavarur për komente dhe miratim.

22.1.4 Në mungesë të ndonjë komenti apo kundërshtimi nga Inxhinieri i Pavarur brenda 20 (njëzet) Ditësh Pune nga paraqitja, Sistemet e Cilësisë quhen të miratuara. Në rast të komenteve të Inxhinierit të Pavarur, Koncesionari i merr ato parasysh ose i dorëzon atij edhe njëherë Sistemet e Cilësisë me shpjegimet, ne lidhje me arsyet e mosmarrjes parasysh të komenteve.

22.1.5 Gjatë kohëzgjatjes së Kontratës, Koncesionari i rishikon herë pas here sistemet e certifikuara. Në rastin e ndonjë ndryshimi në Sistemet e Cilësisë, pikat 22.1.3 dhe pikës 22.1.4 më sipër përdoren përkatësisht në lidhje me miratimin e Sistemeve të ndryshuara të Cilësisë nga Inxhinieri i Pavarur.

22.2. Kontrolli i Cilësisë

Autoriteti Kontraktor ose çdo institucion apo Person i ngarkuar nga Autoriteti Kontraktor, mund të bëjë herë pas here, kur e zgjedh vetë, me shpenzimet e tij, një kontroll të procedurave të kontrollit të cilësisë së Shoqërisë Koncesionare dhe të Nënkontraktorëve për të siguruar kontrollin e kryerjes së detyrimeve sipas kësaj Kontrate.

22.3. Bashkërendimi i Projektimit, Ndërtimit dhe Sigurisë

Shoqëria Koncesionare vepron në përputhje me Ligjet, të cilat rregullojnë bashkërendimin e Shoqërisë Koncesionare me Autoritetet Përkatëse për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e Portit të integruar në Triport Vlorë, objekt i Kontratës, duke garantuar në çdo kohë sigurinë e tij.

Neni 23

Përfundimi i Punimeve

23.1 Përfundimi

Përfundimi i Punimeve në lidhje me Portin e Integruar në Triport Vlorë nënkupton se:

a) Ndërtimi i Portit të Integruar objekt kontrate ka përfunduar; dhe

b) Është dhënë certifikata e përfundimit të punimeve dhe kolaudimi (që lëshohet nga Autoriteti Përkatës).

23.2 Dorëzimi Teknik pas Përfundimit

Jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) Ditë Pune para datës kur Shoqëria Koncesionare parashikon se do të përfundojnë Punimet, Palët bien dakord të përcaktojnë me shkrim procedurën e dorëzimit teknik dhe/ose kolaudimit. Shoqëria Koncesionare i paraqet Inxhinierit të Pavarur Dokumentacionin e Projektit sipas procedurës së dakordësuar të dorëzimit teknik së bashku me shtesat, nëse ka, në Skicat e Ndërtimit të përditësuara të projektimit me ndryshimet përkatëse të bëra gjatë ndërtimit, për qëllime inspektimi (vizatimet/gjendjen faktike). Kjo procedurë zbatohet nga Inxhinieri i Pavarur,

Autoriteti Kontraktor, Shoqëria Koncesionare, Nënkontraktori i Ndërtimit dhe çdo Autoritet Përkatës i duhur, i cili ftohet ose prania e të cilit kërkohet me Ligj. Shoqëria Koncesionare i bashkëngjit njoftimit me shkrim të përmendur me lart, certifikatën e Inxhinierit të Pavarur, e cila konfirmon se Punimet janë përfunduar dhe janë përmbushur plotësisht.

23.3 Marrja e Certifikates së Përfundimit

23.3.1 Shoqëria Koncesionare bën kërkesë për certifikatën e Përfundimit dhe Autoriteti Kontraktor në mënyrë të arsyeshme do të japë ndihmën e nevojshme që ajo të pajiset me to, nëse Shoqëria Koncesionare ka përmbushur të gjitha detyrimet e kësaj Kontrate si dhe është pajisur me certifikatën e Inxhinierit të Pavarur, sipas përcaktimit të pikës 23.2

23.3.2 Shoqëria Koncesionare e njofton menjëherë Autoritetin Kontraktor për datën e inspektimit të Territorit të Projektit nga Autoriteti Përkatës. Autoriteti Kontraktor mund të marrë pjesë në çdo inspektim, i cili kryhet nga çdo Autoritet Përkatës, për të përcaktuar nëse mund të lëshohet Certifikata e Përfundimit.

23.3.3 Shoqëria Koncesionare njofton menjëherë Autoritetin Kontraktor në datën e dhënies së Certifikatës së Përfundimit nga Autoriteti Përkatës dhe i jep Autoritetit Kontraktor kopje përfundimtare të Skicave të Ndërtimit, me ndryshimet përkatëse të bëra gjatë Punimeve, nëse ka.

23.3.4 Nëse Autoriteti Përkatës nuk e lëshon Certifikatën e Përfundimit të punimeve, megjithëse Inxhinieri i Pavarur dhe Autoriteti Kontraktor nuk kanë paraqitur ndonjë kundërshtim për Punimet dhe nga ana tjetër as nuk kërkohet të merren masa të tjera për përfundimin e Punimeve, me kusht që:

a) Koncesionari të ketë përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate dhe dispozitave përkatëse të Ligjit kur ka bërë kërkesë për Certifikatën e Përfundimit; dhe

b) Gjatë inspektimit zyrtar nga Autoriteti Përkatës përpara kërkesës për Certifikatën e Përfundimit, Autoriteti Përkatës nuk ka paraqitur ndonjë kundërshtim, në përputhje me Ligjin që konstaton mos-përmbushjen e detyrimeve ose të kushteve të nevojshme për lëshimin e Certifikatës së Përfundimit,

Atëherë kjo do të konsiderohet sipas rastit si Shkak Lehtësimi dhe/ose Shkak Kompensimi, veç e veç ose së bashku.

23.4 Përgjegjësia për Defektet

23.4.1 Pa cënuar asnjë të drejtë tjetër të Autoritetit Kontraktor sipas kësaj Kontrate, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë t'i kërkojë Shoqërisë Koncesionare riparimin e çdo Defekti në Punime me shpenzimet e veta, në përputhje me këtë Kontratë, gjatë periudhës përkatëse të përgjegjësisë së tij për Defektet ("Periudha e Përgjegjësisë së Defekteve").

23.4.2 Shoqëria Koncesionare është përgjegjëse dhe kryen sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur çdo rindërtim, riparim, rehabilitim ose Punime të tjera që kërkohen si rrjedhojë e një Defekti, përveç sa është parashikuar ndryshe në këtë Kontratë.

23.4.3 Me përfundimin e një Punimi, në përputhje me Nenin 23, Inxhinieri i Pavarur vërteton se këto Punime janë kryer në përputhje me Standardet sipas Dokumentacionit të Projektit. Në masën që Punime të tilla nuk janë përfunduar në përputhje me Standardet, Koncesionarit i kërkohet të kryejë Punime të tjera deri në plotësim të tyre.

23.4.4 Për të shmangur çdo dyshim, Palët Koncesionare gjatë gjithë Periudhës së Koncesionit dhe fazave të saj, nuk do të jenë përgjegjëse për Defekte të cilat janë rezultat i Ngjarjes së Forcës Madhore.

23.5 Procedura për Riparimin e Defekteve

23.5.1 Nëse gjatë periudhës së mirëmbajtjes së Portit të Integruar në Triport Vlorë të ndërtuar nga Koncesionari, del në pah një Defekt për punime ose zëra punimesh që janë kryer nga koncensionari, atëherë ai do të rregullojë Defektin/Defektet. Projekti/veprimet për eleminimin e Defektit të ndodhur do të miratohen paraprakisht nga Inxhinieri i Pavarur. Kostoja e riparimit të Defekteve të sipërcituara do të përballohet nga Koncesionari.

23.5.2 Koncesionari në çdo kohë:

a) Kryen Punimet dhe shërbimet për të mos e përkeqësuar një Defekt dhe;
b) Sapo merr dijeni për një Defekt, bën të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të zbutur pasojën e atij Defekti; dhe
c) Ndërmerr të gjitha hapat për të minimizuar pasojat e çdo Defekti të njohur.

23.5.3 Koncesionari e njofton Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e Pavarur brenda 5 (pesë) Ditësh Pune nga marrja dijeni ose konstatimi i një Defekti, dhe pas kësaj i jep Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të Pavarur çdo informacion të mëtejshëm në lidhje me Defektin. Inxhinieri i Pavarur, në bazë të këtij informacioni, jep mendimin e tij brenda një periudhe të arsyeshme, lidhur me aplikimin e masave për riparimin e tij.

23.5.4 Jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) Ditë Pune pasi merr dijeni ose konstaton një Defekt, Koncesionari i dorëzon Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të Pavarur një propozim për punime riparuese për ndreqjen e Defektit.

23.5.5 Jo më vonë se 10 (dhjetë) Ditë Pune pas marrjes së propozimit të Koncesionarit sipas pikës 23.5.4, Autoriteti Kontraktor ose e miraton atë me shkrim, ose sugjeron ndryshimet përkatese në propozimin e Koncesionarit. Nëse Autoriteti Kontraktor vlerëson se i duhet më shumë kohë për shqyrtimin e propozimit, afati shtesë do t'i bëhet i ditur me shkrim Koncesionarit, por ky afat shtesë nuk mund të jetë më shumë se 10 (dhjete) Ditë të tjera Pune. Nëse Autoriteti Kontraktor nuk përgjigjet në lidhje me propozimin e Koncesionarit, dhe nëse ky propozim është vlerësuar,miratuar nga Inxhinieri i Pavarur, atëherë propozimi do të quhet i miratuar.

23.5.6 Nëse Autoriteti Kontraktor sugjeron ndryshime në propozimin e Koncesionarit, Koncesionari brenda 5 (pesë) Ditësh Pune nga marrja e ndryshimeve të sugjeruara ia

kalon propozimin Inxhinierit të Pavarur, i cili menjëherë jep një vendim përfundimtar për propozimin.

23.5.7 Vendimi i Inxhinierit të Pavarur sipas pikës 23.5.6 është detyrues për Palët, përveç kur njëra nga Palët e kundërshton atë, brenda 5 (pesë) Ditësh Pune nga marrja e vendimit të Inxhinierit të Pavarur.

Neni 24

Mirëmbajtja

24.1 Përgatitja e Planit të Menaxhimit të Mirëmbajtjes

24.1.1 Duke filluar në çdo moment pas Datës së Fillimit të Zbatimit të Kontratës, por jo më vonë se 20 (njëzet) Ditë Pune nga fillimi i Fazës së Mirëmbajtjes së Portit të Integruar në Triport Vlorë, sipas Projekt Zbatimit të paraqitur nga Shoqëria Koncesionare, kjo e fundit në përputhje me kërkesat e Manualit të Mirëmbajtjes sipas Shtojcës nr. 2 (bashkëlidhur kësaj Kontrate), përgatit dhe i paraqet Autoritetit Kontraktor të gjithë Programin në lidhje me menaxhimin e Mirëmbajtjes së Portit të Integruar, në Triport Vlorë, (në vijim "Plani i Mirëmbajtjes së Portit të Integruar, në Triport Vlorë"). Faza e Mirëmbajtjes fillon menjëherë pas përfundimit të fazës së Ndërtimit dhe deri në fund të periudhës së koncesionit.

24.1.2 Brenda 20 (njëzet) Ditësh Pune pas marrjes nga Autoriteti Kontraktor të Planit për Mirëmbajtjen e Portit të Integruar, në Triport Vlorë nga Shoqëria Koncesionare, Autoriteti Kontraktor nëpërmjet Autoritetit Përkatës përgjegjës për Portet, miraton Planin e Mirëmbajtjes së Portit të Integruar, në Triport Vlorë ose paraqet vërejtjet apo rekomandimet e tij, gjithnjë në përputhje me Manualin e Mirëmbajtjes sipas Shtojcës nr. 2 ("Manuali i Mirëmbajtjes"). Në rast se ka vërejtje dhe/ose rekomandime nga ana e Autoritetit Kontraktor, ky i fundit së bashku me paraqitjen e vërejtjeve dhe/ose rekomandimeve i cakton Shoqërisë Koncesionare edhe një datë për takimin midis Palëve për të diskutuar Planin dhe vërejtjet dhe/ose rekomandimet e Autoritetit Kontraktor jo më vonë se 30 (dhjetë) Ditë Pune nga data e paraqitjes së vërejtjeve apo rekomandimeve. Shoqëria Koncesionare angazhohet se do të vlerësojë me kujdes dhe mirëbesim çdo parashtrim të bërë nga Autoriteti Kontraktor në lidhje me Planin e Mirëmbajtjes së Portit të Integruar, në Triport Vlorë. Brenda 10 (dhjetë) Ditësh Pune pas takimit dhe gjithsesi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) Ditësh Pune nga data e marrjes së vërejtjeve apo rekomandimeve nga ana e Autoritetit Kontraktor, ajo i dërgon Autoritetit Kontraktor, versionin përfundimtar të Planit të Mirëmbajtjes së Portit të Integruar, në Triport Vlorë dhe në rast të mosmarrjes parasysh të vërejtjeve dhe rekomandimeve të Autoriteti Kontraktor i dërgon edhe një relacion shpjegues për arsyet e mosmarrjes parasysh. Versioni përfundimtar i dërguar nga Shoqëria Koncesionare do të konsiderohet si përfundimtari dhe nuk është i nevojshëm miratimi i mëtejshëm nga ana e Autoritetit Kontraktor.

24.1.3 Palët do të hartojnë Planin e Mirëmbajtjes së Portit të Integruar, në Triport Vlorë, në bashkëpunim me Inxhinierin e Pavarur.

24.1.4 Çdo nevojë për ndryshim të mëvonshëm të Planit të Mirëmbajtjes së Portit të Integruar, në Triport Vlorë nga ana e Shoqërisë Koncesionare do të ndjekë të njëjtën procedurë dhe afat si për miratimin e tij fillestar, sipas paragrafit të mësipërm.

24.2 Periudha e Mirëmbajtjes

24.2.1 Periudha e mirëmbajtjes fillon, pas përfundimit të plotë dhe lëshimit të Certifikatës së Përfundimit të ndërtimit të Portit të Integruar, në Triport Vlorë, i cili është ndërtuar sipas Projekt Zbatimit të paraqitur nga Koncesionari dhe të miratuar nga AK (në vijim "Faza e Mirëmbajtjes").

24.2.2 Shoqëria Koncesionare do të ofrojë Shërbimet e Mirëmbajtjes së Portit të Integruar, në Triport Vlorë, gjatë gjithë periudhës së parashikuar për mirëmbajtje në Projekt Zbatim, në përputhje me Shtojcën nr. 2, Shtojcen nr.3 si dhe me Planin e Mirëmbajtjes së këtij Porti.

24.2.3 Në ofrimin e Shërbimeve dhe mirëmbajtjen e Portit, Shoqëria Koncesionare gjatë gjithë kohës bën të gjitha përpjekjet e arsyeshme të nevojshme për të siguruar që të mos veprojë në ndonjë mënyrë që të ndikojë negativisht në funksionimin e Portit.

24.2.4 Për të shmangur çdo dyshim, Shoqërisë Koncesionare do t'i kërkohet të mobilizohet (me qëllim që të jetë gati) që të fillojë ofrimin e plotë të Shërbimeve të Mirëmbajtjes në lidhje me Portin e Integruar në Triport Vlorë, menjëherë me fillimin e Fazës së Mirëmbajtjes.

24.2.5 Në rast se gjatë kontrollit nga ana e Autoritetit Kontraktues konstatohen mospërmbushje lidhur me standardet e cilësisë dhe mirëmbajtjes, Autoriteti Kontraktor mund të dërgoje një Njoftim për Mospërmbushje të Detyrimeve te Shoqëria Koncesionare në përputhje me parashikimet e nenit 37, duke i vënë në dispozicion një kohë të arsyeshme.

24.2.6 Në qoftë se Shoqëria Koncesionare nuk ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme korrigjuese për të përmirësuar shkaqet e mospërmbushjes të vëna në dukje në Njoftimin për Mospërmbushje të Detyrimeve, brenda një afati kohor te arsyeshëm, të caktuar në këtë njoftim, ajo i paguan Autoritetit Kontraktues penalitet në masën 0.001% të Vlerës së Mirembajtjes. Ky penalitet fillon të aplikohet pas përfundimit të një periudhe prej 10 Ditë Pune nga data e fundit e afatit të përcaktuar në Njoftimin për Mospërmbushje të detyrimeve të dërguar nga Autoriteti Kontraktor, sipas këtij neni.

24.3 Procedurat e Bashkërendimit

Deri në fillimin e Fazës së Mirëmbajtjes, Shoqëria Koncesionare me asistencën dhe kujdesin e Autoritetit Kontraktor, duhet t'i ketë mbaruar diskutimet me të gjithë Autoritetet Përkatëse përgjegjëse për Portin, ose që preken nga mirëmbajtja e këtij porti dhe duhet të ketë përgatitur dhe rënë dakord, nëse është e nevojshme, për procedurat e bashkërendimit në lidhje me Punimet e nevojshme për mirëmbajtjen e Portit ndërmjet Autoritetit/Autoriteteve Përkatës dhe Shoqërisë Koncesionare.

24.4 Amendamentet në Manualin e Mirëmbajtjes

Shoqëria Koncesionare mund të propozojë tek Autoriteti Kontraktor ndryshimin e Manualit të Mirëmbajtjes sipas Shtojcës nr. 2 brenda 15 (pesëmbëdhjetë) Ditësh Pune pas marrjes së propozimeve për ndryshim Autoriteti Kontraktor, vetë ose nëpërmjet Autoritetit Përkatës, miraton propozimet ose paraqet me shkrim vërejtjet apo rekomandimet e tij. Në rast se ka vërejtje dhe/ose rekomandime nga ana e Autoritetit Kontraktor, ky i fundit së bashku me paraqitjen e vërejtjeve dhe rekomandimeve i cakton Shoqërisë Koncesionare edhe një datë për takimin midis Palëve për të diskutuar propozimet për ndryshimin e Manualit të Mirëmbajtjes si dhe vërejtjet e rekomandimet e Autoritetit Kontraktor, jo me vonë se 15 (pesembedhjetë) Ditë Pune nga data e paraqitjes së vërejtjeve, apo rekomandimeve. Shoqëria Koncesionare duhet të vlerësojë me kujdes dhe mirëbesim çdo parashtrim të bërë nga Autoriteti Kontraktor nëpërmjet Autoritetit përgjegjës për Portet, në lidhje me Manualin e Mirëmbajtjes. Brenda 5 (pesë) Ditësh Pune pas takimit dhe gjithsesi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) Ditësh Pune nga data e marrjes së vërejtjeve apo rekomandimeve nga ana e Autoritetit Kontraktor, Shoqëria Koncesionare i dërgon për miratim Autoritetit Kontraktor, versionin e rishikuar të propozimeve për ndryshimin e Manualit të Mirëmbajtjes sipas vërejtjeve dhe rekomandimeve të Autortietit Kontraktor. Autoriteti duhet të përgjigjet në lidhje me propozimin e ri brenda një afati prej 10 (dhjetë) Ditësh Pune nga dita e dërgimit të propozimit të ndryshuar. Në rast se Autoriteti Kontraktor nuk përgjigjet apo nuk e miraton propozimin e Shoqërisë Koncesionare, atëherë do të vazhdojë të jetë në fuqi Manuali i Mirëmbajtjes aktual. Palët mund të vazhdojnë të diskutojnë dhe negociojnë për ndryshimet e nevojshme të Manualit të Mirëmbajtjes, deri në gjetjen e dakordësisë dhe dhënien e miratimit për këto ndryshime nga Autoriteti Kontraktor.

24.5 Detyrimet e Shoqërisë Koncesionare

24.5.1 Shoqëria Koncesionare ndërmerr (dhe angazhohet që çdo Nënkontraktor si dhe punonjësit e tij do të ndërmarrin) të gjitha veprimet e nevojshme për të mirëmbajtur Portin në atë mënyrë që të sigurojë:

a) Shfrytëzimin e pandërprerë dhe të sigurtë të Portit në bazë 24-orëshe, nga mjetet detare dhe çdo Përdorues i mundshëm, përveç rasteve të Ngjarjeve të Forces Madhore, aksidenteve apo ngjarjeve të tjera që e bëjnë atë të pashfrytëzueshem;

b) Respektimin e Manualit/leve të Mirëmbajtjes;

me kujdes dhe në përputhje me kërkesat për Shërbimet e Mirëmbajtjes të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor si dhe Standardet dhe Propozimet e Shoqërisë Koncesionare për mirëmbajtjen sipas propozimit të ofertës fituese, si dhe Praktikës më të Mirë të Industrisë.

24.5.2 Shoqëria Koncesionare:

a) Merr të gjitha masat, në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktor dhe Autoritetet Përkatëse, për të bërë të mundur lëvizjen e qetë të trafikut detar dhe për t'i mbajtur në minimum vonesat e tij;

b) Vepron sa më shpejt që të jetë e mundur ndaj, emergjencave apo incidenteve të tjerë, për aq sa parashikohet në Manualin/let e Mirëmbajtjes apo në Planin e Mirëmbajtjes së Portit;

24.5.3 Përveçse rasteve të jashtëzakonshme apo të një ndodhie të paparashikuar, Shoqëria Koncesionare u jep Përdoruesve dhe Autoritetit Kontraktor, për aq sa është e mundur, paralajmërimet e nevojshme për çdo ngjarje që ndikon në përdorimin e portit nga ana e tyre.

24.5.4 Kur një Punim për mirëmbajtje, riparim apo Punime të tjera, e bën të nevojshme ndërprerjen apo pezullimin e përdorimit të të gjitha pjesëve të portit, apo mbylljen e një pjese të tij për një periudhë kohe, Shoqëria Koncesionare i jep (i) Autoritetit Kontraktor, (ii) Autoritetit Përkatës të përfshirë, si dhe (iii) çdo Palë të interesuar dhe të gjithë Përdoruesve të prekur, me anë të mjeteve të disponueshme, në përputhje me Praktikën e Mirë të Industrisë, njoftim paraprak për një rast të tillë, përveç rasteve të emergjencës ose të një çrregullimi të vogël në Port. Në rastin e një urgjence, apo të një çrregullimi të vogël në Port, nuk kërkohet ndonjë njoftim paraprak, megjithatë, sa më shpejt që të jetë e mundur, por gjithsesi brenda një afati të arsyeshëm, Shoqëria Koncesionare i jep Autoritetit Kontraktor dhe çdo Autoriteti Përkatës, shpjegimet e ngjarjes në fjalë, nëse i kërkohet.

24.5.5 Shoqëria Koncesionare bën në çdo kohë përpjekjet e saj të arsyeshme, për të minimizuar ose evituar shqetësimet që i shkaktohen trafikut në port.

24.5.6 Në fund të vitit të 7-të të Periudhës së Koncesionit, Shoqëria Koncesionare i paraqet Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të Pavarur një Program të riparimeve të nevojshme (që përfshin një plan trevjeçar të përditësuar të mirëmbajtjes dhe një Program vjetor të riparimeve që lidhen me vitin e ardhshëm, në përputhje me Manualin/let e Mirëmbajtjes si dhe me Planin për Mirëmbajtjen e Portit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) Ditë Pune përpara ditës së parë me të cilën lidhet Programi. Autoriteti Kontraktor mund të komentojë për Programin e riparimeve brenda 30 (tridhjetë) Ditësh Pune pas paraqitjes së Programit të riparimeve të propozuara. Shoqëria Koncesionare merr parasysh komentë të tilla, me përjashtim të atyre komenteve, që do të sillnin vonesa të paarsyeshme, shkelje të kësaj Kontrate ose të Ligjit, si dhe kosto të larta, të cilat Shoqëria Koncesionare nuk i përballon dot.

24.5.7 Për të shmangur çdo dyshim, rregullimi i dëmtimeve në Port si pasojë e Ngjarjeve të Forcës Madhore, nuk përfshihet në pagesën e Mirëmbajtjes sipas kësaj Kontrate dhe këto shpenzime do të paguhen veçmas nga Autoriteti Kontraktor. Përpara fillimit të punimeve për rregullimin e këtyre dëmtimeve, Shoqëria Koncensionare i paraqet Inxhinierit të Pavarur dhe Autoritetit Kontraktor planin e ndërhyrjes për këto rregullime si dhe koston e tyre. Vetëm pasi Palët bien dakord për planin dhe koston e ndërhyrjeve, Shoqëria Koncensionare fillon punën për rregullimin e dëmtimeve në Port.

Neni 25

Inspektimi, Mbikqyrja dhe Raportimi

25.1 Inspektimet e Inxhinierit të Pavarur

25.1.1 Inxhinieri i Pavarur kryen inspektime për të verifikuar dhe ndjekur kryerjen e punimeve sipas Projekt Zbatimit, nga ana e Shoqërisë Koncesionare.

25.1.2 Gjatë Periudhave Ndërtimore dhe Periudhës së mirëmbajtjes, Inxhinieri i Pavarur, do të kontrollojë dhe mbikqyrë Punimet. Një kontroll i tillë përfshin ndjekjen e aktiviteteve në çdo fazë të punës, me qëllim për të siguruar që Punimet po kryhen në përputhje me kërkesat e cilësisë së Autoritetit Kontraktor, Standardet si dhe në përputhje me Projekt Zbatimin e miratuar.

25.1.3 Inxhinieri i Pavarur ka të drejtë të ndjekë takimet për ecurinë e Punimeve, të cilat zhvillohen ndërmjet Shoqërisë Koncesionare dhe Nënkontraktorëve të Ndërtimit, dhe të marrë njoftimet përkatëse për kohën dhe vendin e takimeve të tilla.

25.2 Pronësia e Portit të Integruar në Triport Vlorë

Pavarësisht se Territori i Projektit dhe Porti referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 163, datë 17.3.2021 "Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të portit të peshkimit në Triport, Vlorë", ka kaluar në përgjegjësi administrimi të Autoritetit Kontraktor, gjatë gjithë Periudhës së Vlefshmërisë së Kontratës, përveç kur në këtë Kontratë është përcaktuar ndryshe, Shoqëria Koncesionare është përgjegjëse për ruajtjen dhe riparimet e dëmtimit të Territorit të Projektit në përputhje me këtë Kontratë dhe deri në përfundim të saj.

Neni 26

Siguria

26.1 Shoqëria Koncesionare angazhohet që Nënkontraktorët e saj të respektojnë legjislacionin në fuqi që rregullon sigurinë në punë dhe që të plotësohen kërkesat në lidhje me të.

26.2 Shoqëria Koncesionare bashkëpunon në çdo hetim të kryer nga Autoriteti Kontraktor, ose në emër të këtij të fundit, në lidhje me shkeljen e sigurisë në punë, ose të sigurisë së veprimtarisë për kryerjen e Punimeve ose Shërbimeve.

Neni 27

Emergjencat

27.1 Të Përgjithshme

Shoqëria Koncesionare e mirëmban Portin në raste emergjence, në përputhje me Standardet e përcaktuara në Dokumentat e Ofertës së Koncesionarit, Projekt Zbatimin e miratuar, dhe me Standardet e përcaktuara në këtë Kontratë.

27.2 Monitorimi nga Autoriteti Kontraktor

Në çdo kohë gjatë periudhës se Punimeve të Ndërtimit si dhe gjatë periudhës së Mirëmbajtjes, Autoriteti Kontraktor ose sipas rastit Autoriteti Përkatës mund t'i bëjë kontrolle Koncesionarit, duke përfshirë kontrollin e cilësisë së ofrimit të Shërbimeve dhe të Standardit të Punimeve, në përputhje me këtë Kontratë. Shoqëria Koncesionare i ofron Autoritetit Kontraktor çdo bashkëpunim që mund të kërkohet nga ky i fundit në mënyrë të arsyeshme (të tillë si ai i ofrimit të të dhënave sipas kërkesës, dhe për t'i dhënë mundësi Autoritetit Kontraktor të marrë pjesë në monitorimin e ecurisë së punëve etj). Autoriteti Kontraktor e informon Shoqërinë Koncesionare për rezultatet e këtyre kontrolleve

Neni 28

Pagesat

28.1 Pagesat e Autoritetit Kontraktor

28.1.1. Pagesa që Autoriteti Kontraktor do të paguajë gjatë gjithë kohëzgjatjes së Kontratës për realizimin e objektit të saj është 59,290,537 (pesëdhjetenëntë milion e dyqindenëntëdhjetë mijë e pesëqindetridhjeteshtatë) Euro plus TVSH-në, ku TVSH-ja do të trajtohet sipas Ligjit përkatës në fuqi, për TVSH-në. Kjo pagesë e Autoritetit Kontraktor do të paguhet sipas Modelit Financiar të rënë dakord mes Palëve dhe këtij neni, në përputhje me shtojcën nr.3, përveç rastit të parashikuar në pikën 20.4 të kontratës, ku kjo pagesë do të paguhet sipas modelit financiar të rishikuar nga koncesionari, pas miratimit paraprak të këtij modeli financiar të rishikuar, nga Autoriteti Kontraktor si dhe nga Ministria përgjegjëse për Financat. Vlera në Euro, do të konvertohet në lekë sipas kursit të këmbimit valutor, të dakortësuar mes palëve dhe të miratuar nga Ministra e Financave dhe Ekonomisë, brenda 2 (dy) javësh, para datës që do të fillojnë pagesat nga Autoriteti Kontraktor. Në rast mosdakortësie apo mos miratimi nga MFE i kursit të këmbimit, brenda afatit të sipërcituar, palët do i referohen përcaktimeve të shtojcës 17 të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese. Pagesat do të fillojnë të kryhen nga Autoriteti Kontraktor kundrejt Shoqërisë Koncesionare jo më parë se tre vite nga Data e efektive e kontratës, pasi të jenë kryer 100% e volumit të Punimeve, të parashikuara në grafikun e Punimeve (pjesë e Projekt Zbatimit), të konfirmuara nga Inxhinieri i Pavarur. Autoriteti Kontraktor do të kryejë pagesat (përveç vitit të fundit) në bazë vjetore në fillim të çdo viti kalendarik, brenda muajit janar me përjashtim të kështit të parë në vitin e parë të pagesës i cili do të paguhet pasi të jenë kryer 100% e volumit të Punimeve, të parashikuara në grafikun e Punimeve (pjesë e Projekt Zbatimit të miratuar), brenda një muaji nga kalimi i afatit 3 vjeçar të datës efektive të kontratës, siç është parashikuar në Modelin Financiar. Në vitin e fundit, do të kryhet pagesa vjetore në 2 këste te barabarta, njëra në fillim të vitit respektiv dhe tjetra, në fund të atij viti, e cila përkon dhe me përfundimin e periudhës së Koncesionit/PPP. Për efekt të llogaritjes, 1 (një) Vit Kalendarik sipas këtij neni, do ti referohet një periudhe kohore prej 365 (treqindegjashtëdhjetepesë) ditësh nga data 1 Janar deri më datë 31 Dhjetor.

28.1.2 Gjatë Periudhës Ndërtimore të Portit deri në përfundim të saj, Shoqëria Koncesionare çdo muaj, do të hartojë situacionet Mujore të ndërtimit dhe faturën tatimore Mujore përkatëse, të cilat konfirmohen nga Inxhinieri i Pavarur. Situacionet mujore dhe fatura tatimore përkatëse hartohen në Euro dhe i dorëzohet Autoritetit Kontraktor, i cili do të paguajë Pagesat e Autoritetit Kontraktor në përputhje me përcaktimet e kësaj kontrate.
Në rastin e pagesave në lidhje me rastet e kompensimit për Shkaqet e Kompensimit, Shoqëria Koncesionare i dërgon Autoritetit Kontraktor situacionet e Punimeve të miratuara nga Inxhinieri i Pavaruar (nëse pagesat lidhen me Shërbime për të cilat duhet të hartohet situacioni i Punimeve), faturat tatimore përkatëse si dhe çdo dokumentacion tjetër në lidhje me shpenzimet e përballuara nga Shoqëria Koncesionare si rezultat i Shkakut të Kompensimit. Situacioni i Punimeve dhe fatura tatimore përkatëse hartohen në Euro.

28.1.3 Çdo verifikim i mundshëm që Autoriteti Kontraktor mund të bëjë lidhur me faturimet, nuk duhet të përbëjë shkak për pengimin e pagesave. Autoriteti Kontraktor do të fillojë të kryejë pagesat në përputhje me përcaktimet e pikës 28.1.1 brenda një afati maksimal prej 20 (njëzet) ditësh kalendarike nga data e dorëzimit të Dokumentacionit të përcaktuar në

paragrafin e mësipërm, përveç rasteve kur konstatohen pasaktësi ose mungesë dokumentacioni. Pagesat përfshirë edhe TVSH-në kryhen në Lekë ("ALL"), sipas kursit të këmbimit valutor të përcaktuar në pikën 28.1.1. Moskryerja e Pagesave të Autoritetit Kontraktor në përputhje me këtë nen do të konsiderohet sipas rastit si Shkak Lehtësimi dhe/ose Shkak Kompensimi, veç e veç ose së bashku.

28.2 Kryerja e Pagesave – Vonesat

28.2.1 Për çdo rast kur pagesa sipas pikës 28.1.1 nuk kryhet në afat, atëherë mbi vlerën e kështit do të parashikohet edhe një penalitet ditor i përllogaritur në masën 0,3 % të vlerës së kështit të papaguar. Në rast se një kést është i papaguar dhe kështi pasardhës nuk paguhet brenda afatit, atëherë kështi i mëparshëm vazhdon të akumulojë penalitetin e sipërpërmendur, ndërsa kështi ndjekës i papaguar do të ketë një penalitet ditor vonese prej 0,5% për aq kohë sa kështi i mëparshëm do të vazhdojë të jetë i papaguar. Në momentin kur kështi i mëparshëm paguhet, atëherë kështi ndjekës i papaguar do të fillojë të akumulojë një penalitet vonese prej 0,3 % të vlerës së tij, duke filluar nga dita që kështi i mëparshëm është paguar. Në rast të dy ose më shumë kësteve të papaguara, atëherë çdo kést i papaguar pas kështit të dytë të papaguar, do të ketë një penalitet që rritet me 0,5% mbi penalitetin e kështit që i paraprin dhe që vazhdon të jetë i papaguar.

28.2.2 Menjëherë me lindjen e detyrimit të penaliteteve për autoritetin kontraktor, Shoqëria Koncesionare do të dërgojë një dokument zyrtar tek Autoriteti Kontraktor për pagesën e penaliteteve. Dokumenti përcakton pagesat e vonuara dhe vlerën përkatëse të penaliteteve për t'u paguar. Shoqëria Koncesionare lëshon faturën tatimore përkatëse (nëse kërkohet nga Ligjet në fuqi) në rast se nuk ka ndonjë pretendim brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor.

28.3 Pretendimet e Autoritetit Kontraktor

28.3.1 Kur Autoriteti Kontraktor vetë ose nëpërmjet Autoritetit përkatës, e kundërshton pagesën e kështit duke pretenduar mos kryerjen e Punimeve të Ndërtimit sipas Standardit dhe sipas grafikut të Punimeve të Projekt Zbatimit, Autoriteti Kontraktor e njofton me shkrim Shoqërinë Koncesionare dhe Inxhinierin e Pavarur në lidhje me kundërshtimet e tij, jo më vonë se 10 (dhjetë) Ditë Pune nga dita që Autoriteti Kontraktor merr faturën dhe situacionin e Punimeve, duke deklaruar arsyet dhe çdo provë të disponueshme që ka, për të konfirmuar deklaratat e tij, të cilat kundërshtojnë informacionin e paraqitur nga Shoqëria Koncesionare. Nëse Autoriteti Kontraktor nuk e kundërshton faturën, Standardin dhe situacionin e Punimeve dhe afatin e kryerjes së tyre sipas Projekt Zbatimit të miratuar, brenda afatit të mësipërm, atëherë ato konsiderohen si të pranuara; dhe

28.3.2 Autoriteti Kontraktor është i detyruar të paguajë çdo pjesë të vlerës së kështit të parashikuar në Modelin Financiar për situacionin e Punimeve që nuk është kundërshtuar nga Autoriteti Kontraktor. Kundërshtimet në lidhje me realizimin e Punimeve sipas grafikut dhe vlerat e kësteve konkrete, nuk do të pengojnë Palët në vazhdimin e kryerjes së pagesës së kësteve dhe të situacioneve të mëpasshme, gjithnjë nëse nuk ka kundërshtime.

28.4 Përgjigja e Inxhinierit të Pavarur

28.4.1 Brenda 5 (pesë) Ditësh Pune nga marrja e njoftimit të Autoritetit Kontraktor,

Inxhinieri i Pavarur bën vlerësimin e pretendimeve të Autoritetit Kontraktor si dhe njofton Autoritetin Kontraktor nëse pranon apo refuzon pretendimet e këtij të fundit dhe;

28.4.2 Nëse Inxhinieri i Pavarur i pranon argumentat dhe pretendimet e paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, atëherë Shoqëria Koncesionare ka të drejtë të zbatojë pikën 28.5 brenda 5 (pesë) Ditësh Pune nga marrja e njoftimit të vendimit të Inxhinierit te Pavarur. Në rast te kundërt vendimi i Inxhinierit të Pavarur quhet përfundimtar.

28.4.3 Nëse Inxhinieri i Pavarur nuk është dakord me pretendimet e paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, atëherë Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të zbatojë pikën 28.5 brenda 5 (pesë) Ditësh Pune nga marrja e njoftimit të vendimit të Inxhinierit të Pavarur. Në rast të kundërt vendimi i Inxhinierit të Pavarur quhet përfundimtar.

28.5 Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Në rast se Palët kanë vendosur zbatimin e kësaj pike, atëherë brenda 7 (shtatë) Ditëve Pune nga kërkesa e Palës për zbatimin e kësaj pike, Palët do të mbajnë një takim të parë së bashku edhe me Inxhinierin e Pavarur për të diskutuar në detaj argumentat e Palëve si dhe të Inxhinierit në lidhje me eurinë e zbatimit të Projektit dhe respektimit të afateve. Palët do te mbajnë gjithsej 2 (dy) takime me një hapësirë kohore prej 3 (tre) Ditësh Pune njëra nga tjetra. Në fund të takimeve Inxhinieri i Pavarur do të dalë me një vendim, i cili është i detyrueshëm për Palët përveçse kur ato vendosin të zbatojnë nenin 52 të kësaj Kontrate.

Neni 29

Modeli Financiar

Jo më vonë se 30 (tridhjetë) Ditë Pune nga data e Përmbylljes Financiare, Koncesionari i dërgon Autoritetit Kontraktor një version të shkruar dhe një version elektronik të Modelit Financiar, të cilët duhet të jenë të njëjtë me njëri-tjetrin, në 2 (dy) kopje, të vërtetuara nga një drejtues i Koncesionarit që ka dijeni për faktet si të vërteta dhe korrekte. Koncesionari duhet të dorëzojë informacion në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Autoritetin Kontraktues për Modelin e Financimit të vendosur për qëllimet e projektit, ku do të jenë specifikuar dhe kontributet përkatëse të kapitalit të ortakëve , duke e shoqëruar me vërtetime bankare që mbështesin kapitalin, kontrata huamarrje apo mjete të tjera që provojnë bazueshmërinë e paketës financiare. Modeli Financiar i dërguar sipas këtij Neni dhe Nenit 1 "Perkufizime dhe Interpretime", "Modeli Financiar", shkronja "b", do të bëhet i vlefshëm me miratim paraprak nga Autoriteti Kontraktor si dhe nga Ministria përgjegjëse për financat. Nëse Autoriteti Kontraktor vendos ta miratojë, atëherë ky miratim duhet të bëhet brenda 20 (njëzet) Ditëve Pune pas dorëzimit nga Koncesionari. Në çdo rast Modeli Financiar do jetë në përputhje me kushtet e kësaj kontrate dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 30

Shkak Kompensimi

30.1 Në rast se, si rrjedhojë e një Shkaku Kompensimi:

a) Shoqëria Koncesionare vonohet në kryerjen e Punimeve sipas Programit; ose

h) Shoqëria Koncesionare nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e tjera të saj që rrjedhin nga kjo Kontratë; ose

i) Shoqërisë Koncesionare i kanë lindur ose do t'i lindin kosto që nuk do t'i kishin lindur, apo nuk ka gjeneruar ose nuk do të gjenerojë të ardhura që ndryshe do të ishin gjeneruar, po të mos kish ndodhur një Shkak i tillë Kompensimi,

Koncesionari/Shoqëria Koncesionare mund të kërkojë përfitimet e mëposhtme të aplikueshme sipas rastit, në formën e:

i) Një shtyrjeje të datës së programuar të përfundimit të Portit të Integruar në Triport Vlorë për vonesën e pësuar nga Shoqëria Koncesionare sipas programit të saj;

ii) Përjashtimit nga përmbushja e detyrimeve të tij për aq dhe në masën sa ato janë prekur nga ndodhja e Shkakut të Kompensimit;

iii) Të drejtës për kompensim; dhe/ose

iv) Mosaplikimit të dispozitave për zgjidhjen e Kontratës për Mospërmbushjen e Detyrimeve të Koncesionarit /Shoqërisë Koncesionare për aq sa Shkaku i Kompensimit ka shkaktuar mospërmbushjen ose ka kontribuar materialisht për të.

30.2 Përveçse kur vonesa në zbatimin e afateve të poshtëpërmendura të njoftimit nuk është shkaktuar nga Koncesionari ose është shkaktuar për arsye që nuk varen nga Koncesionari, Shoqëria Koncesionare siguron përfitime si më sipër, në rrethana kur ka njoftuar Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e Pavarur (i cili e ka konfirmuar/vlerësuar të drejtë) për kërkesën e saj për të marrë ndonjë prej këtyre përfitimeve pa vonesa të tepërta, por gjithsesi, jo më vonë se maksimumi:

30.2.1 30 (tridhjetë) Ditë Pune pasi Shoqëria Koncesionare ka marrë dijeni për ndodhjen e Shkakut të Kompensimit; dhe

30.2.2 jo më vonë se 30 (tridhjetë) Ditë Pune pas dorëzimit të njoftimit të përmendur në pikën 30.2.1 më sipër

a) I ka dhënë Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të Pavarur një shpjegim të plotë dhe të hollësishëm për Shkakun e Kompensimit dhe përfitimet e kërkuara;

b) Në rastin e një vonese, e ka njoftuar Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e Pavarur për kohëzgjatjen e përafërt të kësaj vonese;

c) E ka vënë në dijeni Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e Pavarur për çdo informacion tjetër përkatës, që lidhet me Shkakun e Kompensimit; dhe

d) E ka njoftuar Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e Pavarur për humbjen e pritshme të të ardhurave, ose për një rritje të kostove që rezultojnë nga një Shkak Kompensimi, me kusht që, në rast se informacioni i plotë nuk është i disponueshëm brenda 30 (tridhjetë) Ditësh Pune nga dhënia e njoftimit, Shoqëria Koncesionare të dërgojë një njoftim ku të parashtrojë të gjithë informacionin e disponueshëm dhe çdo 10 (dhjetë) Ditë Pune pas

paraqitjes të këtij njoftimi i'u japë informacion të mëtejshëm Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të Pavarur; dhe

Nëse Shoqëria Koncesionare i ka përmbushur detyrimet e parashikuara në këtë nen dhe Inxhinieri i Pavarur e ka bërë një njoftim, ku deklaron se ka ndodhur një Shkak Kompensimi dhe se Shoqërisë Koncesionare i duhet bequr përkatësisht përgjegjësia për mospërmbushjen e detyrimit të saj, atëherë:

i. Kur është e përshtatshme, data e programuar e përfundimit të portit shtyhet për një periudhë kohe të përcaktuar nga Inxhinieri i Pavarur, por gjithsesi jo më të shkurtër sesa periudha e vonesës e shkaktuar nga Shkaku i Kompensimit; dhe

ii. Nëse Shoqëria Koncesionare i ka bërë, ose do të bëjë shpenzime shtesë, ose ka pësuar ose do të pësojë humbje të të ardhurave, që ndryshe nuk do t'i kishte bërë/do t'i kishte gjeneruar, po të mos kish ndodhur një Shkak i tillë Kompensimi, Autoriteti Kontraktor e rimburson Shoqërinë Koncesionare për shpenzime të tilla dhe/ose humbje të të ardhurave, me qëllim që të kthejë Shoqërinë Koncesionare në një gjendje që nuk është as më e mirë as më e keqe se më parë. Shuma e një rimbursimi të tillë do të përcaktohet, për aq sa është e mundur, me anë të përdorimit të Modelit Financiar; dhe

iii. Autoriteti Kontraktor nuk e ushtron të drejtën e tij të Përfundimit të Parakohshëm të Kontratës për shkak të Mospërmbushjeve nga Koncesionari të detyrimeve të tij, shkaktuar nga Shkaku i Kompensimit; dhe

iv. Autoriteti Kontraktor i ofron Shoqërisë Koncesionare mundësinë e përjashtimit nga detyrimet e tij, që rjedhin nga kjo Kontratë, të cilat përcaktohen nga Inxhinieri i Pavarur,

me kusht që, nëse Shoqëria Koncesionare ose Autoriteti Kontraktor nuk bien dakord me njoftimin me shkrim të bërë nga Inxhinieri i Pavarur, çdo mosmarrëveshje të vendoset në përputhje me paragrafin si më poshtë. Njoftimi me shkrim i Inxhinierit të Pavarur është detyrues për Palët, përveçse kur njëra nga Palët e kundërshton atë brenda 7 (shtatë) Ditëve Pune nga data e njoftimit të Inxhinierit të Pavarur në lidhje me ndodhjen e një Shkaku Kompensimi, në përputhje me procedurën e mëposhtme:

Brenda 7 (shtatë) Ditëve Pune nga kundërshtimi i Palës, Palët do të mbajnë një takim të parë së bashku edhe me Inxhinierin e Pavarur për të diskutuar në detaj argumentat e Palëve si dhe të Inxhinierit të Pavarur në lidhje me Shkakun e Kompensimit. Palët do të mbajnë gjithsej 2 (dy) takime me një hapësirë kohore prej 3 (tre) Ditësh Punë njëra nga tjetra. Në fund të takimeve Inxhinieri i Pavarur do të dalë me një vendim përfundimtar i cili është i detyrueshëm për Palët përveçse kur ato vendosin të zbatojnë nenin 52 të kësaj Kontrate. Palët bien dakord që, nëse Autoriteti Kontraktor vendos ti drejtohet Procesit të Arbitrazhit sipas nenit 52 të kësaj Kontrate për të zgjidhur mosmarrëveshjen e lindur sipas këtij Neni, atëherë deri në marrjen e një vendimi të Gjykatës, Shoqëria Koncensionare ka të drejtën, por jo detyrimin, që të pezullojë kryerjen e mëtejshme të Punimeve të Ndërtimit apo Mirëmbajtjen.

30.3 Përveçse sipas parashikimeve të pikës 30.2, nëse Shoqëria Koncensionare nuk i jep Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të Pavarur informacionin deri në njërin nga afatet e parashikuara, ai nuk merr asnjë nga përfitimet e lartpërmendura si rezultat i Shkakut të Kompensimit.

30.4 Shoqëria Koncesionare është e detyruar të njoftojë Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e Pavarur menjëherë në rast se merr dijeni për ndonjë informacion tjetër dhe/ose material në lidhje me një Shkak Kompensimi, si dhe të njoftojë Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e Pavarur për hollësitë e një informacioni të tillë, të cilat janë të reja ose që rregojnë se informacioni i dhënë më parë ka qenë materialisht i pasaktë dhe/ose i gabuar.

30.5 Në çdo rast metoda e rimbursimit do të aplikohet duke mbajtur në konsideratë legjislacionin shqiptar të aplikueshëm në fuqi.

Neni 31

Shkaqe Lehtesimi

31.1 Kur si rrjedhojë e një Shkaku Lehtësimi:

31.1.1 Shoqëria Koncesionare nuk është në gjendje të kryejë Punimet me qëllim që të mund të sigurojë Certifikatën e Përfundimit, të ndërtimit të Portit të Integruar, në Triport Vlorë, deri në datën e programuar të përfundimit; ose

31.1.2 Shoqëria Koncesionare nuk është në gjendje të përmbushë ndonjërin prej detyrimeve të saj që rrjedhin nga kjo Kontratë;

atëherë

Shoqëria Koncesionare mund të sigurojë përfitimet e mëposhtme të aplikueshme sipas rastit, në formën e:

(i) Shtyrjes të datës së programuar të përfundimit të ndërtimit të portit, që i përshtatet vonesës së shkaktuar Koncesionarit në bazë të Programit të tij; dhe/ose

(ii) Lehtësimit nga detyrimet e tij ose shtyrja e zbatimit të tyre, për aq dhe deri në masën sa ato janë prekur nga ndodhia e Shkakut Lehtësues; dhe/ose

(iii)Pas dhënies së lejes së Certifikatës së Përfundimit/akt kolaudimit në lidhje me Portin e Integruar në Triport Vlorë, në rastin e një Shkaku Lehtësues si rezultat i të cilit Koncesionari nuk është në gjendje të përmbushë të gjitha ose një pjesë materiale të detyrimeve të tij që rrjedhin nga kjo Kontratë, për një periudhë më shumë se 2 (dy) javë, ose për shkak të ndonjë arsyeje tjetër të vlefshme, e cila, ka shkaktuar një vonesë prej më shumë se 2 (dy) Muajsh (periudhë e cila përfshin çdo Shkak Lehtësues që ndodh përpara dhënies së Certifikatës së Përfundimit në lidhje me portin), pas miratimit/ konfirmimit nga Inxhinieri i Pavarur, përfiton mos-aplikimin e dispozitave për zgjidhjen e Kontratës për shkak të Mospërmbushjeve nga Shoqëria Koncesionare të detyrimeve të saj, për aq sa Mospërmbushja nga Shoqëria Koncesionare e detyrimeve ka ardhur si rrjedhojë e një Shkaku Lehtësues, apo nëse një shkak i tillë ka kontribuar në shkallë thelbësore.

31.2 Përveçse kur vonesa në zbatimin e afateve të poshtëpërmendura të njoftimit nuk është shkaktuar nga Koncesionari ose është shkaktuar për arsye që nuk varen nga Koncesionari, Koncesionari siguron përfitime të tilla vetëm në rrethanat kur ai:

31.2.1 E ka njoftuar Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e Pavarur për kërkesën e tij për t'i dhënë ndonjë nga këto përfitime pa vonesë, por gjithsesi jo më vonë se maksimumi 30

(tridhjetë) Ditë Pune pasi Koncesionari ka marrë dijeni për ndodhjen e Shkakut të Lehtësimit; dhe

31.2.2 Jo më vonë se 30 (tridhjetë) Ditë Pune pas dorëzimit të njoftimit sipas pikës 31.2.1 më lart;

a) I ka dhënë Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të Pavarur një shpjegim të plotë rreth Shkakut Lehtësues dhe përfitimeve të kërkuara;

b) Në rastin e një vonese të shkaktuar nga Shkaku i Lehtësimit, e ka njoftuar Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e Pavarur për kohëzgjatjen e vlerësuar të një vonese të tillë, dhe

c) E ka njoftuar Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e Pavarur per çdo informacion tjeter përkatës, me kusht që, nëse informacioni i plotë nuk është i disponueshëm brenda 30 (tridhjetë) Ditësh Pune nga dhënia e njoftimit sipas pikës 31.2.1, Shoqëria Koncesionare do t'u dërgojë një njoftim Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të Pavarur, ku të paraqesë të gjithë informacionin e disponueshëm dhe më pas t'u japë informacion të mëtejshëm çdo 7 (shtatë) Ditë Pune pas paraqitjes së këtij njoftimi; dhe

31.2.3 Ti ketë provuar Inxhinierit të Pavarur se:

a) Shkaku Lehtësues ka rezultuar në shtyrjen e Datës së Programuar të Përfundimit të ndërtimit të Portit të Integruar në Triport Vlorë, ose në Mospërmbushjen e Detyrimeve të tjera të Shoqërisë Koncesionare;
dhe

b) Shoqëria Koncesionare i ka bërë të gjitha përpjekjet e arsyeshme, në varësi të Shkakut të Lehtësimit, që mund t'i kërkohen Shoqërisë Koncesionare në mënyrë të arsyeshme, në përputhje me Praktikën e Mirë të Industrisë, për të parandaluar ose zbutur pasojat e Shkakut të Lehtësimit. Për shmangien e çdo dyshimi, përfitimi i kërkuar i korrespondon vetëm një pjese të tillë të pasojave të Shkakut të Lehtësimit, e cila nuk mund të ishte parandaluar apo zbutur nga Shoqëria Koncesionare.

31.3 Nëse Shoqëria Koncesionare i ka kryer detyrimet e parashikuara në pikës 31.2 dhe Inxhinieri i Pavarur ka dhënë një njoftim me shkrim ku deklaron se ka ndodhur një Shkak Lehtësimi, dhe përcakton ndihmën e duhur që i duhet dhënë Koncesionarit në përputhje me këtë pikë, atëherë:

a) Sipas rastit, data përkatëse e programuar për përfundimin e ndërtimit të portit shtyhet me një periudhë kohe që përcaktohet nga Inxhinieri i Pavarur, por gjithsesi jo më të shkurtër sesa periudha e vonesës së shkaktuar nga Shkaku i Lehtësimit; dhe

b) Autoriteti Kontraktor nuk e ushtron të drejtën e tij për përfundimin e parakohshëm të Kontratës për shkak të Mospërmbushjeve të Detyrimeve nga Koncesionari/Shoqëria Koncesionare, në lidhje me një shkelje të detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate, shkaktuar nga Shkaku Lehtësues; dhe

c) Autoriteti Kontraktor e përjashton Shoqërinë Koncesionare nga detyrimet e saj, që

rjedhin nga kjo Kontratë, të cilat përcaktohen nga Inxhinieri i Pavarur, me kusht që, nëse Shoqëria Koncesionare ose Autoriteti Kontraktor nuk bien dakord me njoftimin me shkrim të Inxhinierit të Pavarur, dhënë në përputhje me këtë nen, çdo mosmarrëveshje të vendoset në përputhje me procedurën e mëposhtme:

i) Brenda 5 (pesë) Ditëve Pune nga marrja e njoftimit me shkrim të Inxhinierit të Pavarur, Palët do të mbajnë një takim të parë së bashku edhe me Inxhinierin e Pavarur për të diskutuar në detaj argumentat e Palëve si dhe të Inxhinierit të Pavarur në lidhje me shkakun e kompensimit.

ii) Palët do të mbajnë gjithsej 2 (dy) takime me një hapësirë kohore prej 3 (tre) Ditësh Pune nga njëri-tjetri. Inxhinieri i Pavarur do të dalë me një vendim i cili është bërë i detyrueshëm për Palët përveçse kur ato vendosin të zbatojnë nenin 52 të kësaj Kontrate. Palët bien dakord që, nëse Autoriteti Kontraktor vendos t'i drejtohet Procesit të Arbitrazhit sipas nenit 52 të kësaj Kontrate për të zgjidhur mosmarrëveshjen e lindur sipas këtij Neni, atëherë deri në marrjen e një vendimi të Gjykatës, Shoqëria Koncensionare ka të drejtën, por jo detyrimin, që të pezullojë kryerjen e mëtejshme të Punimeve të Ndërtimit apo Mirëmbajtjen.

31.4 Përveçse sipas parashikimeve të pikës 30.2, në rast se Shoqëria Koncesionare nuk u jep informacion Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të Pavarur deri në njërin nga afatet e parashikuara në këtë nen, ai nuk do të marrë asnjë nga përfitimet e mësipërme që rjedhin nga Shkaku i Lehtësimit, derisa të dërgojë një informacion të tillë brenda afatit.

31.5 Shoqëria Koncesionare është e detyruar të njoftojë Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e Pavarur pa vonesa të tepërta në rast se merr dijeni për ndonjë informacion tjetër material në lidhje me një Shkak të paparashikuar Lehtësues si dhe të njoftojë Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e Pavarur për hollësitë e një informacioni të tillë, të cilat janë të reja ose që tregojnë se informacioni i dhënë më parë ka qenë materialisht i pasaktë dhe/ose i gabuar.

31.6 Në rastin kur një Shkak Lehtësimi, ose pasojat e tij vazhdojnë të mbeten të tilla që:

a) Në varësi të nenit 31, vonesa në dhënien e Certifikatës së Përfundimit paraprak ose Certifikata e Përfundimit kalon 12 (dymbëdhjetë) Muaj; ose

b) Në varësi të nenit 31, Shoqëria Koncesionare nuk është në gjendje të përmbushë të gjithë ose një pjesë materiale të detyrimeve të saj, që rjedhin nga kjo Kontratë, për një periudhë që i kalon 12 (dymbëdhjetë) Muaj,

Të dyja Palët do të takohen për të gjetur një zgjidhje të kënaqshme, që ka të bëjë me të tilla Shkaqe të zgjatura Lehtësimi. Nëse të dy Palët nuk bien dakord për vazhdimin e përfitimeve të Shkakut të Lehtësimit brenda 30 (tridhjetë) ditësh, secila nga Palët mund ta zgjidhë këtë Kontratë në përputhje me nenin 52.

c) Në rastin kur Shkaku i Lehtësimit, i përshkruar në shkronjën (d) të përkufizimeve te Shkaku i Lehtësimit, vazhdon ose pasojat e tij vazhdojnë te mbeten të tilla që:

i. Vonesa në dhënien e Certifikatës së Përfundimit i tejkalon 6 (gjashtë) Muaj; ose

i. Shoqëria Koncesionare nuk është në gjendje që të përmbushë të gjitha ose një pjesë të rendësishme të detyrimeve të saj që rrjedhin nga kjo Kontratë për një periudhë që i tejkalon 6 (gjashtë) Muaj.

Të dyja Palët do të takohen për të gjetur një zgjidhje të kënaqshme që ka të bëjë me të tilla Shkaqe Lehtësimi. Nëse të dy Palët nuk bien dakord për vazhdimin e përfitimeve për Shkaqet e Lehtësimit brenda 30 (tridhjetë) ditësh, secila nga Palët mund ta zgjidhë këtë mosmarreveshje në përputhje me nenin 52.

Neni 32

Ngjarje të Forcës Madhore

32.1 Asnjë Palë nuk ka të drejtë të bëjë një padi ndaj Palës tjetër për shkelje të detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate, për shkak të një Ngjarjeje të Forcës Madhore dhe në masën që një Ngjarje e Forcës Madhore e pengon të kryejë detyrimet e veta.

32.2 Kur ndodh një Ngjarje e një Force Madhore, Pala e Prekur e njofton Palën tjetër pa vonesa të panevojshme. Njoftimi përfshin hollësitë për ndikimin e kësaj ngjarjeje në detyrimet e Palës së Prekur dhe për çdo veprim të propozuar për zbutjen e pasojave të saj.

32.3 Pa vonesa të tepërta, pas një njoftimi të tillë Palët konsultohen me njëra tjetrën me mirëbesim dhe bëjnë përpjekje të arsyeshme për të rënë dakord për kushtet e përshtatshme për zbutjen e efekteve të Ngjarjes së shkaktuar nga Forca Madhore dhe për të lehtësuar realizimin në vijimësi të Kontratës.

32.4 Kur Palët nuk bien dakord për kushte të tilla brenda 6 (gjashtë) Muajsh nga data e fillimit të Ngjarjes së shkaktuar nga Forca Madhore, dhe një forcë e tillë madhore vazhdon, ose pasojat e saj vazhdojnë të jenë të tilla saqë Pala e Prekur nuk është në gjendje t'i përmbushë të gjitha, ose pjesën më të madhe të detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate, secila nga Palët mund ta zgjidhë këtë Kontratë, duke i dhënë një njoftim paraprak 30 (tridhjetë) ditë përpara Palës tjetër ("Njoftim për Përfundimin e Kontratës për Shkak të Ngjarjeve të Forcës Madhore").

32.5 Nëse si rezultat i një Ngjarjeje të shkaktuar nga një Force Madhore:

a) Shoqëria Koncesionare nuk është në gjendje të kryejë Punimet me qëllim që të këtë mundësi të marrë certifikimet, Certifikatën e Përfundimit dhe miratimet përkatëse në lidhje me përfundimet e Punimeve sipas afateve të parashikuara, deri në datën e përcaktuar sipas grafikut të ekzekutimit të Punimeve; ose

b) Shoqëria Koncesionare nuk është në gjendje të përmbushë ndonjë nga detyrimet e tjera të saj që rrjedhin nga kjo Kontratë; atëhere

Koncesionari mund të marrë një përfitim në formën e:

i) Një shtyrjeje të datës së programuar të përfundimit të Punimeve të portit, në përputhje me vonesën e pësuar nga Koncesionari sipas Programit të saj;

ii) Përjashtimin nga detyrimet e saj për aq sa ato preken nga Ngjarja e Forcës Madhore;
iii)Përjashtim nga zgjidhja e Kontratës për faj të Koncesionarit për aq sa mospërmbushja është shkaktuar ose është ndikuar materialisht nga ekzistenca e Ngjarjes së Forcës Madhore.

32.6 Koncesionari mund të pretendojë përfitime të tilla vetëm në rrethana kur e ka njoftuar Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e Pavarur për kërkesën e tij për t'i dhënë ndonjë nga këto përfitime pa vonesa të tepërta, por gjithsesi jo më vonë se maksimumi:

a) Brenda 10 (dhjetë) Ditë Pune pasi Koncesionari ka marrë dijeni për ndodhjen e një Ngjarjeje të Forcës Madhore; ose

b) Brenda 30 (tridhjetë) Ditë Pune pas ngjarjes së shkaktuar nga Ngjarja e Forcës Madhore;

32.7 Nëse si rezultat i një Ngjarjeje të shkaktuar nga nje Force Madhore Autoriteti Kontraktor nuk është në gjendje të përmbushë ndonjë nga detyrimet e tij që rrjedhin nga kjo Kontratë, atëherë Autoriteti Kontraktor mund të marrë një përfitim në formën e:

a) Përjashtimit nga detyrimet e tij për aq sa ato preken nga Ngjarja e Forcës Madhore;
b) Përjashtimit nga zgjidhja e Kontratës për faj të Autoritetit Kontraktor për aq sa mospërmbushja është shkaktuar ose është ndikuar materialisht nga ekzistenca e Ngjarjes së Forcës Madhore.

32.8 Autoriteti Kontraktor mund të pretendojë përfitime të tilla vetëm në rrethana kur e ka njoftuar Koncesionarin dhe Inxhinierin e Pavarur për kërkesën e tij për t'i dhënë ndonjë nga këto përfitime pa vonesa të tepërta, por gjithsesi jo më vonë se maksimumi:

a) Brenda 10 (dhjetë) Ditë Pune pasi autoriteti kontraktues ka marrë dijeni për ndodhjen e një Ngjarjeje të Forces Madhore; ose

b) Brenda 30 (tridhjetë) Ditë Pune pas ngjarjes së shkaktuar nga Ngjarja e Forcës Madhore.

Neni 33

Ndryshime në Ligj dhe Veprim Material i Pafavorshëm Qeveritar

33.1 Nëse ndodh një Ndryshim në Ligj, i cili nuk është Ndryshim Cilësues në Ligj dhe që kërkon nga Shoqëria Koncesionare të ndryshojë ose amendojë Projektin, cilësinë ose vëllimin e Punimeve apo Shërbimeve, Shoqëria Koncesionare paraqet një propozim për ndryshim në përputhje me pikën 33.2.1.

33.2 Nëse një Ndryshim Cilësues ne Ligj ndodh, ose pritet të ndodhë së shpejti, secila nga Palët mund të njoftojë Palën tjetër dhe Inxhinierin e Pavarur me shkrim për efektet e mundshme të një ndryshimi të tillë, duke specifikuar:

33.2.1 Nëse kërkohet përjashtim nga përmbushja e detyrimeve, duke përfshirë detyrimin për të arritur datën e programuar të përfundimit të ndërtimit të portit;

33.2.2 Çdo ndryshim të nevojshëm në Punime apo Shërbimet e Mirëmbajtjes që shkaktohet apo rezulton nga një Ndryshim i tillë Cilësues në Ligj;

33.2.3 Nëse kërkohet ndonjë ndryshim në kushtet e kësaj Kontrate ose të Dokumenteve të tjerë të Projektit;

33.2.4 Nëse zbatimi i Ndryshimit Cilësues në Ligj do të rezultojë drejtpërdrejt në rritjen e kostove apo në humbjen e të ardhurave të Koncesionarit;

33.2.5 Çdo Shpenzim Kapital që kërkohet për të zbatuar Ndryshimin Cilësues në Ligj, ose që mund të kursehet;

33.2.6 Çdo Miratim i Nevojshëm që do të kërkohet për të zbatuar një Ndryshim Cilësues në Ligj; dhe

33.2.7 Mënyrën në të cilën Ndryshimi Cilësues në Ligj mund të prekë çmimet e vëna nga furnitorët për Shërbimet, duke përfshirë firmat e operuara nga Aksionerët e Shoqërisë Koncesionare, ose Shoqëritë e tyre të Lidhura.

33.3 Nëse, si rezultat i një Ndryshimi Cilësues në Ligj:

33.3.1 Shoqëria Koncesionare nuk është në gjendje të kryejë Punimet, me qëllim që të jetë në gjendje të sigurojë certifikimet përkatëse në lidhje me përfundimin deri në datën e programuar për përfundimin e ndërtimit të Portit të Integruar në Triport Vlorë;

33.3.2 Shoqëria Koncesionare nuk është në gjendje të përmbushë ndonjërin nga detyrimet e saj që rrjedhin nga kjo Kontratë; ose

33.3.3 Shoqërisë Koncesionare i kanë lindur ose do t'i lindin kosto, të cilat ndryshe nuk do t'i kishin lindur, ose nuk ka gjeneruar ose nuk do të gjenerojë të ardhura, të cilat ndryshe do t'i kishte gjeneruar po të mos kishte ndodhur një Ndryshim i tillë Cilësues në Ligj,

Shoqëria Koncesionare mund të sigurojë një përfitim në formën e:

33.3.4 Shtyrjes së duhur të datës së programuar të përfundimit të Punimeve të portit;

33.3.5 Ndryshimet e nevojshme të Dokumenteve të Projektit për të marrë parasysh dhe reflektuar Ndryshimin Cilësues në Ligj;

33.3.6 Të drejtën e kompensimit; dhe/ose

33.3.7 Mos-aplikimin e dispozitave për zgjidhjen e njëanshme të Kontratës për faj të Koncesionarit, nëse ka njoftuar Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e Pavarur lidhur me këto pretendime brenda një afati jo më shumë se 60 Ditë Pune nga hyrja në fuqi e ndryshimit të Ligjit.

Palët do të takohen për të diskutuar për efektet e sjella nga Ndryshimi Cilësues i Ligjit brenda 20 (njëzet) Ditësh Pune nga aprovimi i tij dhe do të përpiqen të arrijnë një marrëveshje brenda 30 (tridhjetë) Ditësh Pune nga takimi i tyre.

Për të shmangur çdo dyshim, përfitimet e përcaktuara në pikat e mësipërme të këtij neni, nuk aplikohen në rastin e ndryshimeve në legjislacionin e Tatimeve dhe /ose Taksave me karakter të përgjithshëm, të aplikueshem në të gjitha subjektet në Republikën e Shqipërisë.

33.4 Veprimi Material i Pafavorshëm Qeveritar

33.4.1 Nëse ndodh ndonjë Veprim Material i Pafavorshëm Qeveritar, Shoqëria Koncesionare do të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktor duke dhënë hollësitë e arsyeshme të këtij veprimi dhe pasojat e tij të mundshme ekonomike për Koncesionarin. Autoriteti Kontraktor do të ketë një afat prej jo më shumë se 45 (dyzet e pesë) Ditë Pune, nga data e marrjes së këtij njoftimi me shkrim, për të bërë çdo përpjekje të mundshme për të ndrequr situatën, e cila rikthen gjendjen e përgjithshme ekonomike të Koncesionarit në atë, në të cilën do të ishte, nëse ky Veprim Material i Pafavorshëm Qeveritar nuk do të kishte ndodhur. Nëse Autoriteti Kontraktor nuk do të ndikojë në ndreqjen e tij brenda këtij afati, Palët së bashku me Inxhinierin e Pavarur do të konsultohen brenda 14 (katërmbëdhjetë) ditësh kalendarike pas skadimit të kësaj periudhe me qëllim arritjen e një zgjidhjeje të përbashkët, të pranueshme për situatën.

33.4.2 Në rast se një zgjidhje reciprokisht e kënaqshme e situatës nuk është arritur në kuadër të kësaj periudhe 14 (katërmbëdhjetë) ditore kalendarike nëpërmjet:

a) një rregullimi apo përshtatje të nevojshme, apo pagesë dhe/ose zgjatje afati, që mund të jetë e drejtë dhe e arsyeshme duke marrë në konsideratë rrethanat; dhe/ose

b) një lehtësimi monetar të drejtë dhe të arsyeshëm sipas rrethanave, dhe/ose

c) një shtyrje të Periudhës së Koncesionit,

atëherë, Koncesionari mundet që (i) të vazhdojë zbatimin e detyrimeve të tij në bazë të Kontratës duke e konsideruar Veprimin Material të Pafavorshëm Qeveritar si Shkak Lehtësimi, ose (ii) të ndërpresë Kontratën në përputhje me klauzolën për zgjidhjen e parakohshme të kontratës për Mospërmbushje te Autoritetit Kontraktor, pa asnjë përgjegjësi apo dëm, apo kosto për Koncesionarin, në rast se çdo mjet juridik tjetër i parashikuar në këtë Kontratë nuk do të jetë i mjaftueshëm për të vendosur Koncesionarin në një pozicion ekonomik të njëjtë krahasuar me pozicionin në të cilin ndodhej, përpara ndodhjes së Veprimit Material të Pafavorshëm Qeveritar, duke mbajtur parasysh të drejtat dhe detyrimet e vazhdueshme të Koncesionarit sipas kësaj Kontrate, Projektit dhe çdo marrëveshjeje tjetër të parashikuar në këtë Kontratë.

Neni 34

Ndryshime në punimet apo shërbimet

34.1 Ndryshime të kërkuara nga autoriteti kontraktor

34.1.1 Autoriteti Kontraktor mundet që të kërkojë ndryshime në Projekt Zbatim, në Punime ose në Shërbimet e Mirëmbajtjes (duke përfshirë një ndryshim në shkallën e Shërbimeve) nëpërmjet një kërkese me shkrim që ia dorëzon Koncesionarit ("**Njoftimi për Ndryshime nga Autoriteti Kontraktor**"), ku përcaktohen detajet e ndryshimit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në përputhje me këtë Kontratë. Çdo ndryshim i kërkuar dhe i propozuar duhet të rakordohet dhe dakordësohet paraprakisht me Koncesionarin. Palët do të bien dakord lidhur me kostot e ndryshimit, nese ka, përpara fillimit të punimeve apo Shërbimeve për realizimin e këtyre ndryshimeve nëpërmjet një anekси te

firmosur nga të dyja palët.

34.1.2 Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të bëjë:

a) Kërkesë, sipas të cilës Punimet e ndërtimit Portit të Integruar objekt Koncesioni i kësaj Kontrate, apo Shërbimet e Mirëmbajtjes duhen ofruar në një mënyrë që bie ndesh me Ligjin apo Praktikat e Mira të Industrisë së transportit, të ndërtimit siç është përcaktuar në Projekt Zbatim;
b) Ndryshime që kërcënojnë, ose do të kërcënonin seriozisht shëndetin apo sigurinë e Personave;
c) Ndryshime që do të ndryshonin thellësisht natyrën e Projekt Zbatimit, duke përfshirë natyrën e risqeve dhe Standardet;
d) Ndryshime që nuk bëjnë pjesë në të drejtat e Autoritetit Kontraktor;
e) Ndryshime që do të kërkonin Truall Shtesë ose Truall Ekstra (dhe një Truall i tillë Shtesë ose Truall Ekstra nuk jepet ose nuk përballohet financiarisht nga Autoriteti Kontraktor);
dhe
f) Ndryshime që do të shkaktonin heqjen, pezullimin ose ndryshimin e çdo miratimi të nevojshëm ekzistues, ose do të kërkonin një pëlqim/leje të re të nevojshme dhe kur nuk ka gjasa të arsyeshme që Shoqëria Koncesionare do të mund t'a merrte miratimin e nevojshëm, brenda afatit kohor të propozuar për zbatimin e ndryshimit të propozuar nga Autoriteti Kontraktor, dhe
g) Ndryshime që do të përbënin kosto dhe shpenzime shtesë për Shoqërinë Koncesionare, duke vënë kështu në rrezik dhe vështirësi Shoqërinë Koncesionare dhe Projektin, përveç rasteve kur Autoriteti Kontraktor merr përsipër mbulimin e menjëhershëm të shpenzimeve dhe kostove.

34.1.3 Në Njoftimin për Ndryshime, Autoriteti Kontraktor jep:

a) Detaje të mjaftueshme për ndryshimin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, me qëllim që Shoqëria Koncesionare të jetë në gjendje të kryejë një vlerësim të ndryshimit, të çmuar në kostot e Projekt Zbatimit;
b) Të dhëna mbi kostot e ndryshimit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor. Në çdo rast përballimi i kostove për ndryshimin e kërkuar do të bëhet nga Autoriteti Kontraktor;
c) Afatin kohor brenda të cilit Shoqëria Koncesionare duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor një përgjigje dhe ndryshimin e çmuar në kostot dhe të ardhurat e Projektit, por gjithsesi, një afat i tillë nuk duhet të jetë më shumë se 20 (njëzet) Ditë Pune pas dorëzimit të kërkesës së Autoritetit Kontraktor për ndryshim;
d) Opinionin e Inxhinierit të Pavarur në lidhje propozimin e Autoritetit Kontraktor.

34.1.4 Shoqëria Koncesionare i paraqet një përgjigje sa më shpejt që të jetë e mundur por gjithsesi, jo më vonë se në afatin e paraqitur në Njoftimin për Ndryshim të Autoritetit Kontraktor, i cili nuk mund të jetë më pak sesa 20 (njëzet) Ditë Pune.

34.2 Ndryshimet e propozuara nga koncesionari

34.2.1 Shoqëria Koncesionare mundet që të propozojë ndryshime në Punimet apo Shërbimet, duke i paraqitur një njoftim me shkrim Autoritetit Kontraktor ("**Njoftim për Ndryshime nga Koncesionari**").

34.2.2 Në Njoftimin e propozimit të saj për Ndryshime, Shoqëria Koncesionare bën të ditur:

a) Natyrën e ndryshimit të propozuar nga Shoqëria Koncesionare me detaje të mjaftueshme, me qëllim që t'i japë mundësi Autoritetit Kontraktor të vlerësojë propozimin në mënyrë të kualifikuar;

b) Nëse në lidhje me ndryshimin e kërkuar nga Shoqëria Koncesionare është e nevojshme të kërkohet shlyerja e detyrimeve të tij, sipas kësaj Kontrate, dhe nëse një ndryshim i tillë nga Shoqëria Koncesionare ka gjasa të shkaktojë vonesa në datën e programuar të përfundimit të ndërtimit të punimeve të portit;

c) Një shpjegim të shkaqeve për të cilat ndryshimi kërkohet nga Shoqëria Koncesionare;

d) Një shpjegim të efektit të pritshëm të ndryshimit të kërkuar nga Shoqëria Koncesionare përfshirë dhe kostot shtesë. Nëse ky ndryshim i kërkuar nga Shoqëria Koncesionare do të ketë kosto shtesë, këto kosto do të përballohen nga Shoqëria Koncesionare;

e) Nëse është e nevojshme, datën në të cilën Autoriteti Kontraktor është i detyruar të konfirmojë nëse e pranon apo e refuzon propozimin.

34.2.3 Autoriteti Kontraktor e vlerëson me mirëbesim njoftimin e Shoqërisë Koncesionare për ndryshim, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat përkatëse, përfshirë, por pa u kufizuar në:

a) Ndikimin e mundshëm të ndryshimit të kërkuar nga Shoqëria Koncesionare në realizimin e Punimeve dhe mirëmbajtjen e Portit të Integruar në Triport Vlorë0, si dhe riskun e cënimit të ecurisë së punës;

b) Ndikimin e mundshëm të ndryshimit të kërkuar nga Shoqëria Koncesionare në marrëdhëniet ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe të tretëve;

c) Opinionin e Inxhinierit të Pavarur në lidhje me propozimin e Koncesionarit;

d) Ndikimin e mundshëm të ndryshimit të kërkuar nga Shoqëria Koncesionare në gjendjen e Portit te integruar pas datës së përfundimit; dhe

e) Ndikimin e mundshëm të ndryshimit të kërkuar nga Shoqëria Koncesionare në risqet dhe kostot e përballuara nga Autoriteti Kontraktor.

34.2.4 Palët e diskutojnë brenda 20 (njëzet) Ditësh Pune Njoftimin për Ndryshim të Koncesionarit dhe Autoriteti Kontraktor mund të propozojë ndryshime të tjera dhe të pranojë ose të hedhë poshtë propozimin për ndryshim nga Koncesionari, duke argumentuar shkaqet e refuzimit, me kusht që Autoriteti Kontraktor të mos hedhë poshtë një ndryshim të propozuar nga Koncesionari, kur një ndryshim i tillë kërkohet si rezultat i një Ndryshimi në Ligj ose kur ky ndryshim është i nevojshëm si rrjedhojë e ndonjë Ngjarjeje të Forcës Madhore, Shkaku Kompensimi apo Shkaku Lehtësimi, siç parashikohet në dispozitat përkatëse të kësaj Kontrate.

34.2.5 Nëse Autoriteti Kontraktor e pranon Njoftimin për Ndryshim nga Koncesionari, Palët

bien dakord për ndryshimet e nevojshme në kushtet e kësaj Kontrate dhe në Dokumentet e tjera të Projektit.

Neni 35

Përgjegjësia dhe premtimi për zhdëmtim

35.1 Gjatë zbatimit të projektit të miratuar, Shoqëria Koncesionare merr përsipër të kompensojë dëmin, humbjen ose kërkesën për dëmshpërblim të Autoritetit Kontraktor ose të çdo Pale të Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë humbje ose kërkesë të pranuar me vendim Gjykate të formës së prerë, lidhur me plotësimin e detyrimeve të Shoqërisë Koncesionare sipas kësaj Kontrate, ose kur vertetohet se është kryer me veprime ose mosveprime të shkaktuara me faj të Shoqërisë Koncesionare, përveç në rrethana kur, dhe në masën që kërkesa për dëmshpërblim vjen nga:

35.1.1 Veprimi apo mosveprimi me dashje ose pakujdesia e Autoritetit Kontraktor ose e Palës së Autoritetit Kontraktor ose e një pale të tretë;

35.1.2 Shkelja nga Autoriteti Kontraktor e kësaj Kontrate ose e Ligjit, si dhe shkelja nga Autoriteti Përkatës;

35.1.3 Një kërkesë e një pale të tretë, që lidhet plotësisht me një periudhë përpara Datës së Hyrjes në Fuqi të kësaj Kontrate;

35.1.4 Veprimi i Shoqërisë Koncesionare sipas udhëzimeve të Përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktor dhe/ose Përfaqësuesit Teknik të Autoritetit Kontraktor dhe kur përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor dhe/ose Përfaqësues Teknik janë vënë në dijeni nga Shoqëria Koncesionare nëpërmjet një njoftimi me shkrim, se veprimi në bazë të këtyre udhëzimeve do të shkaktonte një humbje ose kërkesë për dëmshpërblim sipas këtij Neni;

35.1.5 Ndërtimi ose mirëmbajtja e portit plotësisht sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate, Ligjit dhe lejeve ekzistuese dhe e çertifikuar nga Autoritetet Përkatëse.

35.2 Në veçanti, Shoqëria Koncesionare merr përsipër të kompensojë çdo dëm, humbje, ose kërkesë për dëmshpërblim të Autoritetit Kontraktor ose ndonjë Pale të Autoritetit Kontraktor, si rezultat i:

35.2.1 Një të drejte për kompensim që rrjedh nga vdekja ose lëndimi personal i një Pale të Autoritetit Kontraktor, ose i një pale të tretë gjatë Punimeve, kur përgjegjësia e Shoqërisë Koncesionare është konstatuar me vendim Gjykate të formës së prerë;

35.2.2 Një e drejtë për kompensim që rrjedh nga një dëm, shkaktuar një prone të një Pale të Autoritetit Kontraktor, një Përdoruesi, apo një pale të tretë, kur përgjegjësia e Shoqërisë Koncesionare është konstatuar me vendim Gjykate të formës së prerë, përveç në rrethana kur kërkesa ka ardhur si rezultat i një veprimi a mosveprimi apo pakujdesie të Autoritetit Kontraktor apo të një Pale të Autoritetit Kontraktor.

35.3 Autoriteti Kontraktor, në përputhje me nenet e kësaj Kontrate, do të dëmshpërblejë plotësisht dhe në mënyrë efektive dhe do të mbajë të padëmtuar Shoqërinë Koncesionare ndaj çdo pretendimi të ndonjë pale të tretë në bazë të ngjarjeve apo mosveprimeve apo ndonjë rrethane

tjeter të lidhur me ndërtimin dhe mirëmbajtjen e Portit të Integruar në Triport Vlorë, me origjinë para Datës së Fillimit të Zbatimit të Kontratës, përveçse në rastet kur, kërkesat e tilla janë të shkaktuara nga veprime ose mosveprimet neglizhente të Shoqërisë Koncesionare ose ndonjë prej punonjësve të tij, ose shkelje nga ana e Koncesionarit e detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate. Detyrimi i Autoritetit Kontraktor për të dëmshpërblyer Shoqërinë Koncesionare siç parashikohet në këtë nen do të reduktohet në mënyrë proporcionale me masën që veprimet ose mosveprimet neglizhente të Shoqërisë Koncesionare ose ndonjë prej punonjësve të saj, agjentët dhe kontraktorët kanë kontribuar për këtë dëmtim, humbje, dëm, kosto dhe shpenzime.

Neni 36

Kthimi

36.1 Shoqëria Koncesionare i kthen/dorëzon territorin e Portit të Integruar të ndërtuar dhe mirëmbajtur në bazë të kësaj kontrate koncesioni, Autoritetit Kontraktor në Datën e Përfundimit të kësaj Kontrate, në gjendje të mirë dhe funksionale, të mirëmbajtur brenda Standardeve të përcaktuara në Projekt, dhe pa ndonjë barrë, pa hipotekë, peng apo ndonjë detyrim të mbartur. Shoqëria Koncesionare pas dorëzimit nuk mban më përgjegjësi për mirëmbajtjen dhe riparimet e dëmtimeve të mëpasshme të Portit të Integruar.

36.2 Jo më vonë se 3 (tre) vjet përpara Datës së Përfundimit të Vlefshmërisë së Kontratës, Shoqëria Koncesionare:

36.2.1 Kryen vrojtimin fillestar për kthimin, me qëllim që të vlerësojë gjendjen e Portit dhe të ndërmarrë masat e nevojshme, për të kryer planin në lidhje me nevojën e Investimeve Kapitale, nëse ka, si dhe çdo Punim që do të dakordësohet ndërmjet Palëve.

36.2.2 Jo më vonë se 18 (tetëmbëdhjetë) Muaj përpara kthimit/dorezimit, në bashkërendim me Inxhinierin e Pavarur, përgatit një plan paraprak të vlerësimit të kthimit, i cili do të përdoret për të përcaktuar ecurinë e Mirëmbajtjes së Portit për pjesën e mbetur të afatit.

36.2.3 Vrojtimi paraprak i kthimit, identifikon çdo Punim rregullues që mund të nevojitet, me qëllim që Porti të arrijë Standartet e kërkuara si dhe kërkesat e dorëzimit në Datën e Përfundimit të Kontratës si dhe kostot e vlerësuara të kryerjes së këtyre Punimeve.

36.2.4 Palët do të negociojnë lidhur me hapat dhe procedurat që do të ndiqen në kohën e kthimit/dorezimit të asetit tek Autoriteti Kontraktor.

Neni 37

Zgjidhja e parakohshme e kontratës

37.1 Zgjidhja e parakohshme

37.1.1 Palët bien dakord se Kontrata mund të zgjidhet ose nga ajo mund të hiqet dorë, përpara përfundimit të afatit të kësaj kontrate në datën e përfundimit të saj, vetëm për shkaqet e parashikuara në këtë kontratë dhe ato të përcaktuara në legjislacionin e aplikueshëm për koncesionet. Në këtë rast zgjidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me dispozitat e

këtij neni.

37.1.2 Përfundimi i parakohshëm i kësaj Kontrate bëhet pa cënuar të drejtat dhe detyrimet e Palëve, në rastet kur ato janë të parashikuara shprehimisht në këtë Kontratë, ose ato që zbatohen pas Datës së Përfundimit të Kontratës për shkak të natyrës së tyre.

37.2 Mospërmbushja nga Koncesionari

37.2.1 Në rrethanat kur ka ndodhur një mospërmbushje nga Shoqëria Koncesionare, dhe kjo e fundit nuk e ka korrigjuar këtë mospërmbushje brenda një afati prej 30 (tridhjetë) Ditësh Pune pas njoftimit me shkrim të Autoritetit Kontraktor sipas pikës 37.2.2 më poshtë, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të zgjidhë këtë Kontratë menjëherë pas një njoftimi me shkrim që i bën Shoqërisë Koncesionare ("Njoftimi për Mospërmbushje të Detyrimeve nga Koncesionari").

37.2.2 Në rastin e një Mospërmbushjeje nga Shoqëria Koncesionare, të identifikuar në përkufizimin e kësaj Mospërmbushjeje ("Mospërmbushje nga Koncesionari"), përpara se Njoftimi për Mospërmbushje të Detyrimeve nga Shoqëria Koncesionare t'i dërgohet Shoqërisë Koncesionare, Autoriteti Kontraktor i dërgon njoftim Shoqërisë Koncesionare për të korrigjuar mospërmbushjen e saj ("Njoftimi për Korrigjim"), i cili përmban një përshkrim të mospërmbushjeve nga Shoqëria Koncesionare dhe një periudhë për korrigjimin e tyre, e cila do të jetë jo më pak se 30 (tridhjetë) Ditë Pune pas dorëzimit të Njoftimit për Korrigjim te Shoqëria Koncesionare.

37.2.3 Autoriteti Kontraktor mund të mos i dërgojë Shoqërisë Koncesionare Njoftim për Mospermbushje nëse:

a) Shoqëria Koncesionare e korrigjon mospërmbushjen deri në datën e parashikuar në Njoftimin për Korrigjim; ose

b) Në rastin e një Mospërmbushjeje nga Shoqëria Koncesionare, të përcaktuar në përkufizimin e kësaj Mospërmbushje ("Mospërmbushje nga Koncesionari"), dhe në varësi të Marrëveshjes së Drejtpërdrejtë, ose Marrëveshjes Financiare, nëse ka, Shoqëria Koncesionare i dorëzon Autoritetit Kontraktor brenda periudhës së korrigjimit të parashikuar në Njoftimin për Korrigjim, një plan të pranueshëm nga Autoriteti Kontraktor për korrigjimin e Mospërmbushjeve nga Shoqëria Koncesionare dhe Shoqëria Koncesionare, pa asnjë vonesë të mëtejshme, nis zbatimin e planit në përputhje me kushtet e tij.

37.2.4 Përveç sa mund të parashikohet në dispozitat e Marrëveshjes së Drejtpërdrejtë, nëse në ndonjë kohë, Shoqëria Koncesionare nuk e përmbush planin korrigjues të pranuar nga Autoriteti Kontraktor në përputhje me pikën 37.2.3 "b", Autoriteti Kontraktor mund t'i dërgojë Shoqërisë Koncesionare një Njoftim të dytë për Korrigjim, ku i kërkohet përmbushja e planit brenda një afati të arsyeshëm dhe në rast të mos përmbushjes së planit brenda këtij afati, atëherë Autoriteti Kontraktor i dërgon Shoqërisë Koncesionare, Njoftimin për Mospërmbushje të Detyrimeve të Shoqërisë Koncesionare dhe kjo Kontratë merr fund në datën e dorëzimit të Njoftimit për Mospërmbushje te Koncesionari. Në këtë rast, Autoritetit Kontraktor i lind e drejta të kërkojë ekzekutimin e Garancisë së Kontratës.

37.2.5 Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të zgjidhë kontratën edhe në rast të mospërmbushjes nga Koncesionari që nuk ka korrigjuar veprimet gjatë Periudhës Koncesionare. Përveç përcaktimeve si më sipër, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të pretendojë ndaj Koncesionarit edhe kostot për vënien në funksion të Portit të Integruar, mirembajtjes së tij, etj.

37.2.6 Në rastin e zgjidhjes së parakohshme të kontratës për mospërmbushje të Koncesionarit, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të tërheqë sigurimin e kontratës si dhe të kompensohet për çdo dëmshpërblim tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, që do të rezultojë i provuar.

37.3 Shkeljet e vazhdueshme

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë, të zgjidhë këtë Kontratë për shkak të shkeljeve të vazhdueshme, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme ("**Shkelje të Vazhdueshme**"):

37.3.1 Nëse Shoqëria Koncesionare e ka shkelur të njëjtin detyrim sipas kësaj Kontrate në të paktën 2 (dy) raste në çdo 6 (gjashtë) Muaj të njëpasnjëshëm, Autoriteti Kontraktor do ta njoftojë Shoqërinë Koncesionare me shkrim ("**Paralajmërimi I Parë**"), duke vënë në dukje:

a) Detyrimin e shkelur;

b) Duke e njoftuar se ky është Paralajmërimi i Parë në bazë të kësaj Kontrate; dhe

c) Duke deklaruar se kjo është një shkelje e kësaj Kontrate e cila, nëse do të përsëritej, mund të rezultonte në përfundimin e parakohshëm të Kontratës;

37.3.2 Nëse, pas marrjes së Njoftimit të Parë, shkelja e konstatuar vazhdon për një periudhë që i tejkalon 30 (tridhjetë) Ditë Pune, ose përsëritet në të paktën 2 (dy) raste në një periudhë prej 6 (gjashtë) muajsh në vijimësi, Autoriteti Kontraktor mund të njoftojë Shoqërinë Koncesionare me shkrim ("**Paralajmërimi i Dytë**"), duke përcaktuar:

a) detyrimin që është shkelur;

b) duke e njoftuar se ky është Paralajmërimi i Dytë në bazë të kësaj Kontratë; dhe

c) duke deklaruar se kjo është një shkelje e kësaj Kontrate e cila, nëse përsëritet, do të çojë në përfundimin e parakohshëm të saj si dhe në ekzekutimin e Garancisë së Kontratës;

37.3.3 Nëse, pas marrjes së Paralajmërimit të Dytë, shkelja e përcaktuar vazhdon për një periudhë që i tejkalon 30 (tridhjetë) Ditë Pune, ose përsëritet në njërin nga 6 (gjashtë) Muajt vijues, Autoriteti Kontraktor do të njoftojë Koncesionarin se ka ndodhur një Shkelje e Vazhdueshme dhe në atë rast, zbatohen dispozitat për Mospërmbushjen e Detyrimeve nga Shoqëria Koncesionare, në përputhje me pikën 37.2.

37.4 Mospërmbushja e Detyrimeve nga Autoriteti Kontraktor

37.4.1 Në rrethana kur ka ndodhur një Mospërmbushje nga Autoriteti Kontraktor, Shoqëria Koncesionare ka të drejtë ta zgjidhë këtë Kontratë, me dërgimin e një njoftimi paraprak

për mospërmbushjet nga Autoriteti Kontraktor, ("**Njoftimi për Mospërmbushje nga ana e Autoritetit Kontraktor**").

37.4.2 Në rastin e një Mospërmbushjeje nga Autoriteti Kontraktor, përpara se të dërgohet Njoftimi për Mospërmbushje nga ana e Shoqërisë Koncesionare duhet t'i dërgohet Autoritetit Kontraktor një njoftim për të korrigjuar mospërmbushjen e tij ("**Njoftimi për Korrigjim**"), i cili përmban një përshkrim të mospërmbushjeve nga Autoriteti Kontraktor dhe një periudhë për korrigjimin e tyre, e cila do të jetë jo më pak se 30 (tridhjetë) Ditë Pune pas dorëzimit të Njoftimit për Korrigjim të Autoritetit Kontraktor.

37.4.3 Shoqëria Koncesionare mund të mos i dërgojë Autoritetit Kontraktor Njoftimin për Mospërmbushje, nëse:

a) Autoriteti Kontraktor e korrigjon mospërmbushjen deri në datën e parashikuar në Njoftimin për Korrigjim; ose

b) Në rastin e një Mospërmbushjeje nga Autoriteti Kontraktor, ky i fundit i dorëzon Shoqërisë Koncesionare, brenda periudhës së korrigjimit të parashikuar në Njoftimin për Korrigjim, një propozim të pranueshëm nga Shoqëria Koncesionare, për korrigjimin e Mospërmbushjeve nga Autoriteti Kontraktor dhe Autoriteti Kontraktor pa asnjë vonesë të mëtejshme nis zbatimin e planit në përputhje me kushtet e tij.

37.4.4 Data e Përfundimit të Kontratës:

a) Në rastin e një Mospërmbushjeje nga Autoriteti Kontraktor të përcaktuar në germën (b) të përkufizimit (Mospërmbushja e Autoritetit Kontraktor) është data e dorëzimit të njoftimit për Mospërmbushje nga Autoriteti Kontraktor; ose

b) Në rastin e të gjitha Mospërmbushjeve të tjera nga ana e Autoritetit Kontraktor, është një datë jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) Ditë Pune pas dorëzimit tek Autoriteti Kontraktor të Njoftimit të Mospërmbushjeve të Autoritetit Kontraktor.

37.4.5 Në rastin e një Mospërmbushjeje nga Autoriteti Kontraktor, të përcaktuar në germën (a) të përkufizimit (Mospërmbushja e Autoritetit Kontraktor), Autoriteti Kontraktor mund t'i parandalojë pasojat e tërheqjes dhe kjo Kontratë nuk përfundon në datën e përcaktuar në Njoftimin për Mospërmbushje të Autoritetit Kontraktor, në rrethanat kur Autoriteti Kontraktor e korrigjon Mospërmbushjen brenda 60 (gjashtëdhjetë) Ditësh Pune nga marrja e Njoftimit të Shoqërisë Koncesionare për Mospërmbushje nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 38

Vazhdimi i detyrimeve deri në përfundim

Palët do të vazhdojnë të përmbushin detyrimet e tyre sipas kësaj Kontrate, pavarësisht nga ndonjë njoftim për përfundim për mospërmbushje, derisa përfundimi i kësaj Kontrate të bëjë në fuqi në përputhje me dispozitat e nenit 37.

Neni 39

Transferimi i aktiveve dhe të drejtave pas përfundimit të kontratës

Në Datën e Përfundimit të Kontratës:

39.1. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet që Shoqëria Koncesionare ka në lidhje me Projekt Zbatimin përfundojnë dhe Autoriteti Kontraktor merr përsipër dhe përfiton të drejtat dhe detyrimet e Shoqërisë Koncesionare ndaj Portit të Integruar në Triport Vlorë. Në rastet kur Autoriteti Kontraktor i mban këto të drejta në bazë të dispozitave të tjera të Kontratës, për kryerjen e transferimit të të drejtave, Autoriteti Kontraktor i siguron Shoqërisë Koncesionare hyrje-dalje dhe përdorim të arsyeshëm të territorit të Portit që i nevojitet për largimin e personelit, stafit, pajisjeve dhe makinerive;

39.2. Nëse njoftimi për përfundim bëhet përpara dhënies së Certifikatave të Përfundimit për të gjithë Portin e Integruar, Palët do të bien dakord lidhur me dorëzimet e objektit të ndërtuar, pa ndonjë barrë, pa hipotekë, peng apo ndonjë detyrim të mbartur, tek Autoriteti Kontraktor, i cili e merr atë në dorëzim (duke përfshirë edhe Punimet e përkohshme);

39.3. Të drejtat e Koncesionit të dhëna Koncesionarit në bazë të kësaj Kontrate (përveç të drejtave të shprehura se do të vazhdojnë edhe pas përfundimit të kësaj Kontrate), duke përfshirë detyrimin e Shoqërisë Koncesionare për të mirëmbajtur Portin e Integruar në Triport Vlorë, do të përfundojnë automatikisht;

39.4. Shoqëria Koncesionare i dorëzon Autoritetit Kontraktor, Manualet e Mirëmbajtjes, së bashku me të gjitha dokumentet dhe të dhënat që kanë të bëjnë me Projekt Zbatimin dhe të dhënat e përditësuara gjatë ndërtimit, në shkallën që ato janë finalizuar në kohën e përfundimit, ose përndryshe skicat siç janë në gjendjen aktuale;

39.5. Shoqëria Koncesionare bashkëpunon dhe e ndihmon Autoritetin Kontraktor për të siguruar transferimin e mirëmbajtjes së Portit të Integruar te një palë e tretë, e caktuar nga Autoriteti Kontraktor pas Datës së Përfundimit të Kontratës.

Neni 40

Shumat e Kompensimit

40.1 Kompensimi për zgjidhjen e kontratës

40.1.1 Nëse kjo Kontratë përfundon përpara kohe, pas dërgimit të njoftimit për përfundim të parakohshëm në përputhje me nenin 37, Shoqëria Koncesionare ka të drejtë të marrë shumën e Kompensimit të Zgjidhjes së Kontratës në përputhje me këtë nen.

40.1.2 Çdo shumë e zgjidhjes së Kontratës, e pagueshme sipas këtij Neni, është një pagesë që bëhet për shkak të një detyrimi që rrjedh sipas kësaj Kontrate. Palët e konsiderojnë të drejtën për të marrë shumën e Kompensimit të Zgjidhjes së Kontratës si të vetmen kërkesë të Koncesionarit ndaj Autoritetit Kontraktor në lidhje me përfundimin e parakohshëm të kësaj Kontrate, Marrëveshjet e Financimit dhe Dokumentet e Projektit, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kontratë.

40.1.3 Palët pranojnë se e drejta për përfundimin e parakohshëm dhe pagesën e shumës së Kompensimit të Zgjidhjes së Kontratës, ose, sipas rastit, e drejta për zbritjen e pagesave, është një zgjidhje e mjaftueshme për kërkesat e dyanshme në lidhje me përfundimin e parakohshëm të kësaj Kontrate, çdo Marrëveshjeje të Financimit dhe të Dokumenteve të Projektit, dhe për çdo shkak që rezulton në përfundimin paraprak të Kontratës, përveç sa parashikohet ndryshe shprehimisht në këtë Kontratë.

40.2 Kompensimi i zgjidhjes së kontratës për shkak mospërmbushjeje nga ana e Autoritetit Kontraktor

Nëse kjo Kontratë përfundon para kohe, për Mospërmbushje nga Autoriteti Kontraktor, ky i fundit i paguan shoqërisë koncesionare shumën e llogaritur në përputhje me dispozitat e kontratës, pa përjashtuar dhe pa cënuar të drejtën e shoqërisë koncesionare për tu paguar për punimet e kryera, ndonjë kompensim ose dëm të shkaktuar kundrejt Koncesionarit, i cili i takon dhe sipas zbatimit të dispozitave të Ligjeve në fuqi.

40.3 Kompensimi i zgjidhjes së kontratës për shkak mospërmbushjeje nga ana e Koncesionarit

Nëse kjo Kontratë përfundon para kohe, për Mospërmbushje nga Koncesionari, Autoriteti Kontraktor mban garancinë e kontratës, pa përjashtuar ndonjë kompensim ose dëm të shkaktuar kundrejt Autoritetit Kontraktor, i cili i takon, sipas zbatimit të dispozitave të kësaj kontrate si dhe Ligjeve në fuqi.

Neni 41

Llogaritja dhe pagesa e kompensimit

41.1 Balancimi i tatimeve

41.1.1 Koncesionari është përgjegjës për të gjitha detyrimet tatimore që rrjedhin nga legjislacioni tatimor në fuqi, për atë si subjekt tregtar në përputhje me aktivitetin që zhvillon.

41.1.2 Përveçse kur është rënë dakord shprehimisht në këtë Kontratë, Autoriteti Kontraktor nuk përdor asnjë shumë (që i takon Shoqërisë Koncesionare për Kompensim për Zgjidhjen e Kontratës,) të pagueshme në përputhje me pikën 40.2(por jo të një shume për zgjidhje Kontrate të pagueshme në bazë të pikës 40.2), nëse si rezultat i një kompensimi/mbajtje të tillë, shuma që i është paguar faktikisht Koncesionarit në lidhje me zgjidhjen e Kontratës do të jetë më e vogël sesa Detyrimet e papaguara të Koncesionarit Kundrejt Huadhënësve. Në respektim të sa më sipër, Autoriteti Kontraktor mund të kompensojë çdo shumë që i detyrohet atij nga Koncesionari me shumën për zgjidhjen e Kontratës, vetëm nëse është rënë dakord për një gjë të tillë shprehimisht në këtë Kontratë dhe nëse kjo lejohet sipas Ligjeve.

41.2 Metoda e Pagesës

41.2.1 Nëse Autoriteti Kontraktor dhe Shoqëria Koncesionare brenda 30 (tridhjetë) Ditësh Pune nuk bien dakord që Autoriteti Kontraktor të paguajë një shumë për zgjidhjen e Kontratës me këtë në marrëveshje me Koncesionarin, ai është i detyruar të paguajë shumën e

zgjidhjes së Kontratës në një llogari të përcaktuar nga Shoqëria Koncesionare, duke filluar nga:

a) Data e zgjidhjes së Kontratës, dhe

b) Data në të cilën çdo mosmarrëveshje në lidhje me një shumë të tillë për zgjidhje Kontrate, është përcaktuar përfundimisht.

41.2.2 Në rrethanat e parashikuara në pikën 40.2 dhe në këtë nen, Autoriteti Kontraktor mund të zgjedhë të paguajë me këste ndaj Koncesionarit çdo Detyrim që ai ka Kundrejt Huadhënësve, sipas Marreveshjes së Financimit që bën pjesë në shumën e Kompensimit të Zgjidhjes së parakohshme të Kontratës, dhe Autoriteti Kontraktor përcakton shumën dhe datat e pagesave të kësteve, me kusht që:

a) Shuma dhe data e secilit kést të bëjnë të mundur të paktën pagesën e Huadhënësve në përputhje me Marrëveshjet e Financimit, në rast se nuk do të kish ndodhur përfundimi i parakohshëm;

41.2.3 E gjithë shuma e Kompensimit të Zgjidhjes së Kontratës, duke përfshirë interesin, paguhet jo më vonë se duke filluar nga data e fundit për pagesë të shumave të kërkueshme sipas Marrëveshjeve të Financimit;

a) Pjesët e shumës së Kompensimit të Zgjidhjes së Kontratës, data e pagimit të të cilave është shtyrë (nuk është paguar në kohë), do të prodhojnë interes të barabartë me Marrëveshjet e Financimit, duke filluar nga Data e Përfundimit të Kontratës, ndërsa Autoriteti Kontraktor mundet që në çdo kohë ta parapaguajë të gjithë përgjindjen e mbetur të shumës së Kompensimit të Zgjidhjes së Kontratës, me kusht që ta bëjë këtë në datën e duhur të pagimit të kështit dhe ta njoftojë Koncesionarin jo më vonë se 20 (njëzet) Ditë Pune më përpara; dhe

b) E gjithë shuma për Kompensimin e Zgjidhjes së Kontratës të paguhet sa më shpejt që të jetë e mundur, duke marrë parasysh fondet e disponueshme të Autoritetit Kontraktor dhe të gjitha mundësitë e pritshme në mënyrë të arsyeshme të Autoritetit Kontraktor për të përfituar fonde për pagesën e të gjithë shumës së plotë të Kompensimit për Zgjidhjen e Kontratës sa më shpejt që të jetë e mundur dhe pa përbërë kjo një shkak për tejzgjatje të pajustifikueshme dhe një cënim të rëndë të së drejtës Ligjore të Koncesionarit, për të marrë shumën që i takon.

41.2.4 Nëse Autoriteti Kontraktor nuk arrin të paguajë ndonjë nga kështet e përcaktuara ne pikën 41.2, Koncesionari mund te kërkoje pagimin e menjëhershëm të shumës së mbetur pa paguar nga shuma e Kompensimit të Zgjidhjes së Kontratës, duke përfshirë interesin e lindur, duke dërguar një njoftim me shkrim brenda 30 (tridhjetë) Ditësh Pune nga data e marrjes dijeni.

41.3 Informacioni i kërkuar për përcaktimin e shumës së kompensimit

Në përcaktimin e shumës për Zgjidhjen e Kontratës, Autoriteti Kontraktor mund të mbështetet në çdo dokument të dhënë nga Huadhënësit, për përcaktimin e Detyrimeve Kundrejt Huadhënësve. Autoriteti Kontraktor nuk është i detyruar të paguajë një shumë në lidhje me Detyrimet Kundrejt

Huadhënësve, e cila e tejkalon shumën e përcaktuar në një dokument të dhënë nga Huadhënësit, ku përcaktohen Detyrimet Kundrejt Huadhënësve.

Neni 42

Ndërhyrja e Autoritetit Kontraktor

42.1 Nëse Autoriteti Kontraktor ka të dhëna të arsyeshme se ka:

a) një rrezik serioz për jetën apo shëndetin dhe sigurinë e Personave apo sigurinë e Portit;
b) një rrezik serioz ndaj pronës apo mjedisit; ose
c) një shkelje të detyrës së parashikuar me Ligj;

në lidhje me Punimet dhe mirëmbajtjen e Portit, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të ndërhyjë në mënyrë të arsyeshme në Punimet e Portit për të larguar një rrezik të tillë.

42.2 Palët do të bien dakord brenda 3 (tre) Muajve nga Data e Hyrjes në Fuqi të kësaj Kontrate për procedurën që do të ndiqet në rastin që Autoriteti Kontraktor dëshiron të ushtrojë të drejtat e tij sipas këtij Neni, sipas propozimit të bërë nga Shoqëria Koncesionare. Koncesionarit i lind e drejta të kompensohet për dëmin dhe humbjet që mund t'i vijnë nga ndërhyrjet e Autoritetit Kontraktor.

Neni 43

Konfidencialiteti

43.1 Palët janë të detyruara të ruajnë konfidencialitetin në lidhje me Dokumente të Projektit, si dhe çdo të dhënë të krijuar dhe mbajtur në përputhje me këtë Kontratë, që përcaktohen në bazë të ligjit si "sekrete tregtare".

43.2 Ky nen nuk zbatohet në rastin kur informacioni që vihet në dispozicion:

a) U jepet Palëve që duhet dhe në shkallën që nevojitet për përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Kontrate;
b) Zakonisht është i disponueshëm, përveç rasteve kur sigurohet si rezultat i shkeljes se detyrimeve në këtë Kontratë;
c) Në përputhje me procedurën e nenit 52 mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;
d) Nëse kërkohet sipas Ligjit ose rregullave që rregullojnë tregun publik të titujve dhe/ose letrave me vlerë;
e) U jepet këshilltarëve profesionistë të Koncesionarit;
f) Huadhënësve apo këshilltarëve të tyre dhe këshilltarëve të tyre të sigurimeve; dhe
g) Për respektimin e një urdhri të Gjykatës apo një urdhri rregullator të një Autoriteti Përkatës.

Dispozitat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë pikë, do të vijojnë të mbeten në fuqi gjatë dhe pas përfundimit të kësaj Kontrate.

Neni 44

Të dhënat e koncesionarit

Koncesionari mban dhe ruan të dhëna të plota në lidhje me Portin duke përfshirë, por duke mos u kufizuar me, të dhënat për kostot faktike apo të parashikuara për mirëmbajtjen e Portit, kostot e ndërtimit, mirembajtjes dhe financimit për gjatë gjithë kohëzgjatjes së Kontratës.

Neni 45

Të drejtat e pronësisë intelektuale

Koncesionari garanton Autoritetin Kontraktues se i ka të gjitha të drejtat e pronësisë intelektuale (nëse është rasti) përfshirë licencat e duhura që kanë të bëjnë në (hardware) dhe programet kompjuterike (software) që përdoren gjatë zbatimit të Koncesionit.

Neni 46

Transferimi

46.1 Përveçse në rrethanat kur lejohet shprehimisht sipas kësaj Kontrate dhe Marrëveshjes së Drejtpërdrejtë dhe në bazë të të drejtave (interesave) mbi garancinë, asnjë Palë nuk ka të drejtë t'ia transferojë ndonjë nga të drejtat e saj një pale të tretë, pa pëlqimin e Palës tjetër. Pavarësisht nga sa më sipër, Autoriteti Kontraktor mund të autorizojë subjekte të tjera shtetërore brenda kontrollit të tij për të ushtruar disa nga të drejtat e tij sipas kësaj Kontrate, me kusht që Autoriteti Kontraktor të njoftojë Koncesionarin për një autorizim të tillë dhe që të mos rezultojë asnjë detyrim shtesë për Koncesionarin si rezultat i një autorizimi të tillë.

46.2 Autoriteti Kontraktor i njeh dhe i pranon interesat e sigurimit të huaja dhe garancitë që Koncesionari u ka dhënë Huadhënësve në përputhje me Modelin Financiar të propozuar nga Koncesionari dhe miratuar nga Autoriteti Kontraktor dhe çdo transferim i të drejtave dhe detyrimeve të kësaj Kontrate, që mund të vijë si pasojë e ekzekutimit të këtyre instrumentave.

Neni 47

Gjuha e kontratës

Kjo kontratë është hartuar në gjuhën shqipe, në 4 (katër) kopje të barazvlefshme.

Neni 48

Njoftimet

48.1 Mënyra dhe adresa e njoftimeve

48.1.1 Të gjitha komunikimet me shkrim, të bëra sipas kësaj Kontrate, ose çdo komunikim tjetër në lidhje me këtë Kontratë, nga secila nga Palët, Palës tjetër i dërgohen me një nga mënyrat e mëposhtme:

a) Dorëzim në dorë të komunikimit me shkrim;

b) Faks, Email; dhe/ose

c) me postë ose me shërbim korrieri.

48.1.2 Komunikim me shkrim u dërgohet palëve në adresat e mëposhtme:

a) Kur i dërgohet Autoritetit Kontraktor:

Adresa: Sheshi Skënderbej, Nr.1 Tiranë

Web:http://www.infrastruktura.gov.al

Email: i përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktues

Për: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

b) Kur i dërgohet Koncesionarit:

Adresa: Rruga 365, Pallati Nr. 8, Kati 8, Apartamenti B, Tiranë

Telefon

Email:

Për: Koncesionarin: Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive "AGBES CONSTRUKSION" sh.p.k., "BESTA" sh.p.k., "Premium Construction & Maintenance" sh.p.k., "ITE. GRUP" sh.p.k.

dhe

"ARKONSTUDIO" sh.p.k.

48.2 Afati i Përgjigjeve

Përveç rasteve kur është përcaktuar shprehimisht ndryshe në Kontratë, Palët bien dakord që kur një njoftim apo kërkesë kërkon përgjigjen, miratimin, refuzimin, apo argumentimin e Palës tjetër, Pala që ka marrë njoftimin apo kërkesën do të shprehet me shkrim në lidhje me qëndrimin e saj brenda 20 (njëzet) Ditësh Pune duke e argumentuar atë. Çdo vonesë apo kosto e shkaktuar kundrejt Koncesionarit apo Shoqërisë Koncesionare si rrjedhojë e vonesës së Autoritetit Kontraktor, do të konsiderohet sipas rastit si Shkak Lehtësimi.

Neni 49

Të pjesshme

Nëse ndonje dispozite ketu eshtë, ose bëhet e pavlefshme apo e pazbatueshme, një pavlefshmëri ose pazbatueshmëri e tillë nuk i cënon dispozitat e tjera të kësaj Kontrate. Palët marrin përsipër të zëvendësojnë dispozitën e pavlefshme dhe të pazbatueshme sa më shpejt që të jetë e mundur me një dispozitë tjetër të vlefshme dhe të zbatueshme, përmbajtja e së cilës është e ngjashme me dispozitën që do të zëvendësohet.

Neni 50

Mbrojtja e të dhënave

50.1 Nëse të dhënat personale, përpunohen në bazë të Ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar, gjatë zbatimit të kësaj Kontrate, Koncesionari plotëson secilën dhe të gjitha dispozitat që rrjedhin nga ky Ligj dhe nëse kërkohet pëlqimi i subjektit të të dhënave, një pëlqim i tillë do të merret me qëllim që të dhënat personale të mund t'i jepen Autoritetit Kontraktor. Shkelja e Ligjit në lidhje me menaxhimin e të dhënave personale nga Koncesionari, do të konsiderohet shkelje e kësaj Kontrate dhe Koncesionari do të jetë përgjegjës vetëm në lidhje me shkeljen e Ligjit.

50.2 Autoriteti Kontraktor nuk do ti japë një pale të tretë (përjashto entet publike), asnjë prej të dhënave konfidenciale pjesë e ofertës së Koncesionarit, pa miratimin e Koncesionarit.

Neni 51

Ligji rregullues

Kjo Kontratë rregullohet nga Ligjet në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 52

Përshkallëzimi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

52.1 Negociata ne Mirëbesim

Nëse lind një mosmarrëveshje ndërmjet Palëve në lidhje me interpretimin apo zbatimin e ndonjë dispozite të kësaj Kontrate, kjo mosmarrëveshje në fillim dërgohet për zgjidhje tek përfaqësuesit e Palëve si me poshtë:

a) Në rast të një mosmarrëveshjeje i njoftohet me shkrim Palës tjetër nga Pala që e nis atë, duke deklaruar përfaqësuesin e saj të autorizuar që do të merret me mosmarrëveshjen;

b) Pala tjetër i përgjigjet njoftimit të Palës së parë brenda 10 (dhjetë) Ditësh Pune, duke deklaruar përfaqësuesin e saj të autorizuar, i cili do të merret me mosmarrëveshjen;

c) Përfaqësuesit e Palëve janë Personat që nuk kanë marrë pjesë në mënyrë materiale në ngjarjet që i kanë paraprirë mosmarrëveshjes;

d) Përfaqësuesit e palëve negociojnë mosmarrëveshjen me mirëbesim dhe me qëllimin për të zgjidhur atë në një mënyrë që t'i përmbahet më mirë frymës dhe qëllimit të saj; dhe.

52.2 Arbitrazhi

52.2.1 Kur mosmarrëveshja nuk zgjidhet me negociata sipas pikës 52.1, brenda 20 (njëzet) Ditësh Pune nga lindja e mosmarrëveshjes, secila nga Palët mund ta dërgojë mosmarrëveshjen në Procesin e Arbitrazhit sipas rregullave të arbitrazhit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit ("International Chamber of Commerce – ICC"). Çdo Proces Arbitrazhi i nisur në përputhje me këtë nen ("**Procesi i Arbitrazhit**") do të zhvillohet me pjesëmarrjen e një paneli arbitrash të përbërë nga tre arbitra ("**Gjykata**"), nga të cilët 1 (një) emërohet nga Autoriteti Kontraktor, 1 (një) nga Koncesionari. Arbitri i tretë caktohet nga dy arbitrat e tjerë dhe vepron si kryetar Gjykate. Vendimi i Gjykatës është i formës së prerë, detyrues dhe i pa apelueshëm për Palët.

52.2.2 Vendi i arbitrazhit është Paris, (Francë) dhe gjuha e arbitrazhit është gjuha angleze.

52.2.3 Gjykata zbaton kushtet e kësaj Kontrate dhe dispozitat e Ligjeve që përdoren herë pas here.

52.2.4 Gjykata ka të drejtë, brenda objektit të një mosmarrëveshjeje ligjore që pritet të zgjidhet, të marrë vendime për masa të ndërmjetme.

52.2.5 Rastet, të cilat kanë të bëjnë me lëshimin e urdhrave të ekzekutimit si dhe procedurat e ekzekutimit në lidhje me mospagimin e faturave të pranuara dhe të pa likuiduara, do të jenë kompetencë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 53

Amendamentet e Kontratës

Kjo Kontratë mund të ndryshohet, në përputhje me parashikimet e nenit 31 të ligjit nr. 125/2013 "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat" të ndryshuar. Çdo ndryshim i kësaj kontrate do të bëhet me marrëveshje të shkruar të të dy palëve dhe e nënshkruar rregullisht prej tyre, me përjashtim të pikës 2.1, pikës 2.2, nenit 12, pikës 13.5, nenit 37, nenit 40, nenit 41, nenit 51 dhe nenit 52 të cilët mund të ndryshohen me nënshkrimin e Palëve dhe pas miratimit të Këshillit të Ministrave. Çdo ndryshim i kësaj kontrate apo Anekseve bashkëlidhur, do të jetë pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj kontrate.

Neni 54

Kostot dhe shpenzimet e palëve

Kur nuk parashikohet ndryshe në këtë Kontratë, ose në ndonjë dokument tjetër të Projektit, secila Palë i përballon vetë të gjitha kostot që i rrjedhin në lidhje me zbatimin e kësaj Kontrate dhe të amendamenteve të saj.

Neni 55

Konflikti i kontratës kundrejt marrëveshjes/ve të tjera

Nëse dispozitat e kësaj Kontrate bien në kundërshtim me dispozitat e një marreveshjeje ose kontrate tjetër ndërmjet Palëve në këtë Kontratë, në lidhje me të njëjtin objekt, pavarësisht nëse një marrëveshje e tillë është bërë përpara ose pas nënshkrimit të kësaj Kontrate, kjo Kontratë do të ketë gjithmonë përparësi.

Kontrata hartohet ne 4 (kater) kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe me përmbajtje të njëjtë ligjore.

Autoriteti Kontraktues

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Perfaqesuar nga:

Zevendesministri

Z. Ilir Bejtja

Në emër të Koncesionarit:

"AGBES CONSTRUKSION" sh.p.k.

Perfaqësuar nga administratori:

Z. Arben Goga

"BESTA" sh.p.k

Përfaqësuar nga:

Z. Ermal Mamaj

"Premium Construction & Maintenance" sh.p.k.

Përfaqësuar nga administratori:

Z.Hektor Agalliu

"ITE. GRUP" sh.p.k

Përfaqësuar nga administratori:

Z.Sokol Zotkaj

"ARKONSTUDIO" sh.p.k

Përfaqësuar nga administratori:

Z.Nasjel Çiço

SHTOJCAT

Shtojca 1

Dokumentet e Procedurës Konkurruese për dhënien me Koncesion/PPP për Projektimin, Ndërtimin dhe Mirëmbajtjen e "Portit të Integruar" në Triport Vlorë

Shtojca 2

Oferta e Koncesionarit, Plane Zbatimi të Punimeve

BOE: "Agbes Construction" shpk "Besta" shpk "Premium Construction Maintenance" shpk "ITE Grup" shpk "ArkonStudio" shpk

"OHENIA ME KONCESION/PARTNERITET PUBLIK PRIVAT PËR PROJEKTIMIN, NDËRTIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E "PORTIT TË INTEGRUAR" NË TIUPORT VLORË"

BOE: "Agbes Construction" shpk & "Besta" shpk & "Premium Construction & Maintenance" shpk & "ITE Grup" shpk & "ArkonStudio" shpk

MODELI FINANCIAR

30/05/2021

MODELI FINANCIAR - TREGUESIT FINANCIAR DHE PAGESAT NGA AR

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10	TOTAL
Vlera Totale e projektit											43,000,000
Total investimi nga jashtë (CAPEX)	(15,000,000)	(15,000,000)	(4,000,000)								(34,000,000)
Shpenzime Mirëmbajtje				(800,000)	(809,000)	(860,000)	(898,000)	(900,900)	(1,959,000)	(1,000,000)	(8,030,000)

	Trenchi 1	Trenchi 2	Trenchi 3
Disbursimi	**15,000,000**		
Viti 1	15,750,000	**15,000,000**	
Viti 2	16,537,500	15,750,000	**4,000,000**
Viti 3	17,364,375	16,537,500	4,200,000
Viti 4	(3,000,908)	(2,858,008)	(725,843)
Viti 5	(3,000,908)	(2,858,008)	(725,843)
Viti 6	(3,000,908)	(2,858,008)	(725,843)
Viti 7	(3,000,908)	(2,858,008)	(725,843)
Viti 8	(3,000,908)	(2,858,008)	(725,843)
Viti 9	(3,000,908)	(2,858,008)	(725,843)
Viti 10	(3,000,908)	(2,858,008)	(725,843)

34,000,000 Kredia per CAPEX
38,101,875 Total ekspozim

4,101,875 interesa te kapitalizuara

Norma e interesit **5%**
Plan including interest rates

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10	TOTAL
Të Ardhura nga Shitjet e Shtetit				8,470,077	8,470,077	8,470,077	8,470,077	8,470,077	8,470,077	8,470,077	55,050,537
Të Tjera e mbetjeve											
Të tjera e mbetjeve											
Investimi (CAPEX)											
Total Investimi (CAPEX)	(15,000,000)	(15,000,000)	(4,000,000)								
Fluksi i Parasë (Cash-Flow) pas Investimit (CAPEX)	(15,000,000)	(15,000,000)	(4,000,000)	8,470,077	8,470,077	8,470,077	8,470,077	8,470,077	8,470,077	8,470,077	(14,000,000)
Shpenzime Riinvestuese				(800,000)	(800,000)	(800,000)	(800,000)	(800,000)	(1,000,000)	(1,000,000)	25,290,537
Fluksi i Parasë (Cash-Flow) pas Shpenzimeve të Mirëmbajtjes	(15,000,000)	(15,000,000)	14,000,000	7,670,077	7,670,077	7,670,077	7,670,077	7,670,077	7,470,077	7,470,077	(4,000,000)
TVSH - Norma e Brendshme e Rithimit	-	-	-	-49.851%	-24.800%	-11.048%	-2.644%	2.628%	5.503%	9.118%	25,290,537
Flusi i mbetur	(7,500,000)	(15,000,000)	(4,000,000)								9.118%
Huti i paguar	-	-	-	(5,584,759)	(5,584,759)	(6,584,759)	(6,584,759)	(6,584,759)	(6,584,759)	(6,584,759)	44,960,000
Pasurimi nga Flusi	15,000,000	15,000,000	4,000,000	(5,584,759)	(5,584,759)	(6,584,759)	(6,584,759)	(6,584,759)	(6,584,759)	(6,584,759)	(44,083,314)
											(12,083,314)
POZICIONI I PARASË	-	-	-	1,085,318	1,085,318	1,085,318	1,085,318	885,318	885,318	885,318	7,187,224
POZICIONI I PARASË AKUMULATIV	-	-	-	1,085,318	2,170,635	3,255,953	4,341,271	5,226,588	6,111,906	7,187,224	

Shitje e mbetjes	44,050,050
Investime të kapitalizuar	4,301,875
Rezervimi me Bankën për vit 0	38,301,875

	Year 1	Year 2	Year 3	Year 4	Year 5	Year 6	Year 7	Year 8	Year 9	Year 10	TOTAL
Net Cash Flow											
Cumulative Cash Flow											
Discount Factor											
Total Cash Flow											
Equity Payback Period											
Debt Payback Period											
Interest Coverage Ratio											
DSCR											
Total Capital											
Bank Repayment Rate											

BOE: "Agbes Construction" shpk "Besta" shpk "Premium Construction Maintenance" shpk "ITE Grup" shpk "ArkonStudio" shpk

Te Ardhura nga Buxheti i Shtetit	Financimi i interesave	Financimi i CAPEX	TOTAL
Viti 1			
Viti 2			
Viti 3			
Viti 4	585,982	7,884,095	8,470,077
Viti 5	585,982	7,884,095	8,470,077
Viti 6	585,982	7,884,095	8,470,077
Viti 7	585,982	7,884,095	8,470,077
Viti 8	585,982	7,884,095	8,470,077
Viti 9	585,982	7,884,095	8,470,077
Viti 10	585,982	7,884,095	8,470,077
Totali	4,101,875	55,188,662	59,290,537

Tabela e Pagesave nga Autoriteti Kontraktues	
Te Ardhura nga Buxheti i Shtetit	Vlera ne vit (Euro)
Viti 1	
Viti 2	
Viti 3	
Viti 4	8,470,077
Viti 5	8,470,077
Viti 6	8,470,077
Viti 7	8,470,077
Viti 8	8,470,077
Viti 9	8,470,077
Viti 10	8,470,077
TOTALI (Euro)	59,290,537

5. Treguesit Financiare		
Koha e projektimit dhe Lejeve	6	muaj
Koha e zbatimit	30	muaj
Total Koha e Ndertimit	36	muaj
Kohezgjatja	10	Vjet
IRR e Projektit	9.1%	

MODELI FINANCIAR - TREGUESIT FINANCIAR DHE PAGESAT NGA AK

Shtojca 4

Përcaktimi Hartografik (sipas VKM nr. 163, datë 17.03.2021)



**Kjo shtojcë do të azhornohet në përputhje me projektin e zbatimit.*

Shtojca 5

Grafiku i Punimeve


GRAFIKU I PUNIMEVE PËR PROJEKTIMIN DHE NDËRTIMIN E "PORTIT TE INTEGRUAR" NË TIRPORT, VLORË



Shtojca 6

Preventivi i Punimeve

Shtojca 7
Sigurimet e Nevojshme

KËRKESAT MINIMALE PËR SIGURIMIN PËR NDËRTIMIN DHE MIRËMBAJTJEN

Koncesionari merr dhe mban mbulimet e mëposhtme në sigurim, gjatë periudhës së Ndërtimit dhe Mirëmbajtjes se Portit, nëpërmjet policave të lëshuara nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoriteti përgjegjës në Republikën e Shqipërisë, sipas kushteve të mëposhtme:

SIGURIMET PËR NDËRTIMIN

SIGURIMI I KONCESIONARIT GJATË PERIUDHËS SË NDËRTIMIT

1. **Sigurimi i të gjitha rreziqeve në ndërtim**

Mbulimi	:	Punimet e kontratës të realizuara dhe gjatë realizimit materialet dhe punimet provizore, për sa kohë janë në Territorin e Projektit, nga të gjitha rreziqet që shkaktojnë humbje ose dëme materiale.
Shuma e siguruar	:	Një shumë e mjaftueshme për të paguar kërkesat për dëmshpërblim në bazë të restaurimit dhe jo më të vogël se [•] për qind e Punimeve kapitale [mbetet për t'u përcaktuar nga Koncesionari dhe për t'u aprovuar nga Huadhënësit]
Shumat e zbritshme	:	Në lidhje me çdo ngjarje të ndodhur, gjatë periudhës së ndërtimit dhe kolaudimit:

i) Nga tërmeti — Jo më shumë se _____ €

ii) nga stuhia, shtrëngata, përmbytja, dëmtimi nga ujë, cunami, shembja e tokës — Jo më shumë se [•] € [mbetet për t'u përcaktuar nga Koncesionari dhe pranohet nga Huadhënësit]

iii) nga çdo shkak tjetër — Jo më shumë se [•] € [mbetet për t'u përcaktuar nga Koncesionari

dhe pranohet nga Huadhënësit]

Periudha e mbulimit : Fillon me Njoftimin për fillimin sipas parashikimeve të bëra në [Nënkontratën e ndërtimit] dhe vazhdon gjatë projektimit, prokurimit, përgatitjes së kantierit, ndërtimit, kolaudimit, vënies në punë dhe deri në vënien në shfrytëzim të plotë, plus [•] muaj periudhë garancie nga Nënkontraktori ndërtimor.

Person i siguruar : Koncesionari, Nënkontraktori ndërtimor dhe furnitorët e Koncesionarit dhe të Nënkontraktorëve ndërtimorë.

Të përgjithshme :

a) Mbulimi përfshin kalimin brenda territorit të Republikës së Shqipërisë të mallrave dhe materialeve të marra me prokurim lokal.

b) Dëmet do të paguhen në monedhën me të cilën ka lindur kostoja, pra Lekë, euro ose dollar amerikan.

c) Përfshin mbulimin për projektimin me defekt, për aq sa ofrohet ky mbulim.

d) Shuma e siguruar do të llogaritet me koston e plotë të zëvendësimit dhe do të përfshijë çdo 'material pa paguar' që i furnizohet Koncesionarit.

e) Polica duhet të përfshijë edhe një rubrikë mbi përgjegjësinë ndaj palëve të treta me kufi minimal dëmshpërblimi prej _____ € që mbetet për t'u përcaktuar nga Koncesionari dhe pranohet nga Huadhënësit dhe duhet të përfshijë kryqëzim të plotë të përgjegjësive mes palëve të siguruara.

f) Mbulimi CAR do të përmbajë një dispozitë për dëm të fshehtë 50/50.

g) Sigurimi do të parashikojë për sa më poshtë:

- Grevat, turbullirat dhe trazirat civile (SRCC);
- Kryqëzim i përgjegjësive mes palëve të siguruara;
- Zgjatje e periudhës së mirembajtjes;
- Grafikun e ndërtimit dhe/ose ngritjes;
- Punë jashtë orarit, punë gjatë natës, punë gjatë festave zyrtare dhe transport ekspres të mallrave;
- Objekte në zona të mbyllura;
- Klauzolë 72-orëshe për rreziqet madhore;
- Largimi i ujërave;
- Testim i makinerive dhe instalimeve;
- Kabllot, tubat dhe objektet e tjera nëntoke;
- Bimët bujqësore, pyjet dhe kulturat;
- Seksionet;
- Kampet & magazina;
- Materiale ndërtimi;
- Masa mbrojtëse në lidhje me reshjet, përmbytjet dhe mbulimin nga ujë;
- Largimin e inerteve.

– Objektet zjarrfikëse dhe mbrojtjen kundër zjarrit në kantierin e ndërtimit;
–Tranzitin në tokë;
–Riskun e projektuesit;
–Pronat ekzistuese;
– Vibrimet/dobësitë e strukturave mbajtëse;
– Punimet për themel pilotë dhe mure mbajtëse;
– Riskun e prodhuesit (për instalimet e/m);
– Impiante dhe pajisje ndërtimi.

Kushte të veçanta

I siguruari merr të gjitha masat përkatëse për të mbrojtur palët e treta nga ndonjë aksident/dëm gjatë realizimit të punimeve.

2. Të ndryshme

Sigurime të tjera të detyrueshme me ligj të cilat mund të vendosen gjatë hetjes efektive dhe kohezgjatjes së kësaj kontrate.

3. Sigurimi i përgjegjësisë ligjore ndaj palëve të treta

Mbulimi	Përgjegjësia ligjore e palëve të siguruara për vdekjen ose demtimin trupor të palëve të treta ose për humbjen ose dëmtimin e pasurive të tyre, që lind nga *pasja në pronësi*, shfrytëzimi, përdorimi ose mirembajtja e Projektit.
Kufiri i dëmshpërblimit	Pereaktohet në marrëveshje me Huadhënësit [mbatet për t'u percaktuar nga Huadhënësit kur të afrohet data e përmbylljes financiare] për çdo ngjarje.
Shumat e zbritshme	Jo më shumë se _____ €
Person i siguruar	Autoriteti Kontraktues, Koncesionari dhe Huadhënësit.
Të përgjithshme	Të përfshijë: një klauzolë për heqje dorë nga të drejtat e regresit (rikthimit) nga siguruesit dhe risiguruesit kundrejt secilës prej paleve të specifikuara këtu; [;] rrjedhje të papritur dhe aksidentale kontaminim, dhe kostot e lindura per pastrimin.

TË PËRGJITHSHME

a) Koncesionari kujdeset që çdo policë e blerë në përputhje me këtë shtojcë të parashikojë:

i) Kalimin e të drejtave të policave tek Huadhënësit dhe Autoriteti Kontraktues sipas rastit;
ii) klauzolë për të drejtën e të siguruarit për t'u drejtuar direkt risiguruesit/për kalimin e të drejtave për fondet nga risigurimi;

iii) që policat nuk duhen të anulohen, të lihen të skadojnë, të pezullohen apo të ndryshohen lidhur me aspektet materiale pa njoftim paraprak me shkrim (të paktën 30 ditë) ose brenda një periudhe më të shkurtër që mund të përcaktohen më pas në lidhje me luftën dhe rreziqet e lidhura;

iv) që mbrojtja që u jepet të bashkësiguruarve në bazë të policave nuk shfuqizohet nga asnjë veprim apo mosveprim nga ana e Koncesionarit apo e Nënkontraktorëve apo nën-Nënkontraktorëve të tij, për aq sa për këtë mbrojtje konsulenti i sigurimeve ka rënë dakord se është i mundshëm në mënyrë të arsyeshme; dhe

v) që Autoriteti Kontraktues nuk është përgjegjës përpara siguruesve ose risiguruesve për pagimin e primeve të sigurimit apo për detyrime të tjera të Koncesionarit.

b) Koncesionari merr dhe u vë në dispozicion të Huadhënësve dhe Autoritetit Kontraktues, letërgarancitë nga siguruesi/siguruesit dhe brokeri, me formën dhe përmbajtjen e pranueshme për Huadhënësit [dhe Autoritetin Kontraktues], ku trajtohet, ndër të tjera, njoftimi që i bëhet Autoritetit Kontraktues në rast se siguruesit dhe brokerat marrin dijeni për fakte që mund të prekin mbulimin sipas policës, konfirmimi i pagimit të primit dhe çdo ndryshim i mbulimit, marrjes ose shoqërisë së sigurimit.

c) Çdo policë e bërë në bazë të kësaj shtojce

i) mbahet pranë siguruesve dhe risiguruesve të tillë me reputacion, sipas aprovimit të marrë nga Huadhënësit dhe/ose Autoriteti Kontraktues;

ii) ka formë dhe përmbajtje në përputhje me detyrimet e Koncesionarit sipas kësaj shtojce, sipas aprovimit që mund të merret nga Huadhënësit dhe/ose Autoriteti Kontraktues dhe

iii) nuk përfshin asnjë dispozitë për vetësigurim ose për fond të mbajtur në vetësigurim me përjashtim për aq sa parashikohen shumat e zbritshme të përcaktuara në Shtojcën 7.

d) Koncesionari u vë në dispozicion Huadhënësve dhe Autoritetit Kontraktues informacionet që mund t'i kërkohen në mënyrë të arsyeshme (si, ndër të tjera, dokumentet origjinale të policës dhe prova që dëshmon pagimin e primeve.

e) Nëse në çdo moment dhe për çdo arsye sigurimi që i kërkohet të mbahet në bazë të kësaj shtojce nuk është i vlefshëm dhe në fuqi, pa cenuar të drejtat e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues, pas një njoftimi përkatës kundrejt Koncensionarit, ka të drejtë që prej atij momenti të sigurohet me shpenzimet e Koncesionarit.

f) Nëse Autoriteti Kontraktues konsideron në mënyrë të arsyeshme që, si pasojë e një ndryshimi me rëndësi materiale në ekspozimin e identifikuar ndaj riskut, ndonjëri prej kushteve, vlerave dhe shumave të zbritshme të sigurimit të marrë në bazë të kësaj shtojce është i pamjaftueshëm ose i papërshtatshëm, Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë që Koncesionari të marrë sigurime të ndryshuara dhe/ose shtesë sipas nevojës për të mbuluar ndryshimin me rëndësi materiale në fjalë.

Shtojca 8

Detyrat kryesore të Inxhinierit të pavarur

Roli i Inxhinierit të pavarur
Inxhinieri i pavarur (IP) kontraktohet nga Autoriteti Kontraktues (AK) për të menaxhuar dhe përmirësuar disa aspekte të caktuara të Kontratës së Koncesionit, kryesisht në lidhje me verifikimin e përmbushjes nga Koncesionari të Kërkesave teknike, ekonomiko financiare dhe ligjore (Kërkesat e Investitorit, KI).
Në përgjithësi, roli i Inxhinierit të pavarur duhet të zgjerohet për të mbuluar funksione për të cilat Autoriteti Kontraktues nuk është plotësisht i pajisur.
Inxhinierit të pavarur konsulent i kërkohet të ofrojë ekspertizë në të gjitha fushat e Koncesionit pa përjashtim. Çdo aspekt i ecurisë së Koncesionit duhet t'i nënshtrohet certifikimit në bazë të Sistemeve të tij të cilësisë dhe auditimit sa i takon cilësisë në lidhje me rezultatet e Koncesionarit me cilësi të siguruar dhe kontrolluar. Për këtë arsye dhe në mbështetje të funksioneve që duhet të kryejë Inxhinieri i pavarur duhet të sigurojë personel të mjaftueshëm, i cili duhet të zotërojë njohuritë e duhura të fushës. Si minimum, personeli i Inxhinierit të pavarur duhet të përfshijë specialitetet e mëposhtme:

- Kryeinxhinier
- Inxhinier të materialeve
- Inxhinier Gjeolog
- Inxhinier gjeoteknik
- Inxhinier strukturor
- Inxhinier për sinjalistikën dhe mbrojtjen e sigurisë
- Ekspert mjedisi
- Specialist informatike
- Inxhinier topograf
- Inspektor për sigurinë dhe shëndetin në punë
- Ekonomist
- Jurist

Roli i Inxhinierit të pavarur është certifikimi i pavarur i punës konform kërkesave dhe që çdo punë bëhet nëpërmjet sigurimit të cilësisë/kontrollit të cilësisë të Koncesionarit, sic mund të jetë e nevojshme herë pas here, në përputhje me udhëzimet ekzekutive të Autoritetit Kontraktues për të konfirmuar dhe/ose korrigjuar ecurinë.
Inxhinieri i pavarur mbikëqyr dhe kontrollon, nëpërmjet Sistemeve të veta të cilësisë, ecurinë e Koncesionarit. Inxhinieri i pavarur kryen auditim të kontrollit të cilësisë sipas nevojës (në bazë të variancës statistikore të ecurisë së Koncesionarit), për të konfirmuar certifikatën e përputhshmërisë të Koncesionarit.
Nëse certifikata e Inxhinierit të pavarur për punën e Koncesionarit, si për Koncesionarin ashtu edhe për Autoriteti Kontraktues, thotë se ka mosplotësim, atëherë Sistemet e cilësisë të Koncesionarit duhet të diktojnë që puna të korrigjohet/përsëritet.

Më ne hollësi, Inxhinieri i pavarur ndërmerr funksionet e mëposhtme:

I-Funksione të përgjithshme
1. kryen kontrolle të përgjithshme, auditon dhe asiston në prova ose hetime në lidhje me Punimet ose Shërbimet, duke pasur në çdo moment liri të pakufizuar për të hyrë në çdo territor ose punishte ku prodhohen materiale, në varësi të ndjekjes së të gjitha procedurave përkatëse të sigurisë;
2. mbikëqyr në aspektin teknikë, ekonomiko financiare dhe ligjore plotësimin nga Koncesionari të dispozitave të Kontratës së Koncesionit, me përshtatjet përkatëse që lejon Kontrata, dhe informon menjëherë Autoritetin Kontraktues dhe Koncesionarin nëse konstatohet mosplotësim;
3. ka liri të pakufizuar hyrjeje në Territorin e Projektit në çdo moment të arsyeshëm gjatë të gjithë Periudhës së Kontratës në mënyrë që të kryejë funksionet e tij;
4. ka të drejtë të hyjë në çdo pronë që përdor Koncesionari për realizimin e Punimeve dhe Shërbimeve, për të kontrolluar ndërtimin dhe mirëmbajtjen e Projektit dhe për të ndjekur plotësimin e detyrimeve nga Koncesionari;
5. ka të drejtë të hyjë në çdo moment në çdo pronë të përdorur nga Koncesionari si objekt trajnimi ose punishte dhe në vendet ku përgatitet puna ose nxirren materialet për Projektin, për ndjekur plotësimin e detyrimeve nga Koncesionari;
6. ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet ku diskutohet ecuria mujore ose me shpeshtësi tjetër në lidhje me Punimet dhe/ose Shërbimet dhe të marrë njoftim në kohën e duhur për këto mbledhje nga Koncesionari;
7. ka të drejtë të kërkoje dhe të marrë kopje të të gjitha skicave, lidhjeve, specifikimeve dhe shtojcave, pas çdo modifikimi që u bën Koncesionari;
8. ka të drejtë t'i kërkojë Koncesionarit të ndreqë çdo defekt në plotësimin e detyrimeve në bazë të Kontratës dhe të vlerësojë se sa janë korrigjuar këto defekte;
9. ka të drejtë t'i kërkojë Koncesionarit të largojë nga Territori i Projektit çdo agjent ose punëmarrës të Koncesionarit ose çdo Nënkontraktor të cilitdo nivel, sipas rastit, që, sipas mendimit të Inxhinierit të Pavarur, bën shkelje ose është i paaftë ose tregon pakujdesi në kryerjen siç duhet të detyrave në lidhje me Projektin, ose prania e të cilëve konsiderohet e padëshirueshme në Territorin e Projektit;
10. konsultohet me Palët për çdo çështje që ka të bëjë me Punimet dhe Shërbimet;
11. u jep raporte ose informacione Autoritetit Kontraktues,
12. shqyrton shfuqizimin ose ndryshimin me ndikim negativ të të gjithave ose disave prej Dokumenteve të projektit dhe jep kundërshtimin e vet për këtë nëse është nevoja;
13. sa herë i kërkohet të japë vendim, opinion ose pëlqim apo të shprehë bindjen ose aprovimin e tij ose të kryerje veprime të tjera që mund të prekin të drejtat dhe detyrimet e Palëve të përfshira ("Konstatim"), nëse nuk parashikohet ndryshe, Inxhinieri i pavarur e bën këtë Konstatim sapo ta këtë të mundur dhe në çdo rast brenda afatit të parashikuar në Kontratën e Koncesionit dhe/ose në Kërkesat e Autoritetit Kontraktues sipas çështjes në fjalë dhe i komunikon komentet që mund të këtë në lidhje me këtë Konstatim brenda afatit përkatës;
14. jep vlerësim mospranues për raportet që janë mbështetur në informacione ose të dhëna të gabuara ose që nuk janë në përputhje me këtë Kontratë;
15. ka të drejtë të shikojë, auditojë dhe marrë kopje të evidencave të Koncesionarit në çdo moment;
16. e ndryshon adresën pasi i ka njoftuar Palët e përfshira.

II-Funksione të veçanta në lidhje me Aspektet e Kërkesave të Autoritetit Kontraktues dhe Kontratën e Koncesionit
Sistemi i menaxhimit të cilësisë
1. Aprovon dhe jep komente për Manualin e kontrollit të cilësisë për ndërtimin dhe mirëmbajtjen

2. Këqyr dhe auditon Sistemin e menaxhimit të cilësisë të Koncesionarit dhe planet e lidhura të cilësisë, përfshirë edhe ato të projektuesve, Nënkontraktorëve dhe furnitorëve të tij, në intervalet që i konsideron të arsyeshme Inxhinieri i pavarur.
3. Shqyrton dokumentacionin e cilësisë në përputhje me standardin e kërkuar.
4. Aprovon dhe komenton për Sistemet përkatëse të cilësisë të hartuara nga Koncesionari përpara fillimit të çdo pjese të Punimeve ose Shërbimeve dhe përditësimet e tyre gjatë Periudhës së vlefshmërisë së Kontratës.
5. Merr pjesë së bashku me menaxherin e projektit të Koncesionit në kontrollet zyrtare dhe të parashikuara me grafik të niveleve të shërbimit që zhvillohen dhe që realizohen nga Njësia e Zbatimit të Projektit.

Mirëmbajtja e Portit

1. Aprovon dhe jep komente për projekt-versionin e hollësishëm të:
- Manualit të kontrollit të cilësisë për mirëmbajtjen
- Manualit të mbrojtjes së shëndetit dhe jetës për mirëmbajtjen
- Manualit të mirëmbajtjes rutinë
- Manualit ose manualeve të kontrollit dhe monitorimit
- Planit të administrimit mjedisor

2. Shqyrton dhe aprovon justifikimin e paraqitur nga Koncesionari për devijimin nga afatet e kundërpërgjigjeve për shkak të kushteve të ashpra të motit.
3. Miraton (së bashku me policinë) gamën e shërbimeve në rast aksidenti.
4. Aprovon ose komenton për Planin në kundërpërgjigje të situatave të forcës madhore ose situata të tjera të rënda.
5. Merr raportet dhe evidencat e Koncesionarit per situatat e forcës madhore ose situata të tjera të rënda.
6. Konsultohet me Koncesionarin në lidhje me zgjidhjen përfundimtare të situatave të forcës madhore ose situata të tjera të rënda, në varësi të llojit të tyre.
7. Aprovon projekt-versionin e hollësishëm, versionin përfundimtar dhe përditësimet e përvitshme të Planit të mirëmbajtjes gjatë dimrit të Koncesionarit.
8. Bie dakord dhe jep aprovimin për shfrytëzimin e teknologjive të ngjashme ose të përmirësuara që duhen përdorur për matjen gjeodezike.
9. Merr raporte tremujore nga Koncesionari ku përshkruhen me hollësi punimet e realizuara në tremujorin e fundit dhe programet e mirëmbajtjes që propozohen për të ardhmen.
10. Bie dakord për mënyrën e raportimit të parametrave të gjendjes së shtresave të rrugës.
11. Këshillon për hetimet shtesë që duhen kryer në lidhje me kushtet ekzistuese gjeoteknike dhe rreziqet urgjente të mundshme në rastet kur materiali rrëshqitës është më i madh se ___ m^3.
12. Aprovon kohën shtesë të nevojshme për riparimet strukturore sipas justifikimit të Koncesionarit.
14. Aprovon ndryshimet që i bëhen programit të mirëmbajtjes parandaluese të Koncesionarit në rast se nuk arrihen objektivat e parashikuara.

Sistemet e kontrollit, monitorimit dhe menaxhimit

1. Këshillon për kohën e lejuar për riparimet e defekteve në rastet kur këto riparime janë të nevojshme dhe nuk mund të përfundohen brenda afatit kohor të dakordësuar të palëve.
2. Jep këshilla dhe orientime për kontrollet e strukturave në lidhje me përmbushjen e standardeve shqiptare dhe evropiane dhe të Praktikës së mirë të sektorit ekonomik, si edhe sistemin e menaxhimit të strukturave.
3. Aprovon projekt-propozimin e hollësishëm për zhvillimin dhe shfrytëzimin e sistemeve të menaxhimit të inventarit dhe infrastrukturës.
4. Aprovon/konfirmon demonstrimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit të inventarit dhe infrastrukturës.

5. Aprovon sistemet e menaxhimit me licence të blerë.
6. Aprovon programin e kontroll-monitorimit për vitin e ardhshëm (përfshirë metodikën, format dhe procedurat) që është pjesë e raportit vjetor.

Punimet kapitale dhe Riparimet kapitale

1. Bashkërendon dhe mbikëqyr Punimet kapitale dhe/ose Riparimet kapitale, që merr përsipër Autoriteti Kontraktues dhe/ose nënkontraktori i Autoritetit Kontraktues gjatë kohëzgjatjes së Koncesionit, të cilave duhet t'u bëjë vend Koncesionari.
2. Jep rekomandime (shtesë) për standardet e projektimit që duhen përdorur në propozimet e reja si edhe në përgatitjen e të gjitha projekteve kryesore përfundimtare të elementeve të Punimeve kapitale nga Koncesionari.
3. Aprovon paketën e plotë të standardeve të projektimit për secilin element të Punimeve që ka përpiluar Koncesionari përpara fillimit të çdo projekti teknike kryesor përfundimtar.
4. Aprovon shmangiet nga standardet dhe normat e konfirmuara të projektimit, si edhe nga projektet paraprake dhe/ose të hollësishme, që mund të jenë me përfitim për Autoritetin Kontraktues dhe për Projektin sa i takon sigurisë, efikasitetit të shfrytëzimit, ekonomisë në ndërtim dhe mirëmbajtjes, programit të ndërtimit, jetëgjatësisë së përgjithshme, përmbushjes së standardeve të reja ndërkombëtare dhe harmonizimit me BE-në në të ardhmen.
5. Konfirmon miratimin e tij për propozim-projektin me shkrim me t'u arritur marrëveshja për këtë.
6. Shqyrton dhe aprovon shtesat dhe ndryshimet në propozim-projektin e pranuar të paraqitura nga Koncesionari si shtojca përpara fillimit të punës për aspektet e punimeve që preken nga shtojca në fjalë.
7. Kontrollon efektin që kanë Objektet e përkohshme tek struktura e përhershme (por nuk kontrollon Objektet e përkohshme).
8. Aprovon verifikuesin e pavarur të Objekteve të përkohshme.
9. Shqyrton vlefshmërinë e projektit dhe verifikon certifikatat e të gjitha Objekteve të përkohshme.
10. Shqyrton dhe pranon (ose refuzon) projektin e plotë përfundimtar për elementet e Punimeve kapitale që duhet të përfshijnë evidencat të plota të projektit të aprovuar.
11. Kërkon dhe përdor manualin e projektimit si tekst të plotë mbështetës dhe dokument efikas pune.
12. Komenton dhe aprovon programin e punës për projektet teknike të paraqitura nga Koncesionari për të gjitha elementet që përbëjnë Punimet kapitale.
13. Shqyrton propozim-projektet e paraqitura, në konsultim me Autoritetit Kontraktues. Pas përfundimit të shqyrtimit, Inxhinieri i pavarur:
   - aprovon materialin e paraqitur,
   - jep aprovim të kushtëzuar që kërkon berjen dhe përfshirjen e rishikimeve në skicat e punës ose
   - refuzon pjesërisht ose plotësisht materialin nëse konstaton se projekti teknik nuk i përmbush kërkesat teknike të Autoritetit Kontraktues dhe/ose kriteret e projektimit
14. Shqyrton skicat teknike të punës të paraqitura. Pas përfundimit të shqyrtimit, Inxhinieri i pavarur:

- aprovon materialin e paraqitur,
- refuzon pjesërisht ose plotësisht materialin nëse konstaton se projekti teknik nuk i përmbush kërkesat teknike të Autoritetit Kontraktues dhe/ose kriteret e projektimit ose me komentet e lëra nga Inxhinieri i pavarur si pjesë e aprovimit të kushtëzuar të propozim-projektit.

15. Monitoron Punimet në përputhje me Kontratën e Koncesionit sipas klauzoles __

16. Aprovon shmangien nga standardet dhe normat në lidhje me specifikimet teknike që është me përfitim për Autoritetin Kontraktues sa i takon sigurisë, efikasitetit të shfrytëzimit dhe jetëgjatësisë.

17. Merr dhe aprovon planin për menaxhimin e ndërtimit të Punëve kapitale për të gjitha Aspektet e punëve kapitale.

18. Aprovon programin e hollësishëm për projektimin dhe ndërtimin e punimeve për çdo Aspekt të punimeve kapitale të paraqitur nga Koncesionari.

19. Aprovon raportet mujore të ecurisë dhe përditësimet e programit sipas kërkesave.

20. Merr pjesë në procesin vjetor të konsultimeve dhe aprovimeve në lidhje me realizimin e Punimeve kapitale në bazë të datave të paracaktuara të fillimit dhe përfundimit (ose datave të kushtëzuara të fillimit dhe data përkatëse të përfundimit, sipas rastit).

Menaxhimi dhe vlerësimi i ecurisë

1.Monitoron dhe raporton për ecurinë e Koncesionarit kundrejt kërkesave kontraktore në bazë të Relacioneve mujore/Relacioneve vjetore të ecurisë, Manualit të mirëmbajtjes, planit të ndërtimit të terminalit dhe të rrugës, Sistemeve të cilësisë dhe Sistemi i menaxhimit mjedisor që lapin informacionet e nevojshme për drejtimin.

2.Ndërmerr auditime të palës së dytë të Sistemeve të cilësisë dhe disa auditime teknike të punimeve faktike.

3.Ndërmerr auditime teknike të Shërbimeve dhe Punimeve të monitoruara nga Njësia e dedikuar e kontrollit të cilësisë e Koncesionarit.

4.Ka të drejtë të rrisë, me shpenzimet e Koncesionarit, nivelin ose shpeshtesinë e monitorimit, auditimit, testimit dhe inspektimit të portit dhe respektimit nga Koncesionari të detyrimeve të veta në bazë të kësaj Kontrate, në atë nivel që Autoriteti Kontraktues ose Inxhinieri i pavarur e konsideron të përshtatshëm, sipas Kontratës së Koncesionit.

Kthimi

1.Mund të udhëzohet nga Autoriteti kontraktues të kryejë një inspektim të Portit për të konstatuar nëse Koncesionari po i përmbush apo jo kërkesat e kësaj Kontrate dhe në veçanti nëse do të përmbushen Kërkesat për kthimin brenda Datës së përfundimit të vlefshmërisë.

2.Shqyrton dhe aprovon planin e vlerësimit për kthimin përpara fillimit të çdo pune ngaKoncesionari.

3.Konsultohet me Koncesionarin në lidhje me përditësimin e planit të vlerësimit përkthimin sipas nevojës për të reflektuar ndryshimet e kushteve të aktiveve të projektit ose të metodikës së vlerësimit të përcaktuara pas inspektimit të Portit nga Autoriteti Kontraktues ose nga personi i caktuar prej tij.

4.Shqyrton dhe aprovon procedurat e hollësishme të testimit dhe inspektimit sipas kërkesave të kontratës.

5.Bashkërendon me Koncesionarin të gjitha aspektet e planit të punimeve rinovuese përkthimin.

6.Merr në dorëzim dokumentacionin nga Koncesionari ku bëhet e ditur se Koncesionari i ka përmbushur udhëzimet dhe i ka përmbushur dhe përfunduar detyrimet për çdo ndreqje siç e kërkon legjislacioni shqiptar në lidhje me ato fusha ku është dashur të merren masa ndreqëse për shkak kontaminimi apo derdhjeje lënde djegëse.
7. I asiston Koncesionarit në kryerjen e Vrojtimit përfundimtar për kthimin në mënyrë që tëpërcaktohen se çfarë punimesh ndreqëse kanë mbetur pa u bërë.

Funksione të tjera:

1. Certifikon që Trualli shtesë kërkohet nga Koncesionari për realizimin e detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate.
2. Jep opinion për pretendimet e Nënkontraktorëve dhe çdo dokument që lidhet me to. Aprovon dhe komenton Programin fillestar të Koncesionarit (ose shtesat dhe ndryshimet në të).
3. Kryen procedurën e dorëzimit teknik pas përfundimit paraprak.
4. Kontrollon dhe vërteton se janë përfunduar Punimet e nevojshme për shfrytëzimin parrezik të portit.
5. Vlerëson rezultatin e procedurës së dorëzimit teknik dhe konstaton nëse Koncesionari i ka përmbushur të gjitha Kërkesat e Autoritetit Kontraktues për punimet, ose informon Koncesionarin për çdo kundërshtim.
6. Konsulton Koncesionarin me qëllim arritjen e një marrëveshjeje për masat që kërkohet të merren në mënyrë të arrihet përmbushja e Kërkesave të Autoritetit Kontraktues në rast se ka kundërshtim.
7. Kryen procedurën e dorëzimit teknik pas përfundimit përfundimtar.
8. Kontrollon dhe vërteton se Punimet janë përfunduar dhe se kushtet e përcaktuara në Certifikatën e perkohshme të Përfundimit janë përmbushur.
9. Përcakton se çfarë shtesash dhe ndryshimesh duhen bërë në Manualet e mirëmbajtjes në rast se Palët nuk merren vesh për shtesat dhe ndryshimet e duhura.
10. Përcakton shtesat dhe ndryshimet e duhura në Programin e riparimeve kapitale në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit.
11. Konstaton nëse ka ndodhur ndonjë defekt, shkelje dhe/ose mosplotësim dhe afatin e ndreqjes në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit në lidhje me defektet e identifikuara dhe të nevojshme për t'u ndrequr
12. Vendos për Truall shtesë alternativ të ngjashëm nëse Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari nuk mund të merren vesh.
13. Informohet dhe vepron sipas nevojës në përputhje me Kontratën e Koncesionit sa u takon ngjarjeve të kompensimit.
14. Vlerëson dëshmitë që jep koncesionari sa u takon ngjarjeve të kompensimit.
15. Informohet dhe vepron sipas nevojës në përputhje me Kontratën e Koncesionit sa u takon ngjarjeve të lehtësimit nga detyrimi.

16. Vlerëson dëshmitë që jep koncesionari sa u takon ngjarjeve të lehtësimit nga detyrimi.

17. Informohet dhe vepron sipas nevojës në përputhje me Kontratën e Koncesionit sa u takon ngjarjeve të forcës madhore.

18. Vlerëson dëshmitë që jep koncesionari sa u takon ngjarjeve të forcës madhore.

19. Njoftohet me shkrim për pasojat e mundshme të një Ndryshimi cilësues të ligjit që është bërë ose do të bëhet shumë shpejt.

20. Njoftohet pa vonesë të panevojshme për kërkesën e Koncesionarit për të marrë përfitime pas hyrjes në fuqi të Ndryshimit cilësues të ligjit.

21. I vihet në dispozicion një shpjegim i plotë dhe i hollësishëm dhe dëshmi në lidhje me Ndryshimin cilësues të ligjit dhe përfitimet e kërkuara, kohëzgjatjen e çmuar të vonesës në fjalë, çdo informacion përkatës që ka të bëjë me Ndryshimin cilësues të ligjit dhe humbjen e pritur të të ardhurave ose rritjen e kostove që vjen nga Ndryshimi cilësues i ligjit.

22. Ofron marrje vendimi në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit në lidhje me një Ndryshim të Autoritetit Kontraktues të kërkuar në përputhje me klauzolën ____ të Kontratës së Koncesionit (Ndryshime të punimeve dhe shërbimeve).

23. Jep opinion për arsyeshmërinë e propozimeve të Koncesionarit në Njoftimin për ndryshim.

24. Ofron marrje vendimi nëse është i nevojshëm Plani i restaurimit dhe kur është i nevojshëm ky plan.

25. Ofron marrje vendimi në përputhje me klauzolën ___ në lidhje me Defektet e fshehta.

Shtojca 9

Sigurimi i Kontratës

ALBSIG

Shoqëria e Sigurimeve ALBSIG sh.a. Tirana, Albania - NIPT K41[illegible]
Tel: (355) 42 [illegible] Fax: (355) 42 [illegible] E-mail: [illegible]

FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS

Numri Serial: 220700284

Për: MINISTRIA E INFRASTRUKTURES DHE ENERGJISE, *Nr. "Abdi Toptani", Nr.1, 1001, Tiranë, Shqipëri*

Në emër të: Bashkimi i Operatorëve ekonomikë "PREMIUM CONSTRUCTION & MAINTENANCE" SH.P.K. (NIPT M11816005V), "AGBES KONSTRUKSION" SH.P.K. (NIPT K32807432W), "BESTA" SH.P.K (NIPT J62903182B), "ITE GRUP" SH.P.K. (NIPT K11323001H) DHE "ARKONSTUDIO" SH.P.K. (NIPT L42019004I). Perfaqesuar nga PREMIUM CONSTRUCTION & MAINTENANCE" SH.P.K.

Procedura e koncesionit / ppp: Procedure e Hapur

Përshkrim i shkurtër i kontratës: PPP/ DHËNIA ME KONCESION/PARTNERITET PUBLIK PRIVAT PËR PROJEKTIMIN, NDËRTIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E "PORTIT TË INTEGRUAR" NË TRIPORT VLORË

Publikimi *(nëse rooohet):* www.app.gl **: Buletini i Njoftimeve Publike** *Nr. 122, Dt. 16.09.2021*

Duke qene se:
- Bashkimi i Operatorëve ekonomikë "PREMIUM CONSTRUCTION & MAINTENANCE" SH.P.K., "AGBES CONSTRUKSION" SH.P.K., "BESTA" SH.P.K, "ITE GRUP" SH.P.K. DHE "ARKONSTUDIO" SH.P.K., eshte shpallur fitues ne Procedurën Konkurruese per Marrjen me Koncesion/PPP të "PPP/ DHËNIA ME KONCESION/PARTNERITET PUBLIK PRIVAT PËR PROJEKTIMIN, NDËRTIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E "PORTIT TË INTEGRUAR", me vendimdhënje ne Triport, Vlore, sipas shkresës se Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise (me poshte referuar si "Autoriteti Kontraktor"); Nr. 7614/1 Prot, date 21.10.2021, "Njoftimi i Fituesit"; dhe

- Ofertuesi Fitues ka paraqitur pranë nesh Draftin e Kontratës te lidhur ndermjet tij dhe Autoritetit Kontraktor, "Per marrjen me koncesion/ppp të PPP PËR PROJEKTIMIN, NDËRTIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E "PORTIT TË INTEGRUAR" NË TRIPORT VLORË ; dhe
- ne Kontratën tuaj Kerkohet leshimi i një Sigurimi Kontrate ne vleren e specifikuar si me poshte, si garanci per permbushjen e detyrimeve te Koncesionarit te parashikuara ne Kontrate; dhe
- **ALBSIG SH.A.** eshte dakord te leshoje kete garanci.

Deklarojme se:
- jemi garantuesit e kontratës se sipërpermendur deri ne shumën totale prej **2,964,526.85 Euro** *(dy milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e pesëqind e njëzet e gjashtë euro e tetëdhjetë e pese cent)*, shuma e cila është e paguajshme ne menyren dhe momentin e percaktuar ne kontrate; dhe
- marrim persipor te paguajme, sapo te beni kerkesen e pare me shkrim dhe pa qene nevoja te beni argumentim te kerkeses, cdo shume brenda kufirit prej **2,964,526.85 Euro** *(dy milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e pesëqind e njëzet e gjashtë euro e tetëdhjetë e pese cent)*; dhe
- per marrjen e kesaj garancie, nuk eshte nevoja t'i drejtoheni me pare Koncesionarit\Partneritit Publik Privat per te realizuar pagesen sipas kerkeses suaj; dhe
- asnje shtesë apo ndryshim i kushteve te kontratës, per te cilen ju mund te bini dakord me Koncesionarin, nuk na clirnn nga detyrimet e kesaj Garancie.

Ky Sigurim eshte i vlefshëm per 3 vite, deri me 16 Mars 2025 (me te drejte rinovimi)

I leshuar ne Tirane me dt. 16 Mars 2022.

ALBSIG SH.A.

0055430